
Konflikti Ruso-Ukrainas

Imperializmi amerikan
pushton Evropën

Giulio Palermo

|||Dritëhije

email: botimedritehije@gmail.com

tel: +355676431411

Konflikti Ruso-Ukrainas

Imperializmi amerikan
pushton Evropën

Giulio Palermo

Përkthyer nga Besmir Skëndaj



**Titulli në origjinal
“Il conflitto russo-ucraino”**

**Autori: Giulio Palermo
Përktheu: Besmir Skëndaj
Redaktoi: Xhuliano Bregasi
Grafika: Kristi Çunga**

**© 2022 Giulio Palermo
© në shqip, Shtëpia Botuese Dritëhije
Tiranë, 2024**

**I edizione: novembre 2022
L.A.D. GRUPPO EDITORIALE
Viale Carso 1, 00197 Roma
www.ladedizioni.it
info@ladedizioni.it**

ISBN 9789928481511

Pasqyra e lëndës

Hyrje / 9

1. Rrënjët historiko-politike të konfliktit / 17

Fuqitë e mëdha dhe marionetat e imperializmit / 14

Tranzicioni i Ruisë në kapitalizëm / 17

Ekspansioni i NATO-s në Evropë / 20

Situata në Ukrainë / 23

Grushti i shtetit i vitit 2014 / 27

Ndryshimi i regjimit / 30

Formimi i qeverisë së re të grushtit të shtetit / 33

Marrëveshjet e Minsk-ut / 37

Ngërçi / 40

Presidenti i kamufluar / 45

2. Pasojat ekonomike të luftës / 53

Operacioni ushtarak rus / 54

Sanksionet kundër Ruisë / 59

Kundërmassat ruse / 60

Fatet e Ukrainës / 66

Fitues dhe humbës në Frontin Lindor / 72

Fitues dhe humbës në Frontin Perëndimor / 75

Default-et financiarë ndërkombëtarë / 78

Zhvillimet e luftës ekonomike / 81

3. Përplasja ruso-ukrainase në kontekstin post-pandemik / 87

Përmbledhje e krizës ekonomike / 89

Lojtarët në fushë / 93

Nga pandemia te lufta në Ukrainë / 96

Efektet e luftës në përplasjen imperialiste / 101

Ekonomia e gjelbër / 104

Përplasja teknologjike dhe kontrolli i informacionit / 109

4. Strategjia e SHBA-së në Evropë / 113

Procesi i unifikimit ekonomik / 114

Fundi i SME-së dhe konvergjenca në euro / 117

Konfliktet e brendshme të Bashkimit Evropian / 120

Kriza monetare / 124

Borxhi publik / 129

Konkluzione / 133

Shkurtime / 144

Konflikti Ruso–Ukrainas

Imperializmi amerikan pushton Evropën

Giulio Palermo

Hyrje

Sipas narrativës dominuese, të paktën në Perëndim, lufta në Ukrainë fillon më 24 shkurt 2022 me sulmin e pajustificuar dhe të paparashikueshëm të Ukrainës nga Rusia, menjëherë pas njohjes nga Moska të republikave të Donbass-it, të Donetsk-ut dhe Lugansk-ut, të cilat shpallën pavarësinë e tyre nga Kievi në vitin 2014.

Nga ana tjetër, sipas deklaratave të presidentit rus Vladimir Putin, “operacioni special” është një reagim ndaj dështimit të Ukrainës për të zbatuar marrëveshjet e Minsk-ut të 2014-s dhe 2015-s dhe ndaj masakrave të kryera nga forcat ushtarake dhe paraushtarake në shërbim të Kiev-it kundër popullsisë së Donbass-it dhe rajoneve të tjera të Ukrainës.

Këto marrëveshje, të nënshkruara nga përfaqësues të Ukrainës, Rosisë, Republikës Popullore të Donetsk-ut dhe Republikës Popullore të Lugansk-ut, nën kujdesin e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), synonin të zgjidhnin krizën në Ukrainë pas grushtit të shtetit të realizuar në shkurt të 2014-s.

Rusia – asokohe Bashkimi Sovjetik – kishte shprehur gjithashtu shqetësime për zgjerimin e Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO) që nga rënia e Murit të Berlinit në vitin 1989, dhe nuk është çudi që tensionet janë rritur dora-dorës që ky proces (zgjerimi) është shtyrë deri në portat e Moskës.

Me agresionin e NATO-s kundër Jugosllavisë në vitin 1999, edhe rusët më të oksidentalizuar filluan ta shohin ndryshe rolin e NATO-s si eksportuese e demokracisë, duke qenë se nën bomba kishin përfunduar vëllezërit e tyre serbë. Një luftë që nuk

i përket asnjë parimi të së drejtës ndërkombëtare: nga Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB), e cila nuk e autorizoi misionin, deri te vetë NATO-ja, duke qenë se asnjë vend anëtar i aleancës nuk ishte sulmuar. Por përkundrazi, një luftë që i përket metodave diplomatike të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, si një akt demonstrimi dhe gjithashtu një paralajmërim për të gjithë.

Me pak fjalë, arsye që Rusia të ishte dyshuese mbi qëllimet e mira të Shteteve të Bashkuara në Ukrainë kishte shumë, dhe rrënjët e tyre janë të thella. Nga ana tjetër, Lufta e Ftohtë përfundoi me një fitues e një humbës dhe, pavarësisht se si thuhet gjërat, sipas logjikës së luftës, është normale që i pari të hakmerret ndaj këtij të fundit.

Pyetja e vërtetë që duhet bërë është, mbase, një tjetër: si është e mundur që, megjithëse shkaqet janë kaq të largëta, përplasja vjen pikërisht tani?

Kur kërkohen shkaqet e situatave që shpërthejnë, duhen dhënë gjithmonë dy shpjegime, jo një: së pari, duhet të identifikohen tendencat afatgjata, ato forca që shtojnë në mënyrë progresive drejt krizës; së dyti, duhen shpjeguar faktorët rastësorë që çojnë në shpërthimin e krizës.

Strategjia afatgjatë e Shteteve të Bashkuara në Ukrainë fillon shumë përpara grushtit të shtetit të vitit 2014. Nga ky këndvështrim, është më mirë të nisesh që nga fillimi: nga procesi i shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik, në të cilin përcaktohet plani amerikan i akaparimit të plaçkës së luftës. Rindërtimi historik i këtyre ngjarjeve është lënda e kapitullit të parë të librit.

Analiza kritike e këtij procesi historik tregon se kemi rritje të presionit ushtarak të SHBA-së mbi Rusinë dhe shpjegon përse Rusia mund të përgjigjet vetëm ushtarakisht në fund. Mirëpo është analiza e dinamikës së luftës, sidomos në aspektet e saj ekonomike, përpara sesa ushtarake, që na jep

një përgjigje më të qartë ndaj pyetjes së dytë: Përse tani? Kapitulli i dytë i kushtohet kësaj teme.

Pasojat ekonomike të luftës, absolutisht të parashikueshme dhe sigurisht të parashikuara nga aktorët në lojë (përveç, me sa duket, për disa politikanë evropianë), tregojnë se drejtimi i operacionit është në Washington dhe se armiku i vërtetë nuk është në Moskë, por në Bruxelles. Ukraina është vetëm instrumenti për të detyruar Rusinë të ndërhyjë dhe për të zgjeruar depërtimin e kapitalit amerikan në Bashkimin Evropian (BE).

Nga këndvështrimi i Shteteve të Bashkuara, strategjia e zgjerimit në Evropë është vetëm një pjesë e strategjive globale që rregullojnë marrëdhëniet me Kinën, të cilat ndizen pikërisht në këto vite. Në fakt, midis marrëveshjeve të Minsk-ut dhe ndërhyrjes ruse, në nivel global, ndodhi diçka jo pak e rëndësishme: shpërtheu pandemia, një fenomen tjetër i përshkruar si i papritur dhe i paparashikuar, por sigurisht jo i paparashikueshëm nga qendrat strategjike të kapitalit të madh dhe nga shërbimet e inteligjencës së fuqive kryesore ekonomiko-ushtarake.

Për qëllimet e analizës sonë, aspektet shëndetësore, ligjore dhe morale të menaxhimit të pandemisë janë krejtësisht të parëndësishme. Dimensioni i vetëm që na intereson është ai ekonomik. Nga pikëpamja ekonomike, pandemia është në fakt një mundësi për të përshpejtuar procesin e transformimit teknologjik dhe social në të cilin Shtetet e Bashkuara kanë investuar shumë, por i cili mezi po zhvillohej. Për të plotësuar përgjigjen e pyetjes Përse tani?, në kapitullin e tretë, e zgjeroj horizontin e kritikës dhe flas për marrëdhëniet midis luftës në Ukrainë dhe politikave anti-pandemike, si momente të ndryshme, por të lidhura të strategjisë globale imperialiste të Shteteve të Bashkuara.

Tabloja që shfaqet tregon se, në garën globale mes SHBA-së dhe Kinës, Evropa është në qen-

dër të politikave imperialiste të SHBA-së. Interesi ekonomik-ushtarak në Evropë nuk është aspak i ri, por është pjesë e një procesi të gjatë që filloi në fund të Luftës së Dytë Botërore. Sado kontradiktore t'iu duket atyre që e shohin BE-në si një pol të pavarur ekonomik, të lindur për të rivalizuar Shtetet e Bashkuara, procesi i konvergencës, fillimisht drejt tregut të vetëm dhe më pas drejt monedhës së përbashkët, ndjek një logjikë diametralisht të kundërt. Në fakt, janë pikërisht Shtetet e Bashkuara që shtyjnë në këtë drejtim.

Prandaj, në kapitullin e katërt, analiza kritike e konfliktit ruso-ukrainas bëhet më komplekse pasi i rikthehem historikisht strategjisë së SHBA-së në Evropë. Pikërisht në këtë proces integrimi midis kapitaleve amerikane dhe evropiane, veprimet ekonomike, politike e ushtarake, në dukje kontradiktore, të BE-së dhe shteteve të saj anëtare, fitojnë një koherencë të plotë.

Në kapitullin e fundit, bëj një përmbledhje të ideve të mia dhe nxjerr disa përfundime.

1. Rrënjët historiko-politike të konfliktit

Para se të hyjmë në thelbin e marrëdhënieve midis Rusisë, Ukrainës, Shteteve të Bashkuara dhe BE-së, duhet të çlirohemi nga një paqartësi teorike që karakterizon debatin mbi imperializmin, në lidhje me natyrën imperialiste të Rusisë. Vetëm duke e vendosur konfliktin ruso-ukrainas në kuadrin e duhur teorik është e mundur të rrokët roli i aktorëve, të cilët formalisht nuk janë në terren, por që në realitet janë në qendër të zhvillimeve ekonomiko-ushtarake të të gjithë zonës.

Nga pikëpamja ushtarake dhe ekonomike, për më tepër, është plotësisht e qartë se pas konfliktit ruso-ukrainas qëndrojnë strategjitë e NATO-s dhe BE-së. Dhe është po aq e qartë se NATO-ja nuk është një organizatë mbrojtëse mes të barabartëve, por një organizatë sulmuese e hegjemonizuar nga Shtetet e Bashkuara. Për të kuptuar natyrën e konfliktit në Ukrainë, duhet të rindërtojmë kësaj rolin e NATO-s dhe Shteteve të Bashkuara në Evropë.

Krahas këtyre aktorëve institucionalë, janë edhe kompanitë e mëdha shumëkombëshe, të cilat ndërhyjnë si nëpërmjet fuqisë financiare të investimeve të tyre, ashtu edhe nëpërmjet presionit politik: nga aktiviteti i lobimit të ndikimi në shoqërinë civile, e deri në përcaktimin e ministrave dhe vijës së politikës ekonomike.

Në një kontekst imperialist, strategjitë gjeopolitike të shteteve formohen nga shkrirja e interesave të kapitalit të madh me ato të strukturave politiko-ushtarake. Prandaj, duke parë interesat e këtyre aktorëve të ndryshëm, pak a shumë të dukshme në debatin zyrtar, unë bëj një rilexim të procesit historiko-politik që çon në luftën në Ukrainë.

Fuqitë e mëdha dhe marionetat e imperializmit

Ata që e vendosin konfliktin ruso-ukrainas në kuar-drin e një imperializmi të supozuar rus, bëjnë një gabim të trashë. Ndryshe nga konceptimi gjeopolitik që mbizotëron sot në marrëdhëniet ndërkombëtare, imperializmi nuk është një kontekst në të cilin marrëdhëniet në nivel global midis shteteve rregullohen përmes përdorimit të armëve. Por ai është faza e zhvillimit kapitalist në të cilën kapitalet e mëdha të monopolizuar ua diktojnë ligjin shteteve, për të shtrirë dominimin e tyre, si në nivel kombëtar ashtu edhe në nivel ndërkombëtar. Ushtritë padyshim kanë rëndësi, por motori i procesit është ekonomik, jo ushtarak.¹

Fuqitë kryesore imperialiste në botë janë Shtetet e Bashkuara dhe Kina. Janë ato që konkurrojnë për përvetësimin e vlerës që nxirret në çdo cep të planetit. Në imperializëm, janë marrëdhëniet ekonomike dhe jo ushtarake ato që drejtojnë këtë proces. Nga ky këndvështrim, dy ekonomitë kryesore të botës nuk janë edhe aq të ndryshme: nëse një investitor amerikan ose kinez troket në derë, nuk është aty thjesht për të bërë tregti me përfitim reciprok, por mbi të gjitha për të bërë të mundur depërtimin e kapitalit amerikan dhe kinez në tregje të reja, shfrytëzimin e punëtorëve të rinj dhe përvetësimin e vlerës së prodhuar prej tyre.

Dallimi i vërtetë midis Republikës Popullore të Kinës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës është se e para nuk ka një traditë të luftërave pushtuese, ndërsa e dyta, që nga fundi i Luftës së Dytë Botërore, kanë sulmuar dhjetëra vende dhe kanë marrë pjesë

1 Vladimir Lenin, Imperializmi, faza më e lartë e kapitalizmit, Rilindja, 1985.

pothuajse në të gjithë konfliktet rajonale në çdo cep të tokës. Në fakt, tradita imperialiste e Shteteve të Bashkuara ka rrënjë të largëta dhe është e lidhur pazgjidhshmërisht me rolin e ushtrisë dhe sektorin e armëve. Imperializimi i Kinës, nga ana tjetër, është më i ri dhe zhvillohet vetëm nëpërmjet kanaleve ekonomike, e jo edhe atyre ushtarake.

Kthesa pro-tregut e Kinës merr formë nën presidencën e Deng Xiaoping-ut, i cili gjatë viteve '80 të shekullit të kaluar rrëzon modelin komunist të ndërtuar nga Timonieri i Madh, Mao Tse-Tung, dhe nis një program të gjerë privatizimesh, liberalizimesh dhe hapje ndaj kapitalit të huaj. Në fillim, Kina ishte kryesisht një hapësirë për zgjerimin e kapitalit të huaj. Me kalimin e kohës, kapitali kinez (një kapital pjesërisht multinacional) u bë mjaft i madh e i fuqishëm për të konkurruar me kapitalin perëndimor, dhe sot Kina është i vetmi vend që mund të rivalizojë me Shtetet e Bashkuara.

Edhe në garën ngushtësisht ekonomike, Shtetet e Bashkuara dhe Kina ndjekin metoda të ndryshme: Shtetet e Bashkuara përparojnë me anë të kërcënimeve e sanksioneve kundër atyre që nuk bashkëpunojnë, ndërsa Kina nëpërmjet kontratave dhe investimeve duke i stimuluar të gjithë që të bashkëpunojnë.

Rusia nuk ka asnjë nga tiparet e një fuqie imperialiste, as të llojit amerikan dhe as të llojit kinez. Në aspektin ushtarak, me siguri nuk është e orientuar drejt zgjerimit: bazat kryesore ushtarake në vendet e huaja që i mbetën Ruisë pas rënies së Bashkimit Sovjetik janë në vendet ish-sovjetike (me përjashtim të Sirisë ku prania ruse është kërkuar drejtpërdrejt nga qeveria e Presidentit Bashar al-Assad). Këto nuk janë kurrsesi kryeura për zgjerim të mëtejshëm, por janë ajo që mbetet nga sistemi rus i mbrojtjes, pas zgjerimit të NATO-s.

Por mbi të gjitha, nga pikëpamja ekonomike, ndryshe nga fuqitë imperialiste, të cilat karakterizohen nga eksporti masiv i kapitalit, Rusia eksporton kryesisht mallra (madje shumë). Edhe nga pikëpamja financiare, manovrat e kapitaleve të mëdha ruse jashtë vendit janë më shumë të orientuara drejt sigurimit të flukseve tregtare sesa drejt përgatitjes së zhvendosjes dhe zhvillimit të prodhimit në vendet satelite. Tipike, nga ky këndvështrim, është marrëdhënia midis Gazprom-it (gjiganti energjetik i kontrolluar nga qeveria ruse) dhe GazpromBank-ut, bankës së grupit Gazprom, e treta më e madhe në Rusi, me degë bankash vetëm në Federatën Ruse, por me pjesëmarrje në Bjellorusi (BelgazpromBank) dhe në Zvicër (GazpromBank – Zvicër) që synojnë pikërisht menaxhimin e eksporteve të Gazprom-it.

Në marrëdhëniet me vendet e huaja, Rusia është e orientuar drejt zhvillimit të marrëdhënieve tregtare. Marrëdhëniet financiare janë një domosdoshmëri, jo një objektiv strategjik. Nga pikëpamja tregtare, është gjithashtu e qartë se Rusia ka shumë interes në ruajtjen e marrëdhënieve paqësore dhe të balancuara gjeopolitike. Strategjitë agresive në marrëdhëniet ndërkombëtare nuk janë objektivist në interes të vendit dhe as të kapitaleve të saj.

Tranzicioni i Ruisë në kapitalizëm

Me shpërbërjen e Bashkimit Sovjetik dhe privatizimet e egra të imponuara nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), kemi zhvillimin e një procesi të dyfishtë: brenda formohet një oligarki e korruptuar financiare, në bashkëpunim me Perëndimin, e cila përfiton nga privatizimet duke u pasuruar në dëm të komunitetit; në marrëdhëniet ndërkombëtare, oligarkitë financiare perëndimore shfrytëzojnë mundësinë për të blerë me çmime të volitshme aksione të rëndësishme të të gjitha kompanive strategjike të krijuara në kohën e komunizmit, për t'i menaxhuar së bashku me oligarkët vendas. Rusia, nga ky këndvështrim, të paktën në fillim, për fuqitë imperialiste është mbi të gjitha një terren për t'u pushtuar, por vështirë se mund të karakterizohet si një fuqi imperialiste.

Gjatë tetë viteve të presidencës së Boris Eltsin-it, nga viti 1991 deri në 1999-n, Rusia përçudnohet ekonomikisht, politikisht dhe kulturalisht.

Në vitin 1992, presidenti i parë i Ruisë post-sovjetike nis programin e reformave të kërkuara nga Perëndimi, mes të cilave privatizime të gjithanshme, liberalizime dhe heqje dorë nga planifikimi për t'i lënë hapësirë tregut, duke shkaktuar një krizë të thellë ekonomike në vend. Ideja e shpërndarjes së bonove (tituj të pronësisë së aksioneve të kompanive të privatizuara) tek njerëzit si një mënyrë demokratike e privatizimit bën që të shpërthejnë pabarazitë. Siç pritej, bonot përllahen nga të fortët dhe punëtorëve nuk iu mbetet asgjë: punëtori rus sheh të zhduken shërbimet kryesore sociale falas, të cilat i kishte përfituar gjithmonë në këmbim të një shisheje vodkë, ndërsa klasa e re politike që menaxhon procesin në bashkëpunim me Perëndimin, zbulon luksin e kapitalizmit.

Në vitin 1993, Presidenti sulmon Parlamentin në zbatim të vendimit të tij për shpërndarjen e Dhomave, pa pasur kompetencat kushtetuese. Në vitin 1998, gjatë krizës së rublës, deklaroi default² të borxhit publik, duke e çuar besueshmërinë financiare të vendit në nivelin më të ulët historik. Dhe, menjëherë pas, përpara dorëzimit të pushtetit, nënshkruan marrëveshje të re me FMN-në, me kushte tejet të pafavorshme për popullin e tij.

Problemi qëndron se Presidenti i dytë i Federatës Ruse nuk mendon aspak si paraardhësi i tij: ai synon të bëjë një kthesë politike dhe ekonomike, t'i japë fund diktateve të kapitalit të huaj dhe të ringjallë krenarinë kombëtare. Ardhja e Putin-it në pushtet përmbys shumë procese ekonomike e politike. Dhe qëndrushëmëria e tij në drejtimin e vendit (Putin ka qenë President i Republikës në periudhën 2000-2008 dhe nga viti 2012 e në vazhdim, dhe ka qenë Kryeministër në periudhat 1999-2000 dhe 2008-2012) i rikthen Rusisë lulëzimin ekonomik, dinjitetin

2 Në fushën kompjuterike termi default ka kuptimin e diçkaje që ndodh “automatikisht”, “si zakonisht”, “sipas kushteve të paracaktuara”, dhe është një term kryesisht neutral; kusht funksional i zgjedhur automatikisht nga një program ose sistem kompjuterik, kur nuk ka tjetër udhëzim specifik nga përdoruesi. Ndërsa në gjuhën financiare termi default merr një ngjyrim negativ: d. komunikon kushtin e falimentimit të një banke, kompanie ose të një shteti që nuk ka mundësi të përballojë obligacionet ose nuk ka mundësi të shlyejë borxhet; deklarim i pamundësisë për të paguar, apo për të shlyer. Si shembull i përdorimit të këtoje termi kemi rastin e Greqisë e cila, përballë vështirësive financiare dhe pamundësisë për të shlyer borxhin, mendonte të shpallte default. Tjetër shembull: në gusht të vitit 1971, përballë kërkesave të bankave qendrore të Zvicrës, Belgjikës dhe Holandës, për konvertim të dollarëve në ar, Shtetet e Bashkuara u gjendën në pamundësi për të realizuar kërkesën, duke u detyruar të heqin konvertimin e dollarit. Me ndërprerjen e konvertimit të dollarit në ar, Shtetet e Bashkuara u dhanë fund marrëveshjeve të Bretton Woods-it, duke shpallur kështu default-in më të rëndë në histori. (shën. i përkth.)

e popullit të saj dhe besueshmërinë dhe respektin në kontekstin ndërkombëtar. Vetë Partia Komuniste Ruse, pavarësisht se është forca kryesore alternative ndaj Putin-it, është shpesh në krah të Presidentit në vendimet ndërkombëtare.

Me Putin-in, blerjet me çmime të lira nga kapitali perëndimor marrin fund, dhe politika rifillon të luajë një rol më aktiv në mbrojtjen e interesave kombëtare dhe në qeverisjen e ekonomisë dhe ndërmarrjeve strategjike.

Që nga rënia e Bashkimit Sovjetik, Rusia është dobësuar si ekonomikisht ashtu edhe ushtarakisht. Por Rusia e Putin-it ka lënë pas poshtërimet e pësura gjatë tetë viteve të para të kapitalizmit, me shpërbërjen e aparatit ekonomik dhe politik të Bashkimit Sovjetik nga presidenti pro perëndimor. Rusia, tashmë, me të gjitha kontradiktat e saj të brendshme, është rimëkëmbur ndërkombëtarisht. Ekonomikisht, është e qëndrueshme dhe pretendon të hyjë në diskutime mbi baza të barabarta me partnerët perëndimorë. Ushtarakisht, nëse nuk i ka sigurisht mjetet për të zhvilluar një luftë botërore, ajo është ende në gjendje të mbrojë interesat e saj kombëtare.

Për të kuptuar vërtetë tiparet imperialiste të konfliktit ruso-ukrainas, nuk duhet të shikojmë nga lindja, por nga perëndimi.

Ekspansioni i NATO-s në Evropë

Për të arritur tek origjina e konfliktit ruso-ukrainas dhe për të kuptuar lidhjet e tij me ekspansionizmin amerikan në Evropë, le të fillojmë me disa referenca të shpejta historike.

Deri në vitin 1991, Ukraina është pjesë e Bashkimit të Republikave Socialiste Sovjetike dhe quhet Republika Socialiste Sovjetike e Ukrainës. Pas rënies dhe shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik, Ukraina bëhet një republikë e pavarur dhe sakaq bëhet gjithashtu një objekt interesi për NATO-n.

Është me rëndësi të kujtojmë se më 17 mars 1991 u mbajt një referendum popullor për ruajtjen e Bashkimit Sovjetik, i cili sanksionoi fitoren dërrmuese të Po-së (78% pro dhe 22% kundër, me një pjesëmarrje në votim prej 80%).

Por vullneti i popullit, siç e dimë tashmë, nuk ka shumë rëndësi kur Perëndimi eksporton demokraci. Kështu, nën shtysën e Shteteve të Bashkuara dhe Komunitetit Evropian (pararendës i BE-së), Bashkimi Sovjetik shpërbëhet dhe menjëherë më pas fillon procesi i aneksimit të republikave post-sovjetike në BE dhe NATO.

Dy proceset e zgjerimit të BE-së dhe NATO-s vazhdojnë paralelisht edhe pse me shpejtësi të ndryshueshme.³

Akti i parë përgatitor i këtij procesi të dyfishtë ndodh me aneksimin e Republikës Demokratike Gjermane në Gjermaninë Perëndimore, e cila u zhvillua më 3 tetor 1990, pak para se të lindë BE-ja (traktati i BE-së do të nënshkruhet në Maastricht më 7 shkurt 1992, pas shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik), e cila në fakt, e zgjeron komunitetin evropian dhe e fut Gjermaninë Lindore në Paktin e Atlantikut pa e rritur numrin e shteteve anëtare në të dy organizatat.

Një vit më pas, Polonia, Hungaria dhe Republika Çeke formojnë *grupin e Visegrád-it* (të cilit më vonë i bashkohet edhe Sllovakia) me synimin për t'u bashkuar me BE-në dhe NATO-n. Hyrja zyrtare e këtyre tre vendeve në NATO ndodh më 12 mars 1999 në Samitin e Washington-it, ndërkohë që bombarduesit e NATO-s tashmë po ndezin motorët e tyre kundër Jugosllavisë.

Bombardimet e NATO-s kundër vendit socialist më parëndimor në Evropë fillojnë më 24 mars dhe vazhdojnë deri më 7 maj dhe kanë një vlerë të fortë demonstrative: në fakt, NATO-ja tregon se mund të lëvizë lirshëm në Evropë, edhe pa marrë parasysh traktatet e OKB-së (ku Rusia dhe Kina vendosin veton ndaj operacionit) dhe të vetë NATO-s (e cila, teorikisht, ka vetëm qëllime mbrojtëse). Në mënyrë që mesazhi të arrijë larg, gjatë bombardimeve kirurgjikale të udhëhequra nga SHBA-ja (siç quheshin lëshimet e raketave dhe bombave në atë kohë), pesë bomba precizioni goditën ambasadën kineze në Beograd, duke e shkatërruar atë.

Në Samitin e Washington-it, përcaktohen edhe udhëzimet për anëtarësimin e Shqipërisë, Bullgarisë, Estonisë, Letonisë, Lituanisë, Maqedonisë së Veriut, Rumanisë, Sllovakisë dhe Sllovenisë. Rusia e kundërshton fuqishëm, por pa arritur ndonjë rezultat, veçanërisht në lidhje me hyrjen në Paktin e Atlantikut të tre shteteve baltike, ish-republika sovjetike, Estonisë, Letonisë dhe Lituanisë, të cilat kufizohen drejtpërdrejt me Rusinë.

Në maj të vitit 2000, pasi çështja jugosllave u zgjidh, me copëtimin në republika të pavarura, Kroacia iu bashkua këtyre vendeve për të formuar *Grupin e Vilnius-it*, një organizatë që synonte pikërisht hyrjen në aleancën ushtarake të komanduar nga Shtetet e Bashkuara.

Në vitin 2009, pas shpalljes së pavarësisë nga Serbia në 2006-n, Mali i Zi gjithashtu aplikoi zyrtarisht për anëtarësim në NATO.

Procesi i anëtarësimit në Paktin e Atlantikut zhvillohet në faza të ndryshme: më 29 mars 2004 zyrtarizohet hyrja e Bullgarisë, Estonisë, Letonisë, Lituanisë, Rumanisë, Sllovakisë dhe Sllovenisë; më 1 prill 2009, hyjnë Shqipëria dhe Kroacia; më 5 qershor 2017, shtohet Mali i Zi dhe, më 27 mars 2020, Maqedonia e Veriut.

Në vitin 2022, kur gjendemi tashmë në një luftë të hapur mes Rusisë dhe Ukrainës, Bosnja e Hercegovina kërkon zyrtarisht t'i bashkohet aleancës, duke përfunduar kështu procesin e gjatë të integritimit që filloi si pasojë e agresionit të NATO-s në vitin 1995 – operacioni “Deliberate Force” – me të cilën Shtetet e Bashkuara filluan të rishënojnë kufijtë e Evropës fill të nesërmen e rënies së socializmit real. NATO-ja gjithashtu insiston në përshpejtimin e pranimit të Gjeorgjisë dhe të vetë Ukrainës, tashmë në listën e pritjes prej më shumë se dhjetë vitesh. Pa e tjerë gjatë, më në fund aplikojnë për t'u anëtarësuar në NATO edhe Finlanda e Suedia, të cilat janë të shqetësuara, sipas zëdhënësve të tyre, për agresionin rus.

Në kuadrin e zhvillimit të NATO-s, Ukraina është vetëm një prej gurëve strategjikë në afrimin me kufijtë e Rusisë. Objektivisht, cilido qoftë objektivi ushtarak, ekonomik apo politik i këtij procesi, mjafton të shikoni një hartë gjeografike për të kuptuar se Rusia ka një problem për sa i përket sigurisë kombëtare.

Situata në Ukrainë

Me rënien e Bashkimit Sovjetik në vitin 1991, Partia Komuniste e Ukrainës, deri atëherë parti e vetme, u shpall e jashtëligjshme. Partia, megjithatë, ruan një mbështetje të fortë në zonat e industrializuara dhe në lindje të vendit. Ligji revokohet më pas, dy vjet më vonë, megjithëse antikomunizmi mbetet faktori politik më i rëndësishëm përmes të cilit Perëndimi mbështet transformimin e vendit dhe të gjithë zonës. Natyrisht, faktori kryesor ekonomik gjendet, nga ana tjetër, në dëshirueshmërinë e kompanive shtetërore të cilat privatizohen me shpejtësi, duke ofruar mundësi joshëse për kapitalin e huaj për përvetësimin e xhevahirëve shtetërore të ekonomisë post-sovjetike me çmime të volitshme.

Në pak kohë, lind një klasë e re afaristësh politiko-sipërmarrës, e lidhur me Shtetet e Bashkuara dhe BE-në, dhe rritet depërtimi ekonomik e kulturor i Perëndimit. Si kudo, me kalimin në kapitalizëm, lindin të pasurit e rinj (politikanë të korruptuar dhe sipërmarrës-afaristë) dhe, bashkë me ta, të varfërit e rinj (gjithë të tjerët), të cilët shohin zhdukjen e shërbimeve thelbësore të ofruara nga shteti dhe krimin e kompanive private në kërkim të fitimit.

Në vitin 1994 dhe 1999, Leonid Kucma, një ish-anëtar i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Ukrainës, fiton zgjedhjet. Në kontekstin e ri politik, Kucma është larguar me vendosmëri nga marksizmi dhe është kthyer në mbështetje të tregut. Mirëpo ai nuk është një tifoz i vërtetë i Perëndimit dhe, në marrëdhëniet ndërkombëtare, është afër me Rusinë.

Në vitin 1998, Ukraina merr kështu kredinë e saj të parë nga FMN-ja prej 2.2 miliardë dollarësh, e cila shkon në 2.6 miliardë vitin pasues, pas angazhimit

të saj për të zbatuar një plan të detajuar reformash pro-tregut.⁴ Megjithatë, Kucma, në vitin 2003, nënshkruan një traktat për krijimin e një zone të vetme ekonomike me Rusinë, Bjellorusinë dhe Kazakistanin, e cila shkakton zemërimin e Perëndimit.

Në zgjedhjet e vitit 2004, përballen Viktor Yanukovych-i, me origjinë nga Donbass-i, ish-anëtar i Partisë Komuniste Sovjetike dhe kryeministër i qeverisë në largim të presidentit Kucma, i mbështetur nga Rusia, dhe lideri i opozitës Viktor Yushchenko, i mbështetur nga BE-ja dhe nga Shtetet e Bashkuara.

Rezultati i zgjedhjeve i jep fitoren Yanukovych-it. Yushchenko-ja sidoqoftë nuk është dakord dhe kundërshton rezultatin zgjedhor. Nga krahu i tij ka shoqërinë civile: një rrjet shoqatash dhe fondacionesh të cilat, me kalimin e viteve, kanë marrë fonde nga *Open Society Foundations* (Fondacionet e Shoqërisë së Hapur) të George Soros-it – një nga njerëzit më të pasur në botë dhe një nga njerëzit më të paskrupullt e të fuqishëm të financave botërore – me qëllim mbrojtjen e interesave perëndimore dhe promovimin e vlerave të tregut dhe të antikomunizmit.

Kështu zhvillohet i ashtuquajti *Revolucion Portokalli*, i cili e shtyn Gjykatën Supreme të Ukrainës të anulojë rezultatin zgjedhor dhe të thërrasë zgjedhje të reja. Rezultati i raundit të ri zgjedhor përmbys rezultatin e mëparshëm dhe Yushchenko-ja bëhet president.

Presidenti i ri nis menjëherë reformat strukturore të kërkuara nga institucionet financiare ndërkombëtare, me pasoja të rënda sociale dhe ekonomike për të gjithë popullsinë. Në vitin 2008, Ukraina merr një kredi të dytë nga FMN-ja, këtë herë me një shumë më të madhe: 16.4 miliardë dollarë.⁵

Megjithatë, gjatë mandatit të tij, Yushchenko-ja nuk arrin ta zbatojë plotësisht paketën e reforma-

4 IMF, Ukraine Memorandum of Economic policies.

5 IMF, Helping Ukraine avoid a hard landing .

ve të diktuar nga FMN-ja, për shkak të opozitës së drejtuar nga Yanukovych-i. Në mënyrë të veçantë, për shkak të katastrofës ekonomike dhe sociale të vendit, qeveria detyrohet të bëjë një rritje të pagave e të pensioneve minimale, të cilave FMN-ja i përgjigjet duke ndaluar disbursimet në fund të vitit 2009.⁶

Megjithatë, të paktën në planin politik dhe kulturor, presidenti pro-perëndimor synon të bëjë një kthesë përfundimtare. Përpara mbylljes së mandatin e tij, më 22 janar 2010, ai bën një nga gjestet simbolike që e përshkruan më së miri distancimin e tij nga komunizmi: ai i dha titullin Hero i Ukrainës Stepan Bandera-s, kriminel lufte, bashkëpunëtor i Gjermanisë naziste kundër Bashkimit Sovjetik gjatë Luftës së Madhe Patriotike (me këtë shprehje e kanë quajtur gjithmonë republikat sovjetike, veçanërisht ato të Frontit Perëndimor, Luftën e Dytë Botërore).

Kthesa ekonomike dhe politike drejt modelit të ri demokratik perëndimor ndërpritet pikërisht nga procesi zgjedhor. Në zgjedhjet e vitit 2010, në fakt, Yanukovych-i fiton sërish, këtë herë pa mundur askush të sajojë protesta apo akuza për mashtrim, duke qenë se i gjithë procesi zgjedhor zhvillohet nën mbikëqyrjen e kujdesshme të vëzhguesve ndërkombëtarë.

Sapo mori detyrën, Yanukovych-it iu desh të përballej me presionin e Perëndimit, i cili qysh në vitin 2004 kishte kontribuar në rrëzimin e tij. Në të njëjtën kohë, ai nuk duket i gatshëm të miratojë masat jopopullore të kërkuara nga BE-ja. Fakti është se në korrik rifillojnë negociatat për një kredi të tretë nga FMN-ja. Ndër kushtet e kredisë prej 15 miliardë dollarësh, Fondi i kërkoi qeverisë ukrainase të mbledhë para përmes reformës së pensioneve – duke rritur moshën e pensionit dhe zgjatur periudhën e kontributeve – dhe duke iu hequr familjeve

6 Reuters, UPDATE 2, Ukraine seeks to overhaul IMF deal, tough talks ahead.

subvencionet shtetërore për gazin natyror – me një rritje prej 50% të çmimeve në ngarkim të përdoruesit – dy çështje të cilat Yanukovych-i i ka kundërshtuar gjithmonë me vendosmëri.⁷

Paralelisht, Yanukovych-i zhvillon marrëdhëniet me Rusinë dhe, në vitin 2013, intensifikon marrëdhëniet tregtare me Bashkimin Doganor Euroaziatik: zona e tregtisë së lirë e formuar nga Rusia, Bjellorusia dhe Kazakistani, e cila, në projektin fillestar të bllokuar nga *Revolucioni Portokalli*, përfshinte edhe Ukrainën.

Kushtet e vendosura nga FMN-ja nuk do të respektohen kurrë dhe, në dhjetor 2013, ndërsa NATO-ja, BE-ja dhe FMN-ja rrisin presionin ndaj Ukrainës, dialogu ndërpritet papritur, dhe nga diplomacia ndërkombëtare kalohet në trazirat në rrugë.

Grushti i shtetit i vitit 2014

Marrëdhëniet e Ukrainës me BE-në dhe institucionet financiare ndërkombëtare janë në qendër të ngjarjeve që çojnë në grushtin e shtetit të vitit 2014. BE-ja shtyn në mënyrë që Ukraina të fillojë procesin e anëtarësimit, duke vendosur megjithatë kushte shumë të ashpra: një axhendë të gjerë reformash ekonomike, gjyqësore dhe financiare; përkrahjen e politikës së jashtme dhe të sigurisë së BE-së; krijimi i një zone të tregtisë së lirë dhe aksesin në kreditë e reja të FMN-së, duke e rritur tej mase borxhin e vendit.

Ndryshe nga vendet që përgjithësisht i drejtohen FMN-së, Ukraina nuk është pa alternativa. Prej kohësh, Moska flirton me Kievin me propozime tërheqëse ekonomike për të dekurajuar afrimin e saj me BE-në dhe NATO-n. Me rritjen e presionit përëndimor ndaj Ukrainës, shoqëruar me kushte gjithnjë e më të ashpra për qeverinë ukrainase, Rusia luan në drejtim të kundërt dhe hedh në tryezë propozime ekonomike gjithnjë e më bujare. Kështu, ndërkohë që BE-ja dhe NATO-ja prezantojnë planin e kasapit social dhe nënshtrimit ndaj interesave të jashtme, Rusia i paraqet vendit fqinj ofertën e një pakete ndihmash me vlerë 15 miliardë dollarë dhe një zbritje prej 33% në gazin natyror si bonus hyrjeje në procesin e integritit ekonomik në zonën euroaziatike, pa asnjë ndërhyrje në çështjet e politikave të të ardhurave dhe privatizimeve, të cilat, sipas propozimit rus, do të mbeten çështje të brendshme të Ukrainës.⁸

Është e qartë se nga pikëpamja ekonomike nuk ka asnjë krahasim mes dy propozimeve. Por Përdimimi nuk ka ndërmend ta blejë Ukrainën në ankand. E kërkon me kushtet që i ka përcaktuar vetë, ato të fitimit maksimal për kompanitë amerikane dhe evropiane. Për këtë ar-

8 United Nations University, What do the World Bank and IMF have to do with the Ukraine conflict?

sye, nuk synon të bëjë lëshime dhe nuk tenton për rrjedhojë asnjë negociim. Për të vendosur kushtet e veta, Perëndimi nuk bën premtime, por kërcënime, përfshirë atë të ndërprerjes së procesit të integritit në Evropë, duke e zhvendosur problemin nga terreni ekonomik në atë politik.

Presidenti Yanukovych, në këtë pikë, nuk ka më hezitime as nga pikëpamja ekonomike, as nga pikëpamja politike: më 21 nëntor 2013, ai pezullon nënshkrimin e marrëveshjes së asociimit me BE-në, braktis tryezën e bisedimeve me FMN-në dhe i drejtohet Rusisë.

Edhe këtë herë nisin menjëherë protestat antiqeveritare, sipas skenarit. Protesta merr formë në Sheshin Maidan (Sheshi Pavarësia) dhe sakaq përhapet në nivel mediatik si lëvizja *EuroMaidan*, një term i prezantuar nga *Radio Free Europe*, një nga krijimet e *Open Society* në Ukrainë që nga viti 1994.

Krahasuar me *Revolucionin Portokalli* të dhjetë viteve më parë, procesi i militarizimit të forcave antiqeveritare është rritur ndjeshëm. Gjatë dhjetë viteve të fundit, mbështetja ekonomike e kapitalit perëndimor për shoqërinë civile ukrainase nuk ka qenë e kufizuar në sferën kulturore e mediatike, por ka favorizuar edhe formimin e grupeve të dhunshme dhe skuadrave paraushtarake.

Brenda pak ditësh, protestat degjenerojnë në dhunë, me snajperë që qëllojnë mbi turmën dhe sulme ndaj ndërtesave qeveritare dhe policisë. Demonstruesit paqësorë marginalizohen nga protestat dhe në rrugë zbresin batalionet paraushtarake filonaziste. Më 8 dhjetor, militantët e *Pravi Sector* ("sektori i djathtë", parti politike dhe organizatë paraushtarake e ekstremist të djathtë) rrëzuan monumentin e Leninit në një shesh të rëndësishëm në Kiev, si një gjest simbolik që është pjesë e procesit revizionist të nisur nga Yushchenko-ja.

Demonstratat kthehen në përleshje të armatosura, të vdekurit numërohen me qindra dhe më në fund,

më 22 shkurt 2014, Yanukovych-i u shkarkua nga posti i Presidentit.

Kundër grushtit të shtetit dalin sakaq Krime-ja dhe rajoni i Donbass-it.

Më 16 mars, pas një referendumit të fituar nga separatistët me 97%, Krimeja shpalli pavarësinë e saj dhe kërkoi aneksimin në Federatën Ruse. Referendume të ngjashme mbahen edhe në Lugansk e Donetsk, në Donbass. Edhe këtu referendumet fitohen nga separatistët me rreth 80% të votave. Më pas vijnë shpalljet e pavarësisë së republikave popullore të Donetsk-ut dhe Lugansk-ut.

Lëvizja kundër grushtit të shtetit, e udhëhequr nga Partia Komuniste dhe forca të tjera antifashiste, po rritet edhe në zona të tjera të vendit. Represioni nga grupet fashiste është i pamëshirshëm. Më 2 maj 2014 dhuna kthehet në barbari.

Partia Komuniste organizon një iniciativë për të bashkuar forcat kundër grushtit të shtetit përpara Shtëpisë së Sindikatave në Odessa, një qytet port në Detin e Zi. Një turmë fashistësh, të udhëhequr nga *Pravi Sector* dhe *Svoboda* (parti politike e ekstremit të djathtë, gjithashtu e frymëzuar nga ideologjia naziste), vendos të veprojë: pasi i detyrojnë demonstruesit të strehohen brenda Shtëpisë së Sindikatave, neo-nazistët i vënë zjarrin ndërtesës dhe qëllojnë mbi ata që përpiqen të shpëtojnë veten. Bilanci është i rëndë: dhjetëra burra, gra dhe fëmijë të karbonizuar e të vrarë me gjakftohtësi.

Në Perëndim, për ditë të tëra nuk jepet as lajmi, dhe kur pamjet e masakrës kanë marrë dhenë, sidomos falë mediave ruse, televizionet dhe gazetat perëndimore nxitojnë të raportojnë se ishte një aksident dhe se zjarri paska qenë vënë nga vetë demonstruesit, të cilët, nga brenda Shtëpisë së Sindikatave, dyshohet se paskan sulmuar forcat skuadraste me bomba molotov, të cilat kanë

përfunduar gabimisht në vetë ndërtesën.⁹

9 Pandora TV, Programo programmato. Bekkaccia, Maïa and the Red army choir, The scream of Odessa, Anti-fascist resistance.

Ndryshimi i regjimit

Zgjedhjet e reja në Ukrainë mbahen më 25 maj 2014 në një situatë kaosi dhe dhune. Janë të përjashtuara Krime-ja dhe republikat e Donbass-it, të shpallura tashmë të pavarura (të dhëna të pranuar në mënyrë të heshtur nga qeveria e Kievit në numërimin e përqindjes së votave krahasuar me totalin e elektoratit). Shumë militantë politikë merren peng, rrihen dhe kërcënohen nga skuadrat fashiste, kandidaturat shqyrtohen mbi baza politike, me përjashtime të rëndësishme, edhe nga ish-deputetët. Natyrisht, të gjithë komunistët dhe sindikalistët më aktivë janë të përjashtuar.

Zgjedhjet fitohen nga Petro Poroshenko-ja, i Partisë së Solidaritetit Evropian (qendër e djathtë), një oligark me aksione të rëndësishme në sektorët e medias, manufakturës, bujqësisë dhe financës. Vetëm një javë pas marrjes së detyrës, Poroshenko pret një delegacion të FMN-së për të diskutuar kushtet e një kredie të re prej 17.5 miliardë dollarësh. Ndër reformat më urgjente, Fondi insiston në liberalizimin e shitjes së tokës bujqësore, përveç reformave të zakonshme strukturore në kurriz popullsisë.¹⁰

Bëhet fjalë për një çështje shumë delikate në të cilën kompanitë shumëkombëshe janë fokusuar që nga rënia e Bashkimit Sovjetik. Por që bëhet gjithnjë e më e rëndësishme dora-dorës me integrimin e Ukrainës në BE dhe me zhvillimin e projektit të shumëkombësheve bioteknologjike për të marrë nën kontroll bujqësinë e Ukrainës dhe për të depërtuar në BE, ku legjislacioni kundër OMGJ-ve përbën një pengesë serioze për zhvillimin e agrobiznesit shumëkombësh.¹¹

10 IMF, Press release: IMF Executive Board approves 4-Year US\$17.5 billion extended fund facility for Ukraine.

11 Oakland Institute, The corporate takeover of Ukrainian agriculture. Oakland Institute, Walking on the west side.

Gjatë tranzicionit në kapitalizëm, parcelizimi dhe rishpërndarja e tokave shtetërore kanë shkaktuar një rënie drastike të prodhimit dhe produktivitetit. Në të njëjtën kohë, kjo ishte e vetmja mënyrë për të shpronësuar shtetin ukrainas nga tokat e tij, pa u pushtuar ushtarakisht nga ushtritë e huaja. Për të mos lejuar që tokat bujqësore të përfundonin tërësisht në duart e të huajve, krijimi i të drejtave të reja të pronësisë mbi parcelat individuale u shoqërua me ndalimin e tregtimit të tyre. Edhe ëndërrimtarët më naivë të tregut të lirë e dinin në fakt se në një kontekst tejet asimetrik për sa i përket shpërndarjes së pasurisë, krijimi i një tregu të vërtetë toke do të kishte nënkuptuar shpronësim të egër të tokës ukrainase nga kompanitë shumëkombëshe.

Tani, më në fund, me liberalizimin e shitjes së tokave bujqësore, kompanitë shumëkombëshe mund të blejnë tokë të shitur nën çmim, në një shtet në krizë, dhe të përfitojnë nga legjislacioni i posaçëm ukrainas për të anashkaluar ligjet për plehëruesit dhe organizmat e modifikuar gjenetikisht. Dhe, nëpërmjet integritit në BE, të futen në të gjithë Bashkimin Evropian.

Edhe Banka Botërore i bashkohet korit të elozheve për angazhimin e autoriteteve ukrainase në zhvillimin e një programi reformash gjithëpërfshirëse dhe shpall dhënien e një paketë ndihme prej 3.7 miliardë dollarë të tjerë.¹²

Në 27 qershor, më në fund, Poroshenko-ja nënshkruan marrëveshjen e asociimit me BE-në dhe rithekson synimin e tij për t'u bashkuar me NATO-n.¹³ Në më pak se një muaj, Presidenti i ri largon kësisoj çdo paqartësi mbi kursin e ri ekonomik dhe pozicionin ndërkombëtar të vendit.

12 World Bank, Reforms critical for Ukraine to improve living standards.

13 BBC, EU signs pacts with Ukraine, Georgia and Moldova.

Në planin ekonomik, kthesa pro-evropiane dhe largimi nga Rusia i imponojnë popullit ukrainas sakrificat të rënda, duke filluar me rritjen 450% të tarifave të gazit. Së pari, nuk ka më ulje të çmimeve të ofruara deri tani nga Rusia për ish motrën e saj sovjetike. Tani, më në fund, vendi është i lirë nga varësia prej Rusisë, dhe gazi e nafta (ruse) arrijnë përmes BE-së, e cila ka pak zbritje për të ofruar dhe që në të vërtetë përbën një ndërmjetës të padobishëm nga pikëpamja e çmimit përfundimtar. Së dyti, qeveria e re pro-perëndimore synon të heqë çdo formë të furnizimit të drejtpërdrejtë ose të subvencionimit të shtetit për nevojat bazë, nga uji te energjia, sepse në Ukrainën e re demokratike mallrat paguhën me para në dorë dhe me çmimet e tregut.

Me sistemimin e çështjeve ekonomike, Poroshenko-ja kalon në çështjet thellësisht politike. Më 15 maj 2015, nis procesi i dekomunistizimit. Paketa e re ligjore parashikon heqjen e të gjitha simboleve komuniste dhe të Bashkimit Sovjetik. Mijëra monumente shkatërrohen, dhjetëra qytete dhe fshatra janë të detyruar të ndryshojnë emrat e tyre, nën kërcënimin e sanksioneve nga qeveria e Kievit. Partia Komuniste e Ukrainës, Partia Komuniste e Ukrainës (e re) dhe Partia Komuniste e Punëtorëve dhe Fshatarëve ndalohen, dhe çdolloj partie e ideologjisë komuniste nuk lejohet të marrë pjesë në zgjedhje.¹⁴

Poroshenko-ja kundërshton gjithashtu me forcë shpalljen e pavarësisë së republikave të Donbass-it dhe nisi një fushatë ushtarake intensive në rajon nën komandën e Batalionit ultra-nacionalist Azov dhe Pravi Sektor.

14 Challenge, Ukraine's decommunization and the rise of fascism.

Formimi i qeverisë së re të grushtit të shtetit

Qeveria e re dhe sistemi i ri institucional i Ukrainës formohen mbi shtysën e shoqërisë civile e cila që në fillim ka mbështetur shkarkimin e Presidentit të zgjedhur në mënyrë legjitime. Nuk bëhet fjalë aspak për shoqata të vogla spontane, të lindura në strukturën sociale dhe kulturore të vendit si një shtytje nga poshtë që synon një demokraci më pjesëmarrëse, por për organizata joqeveritare të krijuara nga perëndimi dhe të financuara ndër vite me kapital të huaj, nën drejtimin e Soros-it, për ta kthyer vendin nën interesat e Perëndimit. Veprimtaria e filantropit antikomunist nuk zhvillohet fare në hije. Përkundrazi, është vetë ai që mburret se ka kontribuar në rënien e diktatorit pro-rus dhe se mobilizon ushtrinë e tij financiare për t'i treguar rrugën qeverisë së re.

Ukraina ka qenë nën shënjestrën e Soros-it që para rënies së Bashkimit Sovjetik. Në vitin 1990, Soros-i themeloi Fondacionin Ndërkombëtar të Rilindjes në Ukrainë (*International Renaissance Foundation*) si pjesë integrale e *Shoqërisë së Hapur*, tani e pranishme në më shumë se tridhjetë vende të botës, veçanërisht në Evropën Qendrore e Lindore dhe në ish-Bashkimin Sovjetik. Sipas të dhënave të siguruara nga *Renaissance*, në këto tridhjetë vjet fondacioni ka financuar më shumë se 9000 projekte, për një vlerë prej më shumë se 230 milionë dollarësh në mbështetje të individëve dhe organizatave në mbrojtje të të drejtave të njeriut, mediave antiqeveritare dhe kulturës antikomuniste.¹⁵ Projektet përfshijnë reformën e sistemit arsimor, sistemin shëndetësor, siste-

15 International Renaissance Foundation, About us.

min ligjor dhe, në përgjithësi, çmontimin e sistemit të shërbimeve sociale të Bashkimit Sovjetik. Në vitin 2014, *Renaissance* është mbështetësi më i zellshëm i marrëveshjes me BE-në dhe merr pjesë aktivisht në formimin e qeverisë së re dhe asetit të ri të pushteteve.

Sipas *Institute for new economic thinking*, një institut i krijuar nga Soros-i në mes të krizës financiare 2007-2009, arritja më e rëndësishme e *Renaissance* në Ukrainë është krijimi i Këshillit Kombëtar për Reformat, një institucion qeveritar i themeluar në gusht 2014 me urdhër të Presidentit Poroshenko. Ky Këshill, pjesë integrale e të cilit është shoqëria civile, financohet nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, *Fondacioni Renaissance* dhe qeveria suedeze, dhe ka detyrë planifikimin, nxitjen dhe monitorimin e procesit të reformave praktikisht në çdo fushë juridike, ekonomike dhe ushtarake: që nga reforma e forcave të rendit, e ligjeve kundër korrupsionit dhe të gjithë sistemit gjyqësor të politikave energjetike, bujqësore, arsimore dhe shëndetësore, nga reforma e taksave dhe pensioneve të privatizimi dhe derregullimi, nga reforma e sistemit financiar dhe e sistemit kombëtar të ajo e sistemit të mbrojtjes dhe sigurisë. Drejtuesi i tij është ish-administratori i deleguar i *Microsoft Ukraine*, Dmitro Shymkiv.¹⁶

Krijimi i Këshillit Kombëtar për Reformat është vetëm një nga kanalet nëpërmjet të cilit shoqëria civile dhe komuniteti ndërkombëtar fitojnë një njohje formale të rolit të tyre në jetën politike të vendit. Paralelisht luhet në fakt edhe loja për postet në qeverinë e re.

Emrat e ministrave të qeverisë së re të grushtit të shtetit dalin si rezultat i një procesi përzgjedhjeje të tipit korporativ, të kryer nga dy agjensi përzgjedhëse të personelit, *Pedersen & Partners* dhe

¹⁶ Institute for New Economic Thinking, Why this time is different for Ukraine.

Korn Ferry, të punësuar, pa habinë e askujt, nga *Fondacioni Renaissance*.¹⁷ Dy kompanitë përzgjedhëse identifikojnë së pari kandidatë të mundshëm midis të huajve të pranishëm në Kiev dhe midis anëtarëve të komunitetit ukrainas që punojnë në Kanada, Shtetet e Bashkuara dhe Mbretërinë e Bashkuar. Më pas, përmes intervistave ngushtojnë listën e ngushtë në 24 kandidatë, të përshtatshëm, sipas dy kompanive, për të luajtur rolin e ministrit apo për të mbajtur poste të larta drejtuese.

Sipas këshillave të dhëna nga dy kompanitë shumëkombëshe, për të mirën e Ukrainës, ministritë ekonomike duhet të shkojnë në duart e amerikanëve. Te Financat këshillohet amerikania me origjinë ukrainase Natalia Jaresko, administratore e deleguar e një fondi investimi amerikan. Figura më e mirë politiko-profesionale për Ministrinë e Ekonomisë është një bankier lituanëz investimesh, Aivaras Abromavicius, nga Departamenti Amerikan i Shtetit.

Një ministër i tretë i jashtëm në qeverinë e Ukrainës është gjeorgjiani Alexander Kvitashvili, të cilit i shkon Ministria e Shëndetësisë, një post që ai e kishte mbajtur më parë në qeverinë e Tbilisi-t. Në listën e të huajve janë edhe disa persona në poste drejtuese, ndonëse në nivel më të ulët se ai i ministrit.

Për miratimin e listës së ministrave të propozuar nga agjencitë amerikane të përzgjedhjes, qeveria e Poroshenko-s, e zgjedhur zyrtarisht me mbështetjen e nacionalistëve, iu ofron menjëherë shtetësinë ukrainase ministrave dhe liderëve të rinj të jashtëm.

Por prania e huaj në dinamikën e brendshme të Ukrainës nuk ka të bëjë vetëm me burrat me kostum e kollare, por edhe atyre të kamufluar. Në fakt, mes

17 Il Sole 24 Ore, L'Ucraina vara un governo con ministri stranieri (selezionati da cacciatori di teste).

batalioneve më agresive pro-qeveritare ka shumë të huaj të cilët, në këtë pikë, është më mirë të integrohen në forcat institucionale. Prandaj, dhënia e shtetësisë ukrainase shtrihet edhe për mercenarët e huaj që luftojnë përkrah trupave të Kievit kundër separatistëve dhe agresorëve rusë.

Për të falënderuar për bashkëpunimin, pikërisht në ditën e prezantimit të qeverisë së re properëndimore, ministrat e jashtëm të vendeve të NATO-s njoftuan të gjithë së bashku masat e reja të mbështetjes ekonomike dhe ushtarake për Kievin. Dhe, për të përsëritur se ndërhyrja nuk është një gjest i thjeshtë miqësie ndaj Ukrainës, por ka një vlerë të qartë anti-ruse, përfitojnë nga rasti për të akuzuar Moskën se dëshiron të parandalojë tranzicionin drejt demokracisë në vendin fqinj.¹⁸

18

NATO, Wales Summit Declaration.

Marrëveshjet e Minsk-ut

Më 5 shtator 2014, ndërsa ushtria e Kievit, e mbështetur nga batalionet naziste, rrethoi republikat popullore të Donbass-it, të vetëshpallura të pavarura, zëvendës-presidenti ukrainas Kucma, ambasadori rus Mikhail Zurabov, kreu i Republikës Popullore të Donetsk-ut Aleksandër Zakharchenko dhe kreu i Republikës Popullore të Lugansk-ut Igor Plotnitsky takohen në Minsk të Bjellorusisë për të nënshkruar një protokoll të përbashkët me ndërmjetësimin e OSBE-së.¹⁹

Protokolli parashikon: armëpushimin e menjëhershëm, respektimin nga Ukraina të “statusit të përkohshëm të vetëqeverisjes lokale në disa zona të Donetsk-ut dhe rajonit të Lugansk-ut”, monitorimin e gjendjes së kufijve midis Ruisë dhe Ukrainës nga OSBE-ja, lirin e pengjeve dhe personave të ndaluar ilegalisht, shpalljen e një ligji që ndalon vazhdimin e luftës në rajonet e Donetsk-ut dhe Lugansk-ut, miratimin e masave për zgjidhjen e krizës humanitare në Donbass dhe largimin e formacioneve ushtarake të paligjshme dhe mercenare nga territori i Ukrainës. Dy javë pas nënshkrimit të protokollit, palët nënshkruajnë edhe një memorandum zbatues ku specifikohen detajet ushtarake të marrëveshjes.

Përplasjet megjithatë nuk u shuan. Përkundrazi, batalionet nacionaliste të ideologjisë naziste marrin drejtimin e operacionit ushtarak duke intensifikuar sulmet kundër popullsisë.

Më 11 shkurt 2015, palët u takuan përsëri për nënshkrimin e një protokollit të ri, *Minsk II* – teorikisht ende në fuqi – që parashikon: armëpushimin e menjëhershëm dypalësh, tërheqjen e të gjitha ar-

19 OSCE, Chairperson-in-Office welcomes Minsk agreement, assures President Poroshenko of OSCE support.

mëve të rënda me qëllim krijimin e një zone sigurie midis të dyja palëve, verifikimin nga OSBE-ja të armëpushimit dhe tërheqjen e armatimeve të rënda, diskutimin mbi metodat e zhvillimit të zgjedhjeve lokale, amnisti për ata që janë përfshirë në përleshjet në rajonet Donetsk dhe Lugansk, shkëmbimin e të burgosurve, shpërndarjen e ndihmave humanitare, kontrollin e plotë nga Ukraina të kufirit të shtetit në të gjithë zonën e konfliktit, tërheqjen e të gjitha formacioneve të huaja të armatosura, duke përfshirë mercenarët, çarmatimin e grupeve ilegale, miratimin e një kushtetute të re që parashikon një status të veçantë për zonat autonome të Donetsk-ut dhe Lugansk-ut dhe të drejta për vetëvendosje gjuhësore.²⁰

Edhe ky protokoll, sidoqoftë injorohet tërësisht, me përjashtim të shkëmbimit të të burgosurve që u bë në vitin 2019.

Dy probleme formale, në veçanti, mbeten të pazgjidhura: së pari, nuk arrihet të gjendet një marrëveshje për mënyrën e bërjes së zgjedhjeve në republikat e Donetsk-ut dhe Lugansk-ut (ku, për më tepër, rezultatet e referendumeve të vitit 2014, të cilat Kievi nuk i ka njohur, lënë pak dyshime mbi vullnetin popullor); së dyti, në lidhje me çështjen gjuhësore, në maj 2019, Poroshenko-ja nënshkruan një ligj që parashikon gjuhën ukrainase si të vetmen gjuhë shtetërore dhe detyron përdorimin e saj në të gjitha institucionet, shkollat, spitalet dhe sektorin e shërbimeve në përgjithësi. Në një vend ku rajone të tëra kanë një shumicë gjuhësore ruse (në disa zona si gjuhë e vetme), kjo krijon një thyerje të thellë shoqërore, të ushqyer pikërisht nga forcat qeveritare.

Ndërkohë, në territoret e Donbass-it dhe në shumë zona të vendit, problemi konkret është sulmi nazist, i cili shprehet si përmes batalioneve parau-

20 OSCE, Chairperson-in-Office gives full backing to Minsk package.

shtarake në vijën e parë të ofensivës në Donbass-it, ashtu edhe përmes një vale dhune ndaj popullsisë.

Që nga fillimi i grushtit të shtetit, të vdekurit janë rreth 14,000 dhe të plagosurit 40,000, kryesisht civilë nga Donbass-i.

Ngërçi

Problemet formale për të cilat nuk gjendet një marrëveshje nuk janë të pakapërcyeshme, sigurisht. Ajo që bllokoi çdo mundësi kompromisi nuk janë marrëveshjet e brendshme në Ukrainë, por marrëdhëniet e jashtme me Perëndimin e, në veçanti, me Shtetet e Bashkuara.

Për Shtetet e Bashkuara, Ukraina është pjesë e një plani më të gjerë, që ka të bëjë me raportin me Evropën, dhe synon rritjen e tensioneve ushtarake në rajon. Shtetet e Bashkuara nuk mund të lejojnë që palët zyrtarisht në terren të arrijnë një marrëveshje dhe në vend të kësaj duan të bëjnë të ndihet pesha e forcës së tyre ushtarake në proceset ekonomike evropiane.

Në samitin e NATO-s në Varshavë të 2016-s, Shtetet e Bashkuara iu shpallën aleatëve planin e fuqizimit ushtarak të frontit lindor të Aleancës tanimë shumë pak atlantike, me nota të qarta anti-ruse.²¹ Arsyeja formale është përgatitja për t'u përballur me agresivitetin e Rusisë, i bërë i qartë nga aneksimi i Krime-së në vitin 2014, dhe i gjykuar i paligjshëm nga vendet e Paktit Atlantik.

Përpos mbështetjes së drejtpërdrejtë të Ukrainës, NATO-ja po përgatitet për një veprim ushtarak frenues, nëpërmjet rrethimit, të Rusisë. Në Ukrainë po intensifikohet dërgimi i automjeteve, njerëzve dhe armëve, mbi të gjitha nga Shtetet e Bashkuara. Në kufijtë rusë, nga ana tjetër, po intensifikohen stërvitjet ushtarake.

Në veri, stërvitja kryesorja quhet “*Cold response*” dhe zhvillohet në Norvegji çdo dy vjet. Në stërvitjen e parë, të vitit 2006, marrin pjesë 11 vende të NATO-s, dhe angazhohen 10,000 ushtarë. Numri i njerëzve dhe mjeteve është rritur ndjeshëm që nga

viti 2012, ndërsa roli i tij në strategjinë e përgjithshme të rrethimit të Rusisë po rritet. Në stërvitjen e fundit, “Cold response 2022”, të mbajtur në mes të konfliktit ruso-ukrainas, kanë marrë pjesë 30,000 persona, që vinin nga 27 vende të NATO-s, me shtimin e Suedisë dhe Finlandës.²²

Sërish në Norvegji, në vitin 2018, NATO-ja kreu stërvitjen më të madhe ushtarake që nga vitet 1980, të ashtuquajturën “Trident Juncture 18”, ku u angazhuan mbi 50,000 persona nga 31 vende, dhe u përdorën masivisht automjete, anije dhe avionë luftarakë.²³

Në vitin 2017, NATO-ja formon, për më tepër, katër grupe taktike luftarake shumëkombëshe në Estoni, Letoni, Lituani dhe Poloni, të udhëhequra përkatësisht nga Mbretëria e Bashkuar, Kanadaja, Gjermania dhe Shtetet e Bashkuara, të cilat institucionalizojnë një proces të nisur disa vite më parë, me operacionet “Atlantic Resolve”, që nisi në 2014-n, dhe “Anaconda 16”, të bërë në vitin 2016, si kundërpërgjigje ndaj aneksimit të Krime-së nga Rusia.²⁴

Si një akt i mëtejshëm kërcënimi, ose ndoshta si një hap konkret drejt luftës, më 2 shkurt 2019, Shtetet e Bashkuara njoftuan synimin e tyre për t’u tërhequr nga Traktati i Forcave Bërthamore me Rreze të Mesme, të nënshkruar në 1987-n së bashku me Bashkimin Sovjetik. Në deklaratën zyrtare, pa dhënë detaje, Sekretari i Shtetit Michael Pompeo thotë se Rusia është e vetmja përgjegjëse për përfundimin e Traktatit, duke e shkelur atë në mënyrë të përsëritur që nga mesi i viteve 2000.²⁵

22 Joint-forces.com, Cold response 2022, an overview.

23 Council of Foreign Relations, NATO’s Trident Juncture Exercises: What to know.

24 NATO, NATO’s multinational battlegroups in the east of the alliance. U.S. European Command, Operation Atlantic resolve. The Guardian, NATO countries begin largest war game in eastern Europe since cold war.

25 CNN, Pompeo announces suspension of nuclear

Sikundër parashikohej, vendimi i SHBA-së për të braktisur Traktatin prodhon reagime energjike nga Rusia dhe Kina. Por tashmë e zaret janë hodhur dhe procesi i daljes përfundon në gusht.

NATO-ja padyshim mbështet vendimin e Shteteve të Bashkuara dhe asnjë shtet anëtar në Evropë nuk guxon të kundërshtojë liderin e aleancës. Vetëm Ministri i Jashtëm gjerman Heiko Maas ngre zërin me ndrojtje duke vënë në dukje publikisht atë që është e dukshme për të gjithë: “Një pjesë e sigurisë së Evropës është humbur”.²⁶

Fill më pas, përsëri në gusht 2019, Shtetet e Bashkuara nisën testimin e raketave të reja që tejkalojnë kufizimet e traktatit. Dhe duke qenë se ata e dinë se Kina i shkel syrin Rusisë për ta tërhequr atë në sferën e saj ekonomike, përmes gojës së Sekretarit të Mbrojtjes Mark Esper, ata saktësojnë se objektivi i kontekstit të ri bërthamor nuk është vetëm Evropa, por edhe zona e Paqësorit.²⁷

Gjithashtu në vitin 2019, NATO-ja shpall një seri tjetër stërvitjesh të mëdha ushtarake vjetore, me pjesëmarrjen e rreth 20,000 ushtarëve amerikanë, “në mbrojtje të Evropës”.

Ndërsa gjysma e Evropës është nën izolim për shkak të koronavirusit, në fillim të vitit 2020, ushtria amerikane drejton kështu stërvitjen më të madhe ushtarake të 25 viteve të fundit, e pagëzuar në mënyrë domethënëse “*Defender Europe 20*”, për t’iu kujtuar aleatëve se nuk duhet të mbrohemi vetëm nga Covid-i: është edhe Putin-i.²⁸

Në shtator, NATO-ja është protagoniste e dy provokimeve të qarta kundër Rusisë: më 4 shtator, tre bombardues strategjike amerikanë B-52 hyjnë në

arms treaty with.

26 Arms control, U.S. Completes INF Treaty Withdrawal.

27 US Department of Defense, Esper: Russia, China want to disrupt International order.

28 NATO, Defender Europe 20.

hapësirën ajrore të Ukrainës dhe kryejnë një fluturim të gjatë zbulimi përgjatë kufijve të gadishullit të Krime-së;²⁹ më 25 shtator, aeroplanët amerikanë organizojnë një sulm të stisur në Kaliningrad, në enklavën ruse midis Polonisë dhe Lituanisë, si një gur prove për të neutralizuar sistemet raketore ruse.³⁰

Në vitin 2021, për të kompletuar tregimin e muskujve në kufijtë e Rusisë, NATO-ja forcon më tej “*Defender Europe 21*” në veri dhe, në jug, fillon “*Steadfast Defender 2021*”, një tjetër stërvitje e madhe ushtarake në Ballkan dhe në pellgun e Detit të Zi, në të cilin marrin pjesë edhe 10,000 ushtarë të tjerë amerikanë.³¹

Rusia nuk rri duarkryq. Stërvitjet amerikane të kujtojnë stërvitjet vjetore “REFORGER” (“*Return of Forces to Germany*”, Rikthimi i forcave në Gjermani) të mbajtura nga NATO-ja gjatë Luftës së Ftohtë dhe që përfundojnë vetëm në vitin 1993, pas rënies së Murit të Berlinit dhe të Bashkimit Sovjetik.³² Prandaj Rusia përgjigjet duke vënë në lëvizje trupat e saj në zonat kufitare me pararojat lindore të NATO-s.

Në nivel ndërkombëtar, Rusia mbështetet mbi të gjitha tek Bjellorusia me të cilën ka kryer tashmë stërvitje të përbashkëta ushtarake në vitin 2013, me emrin “*Zapad*” (që do të thotë “perëndim” në rusisht), që e merr emrin nga stërvitja më e madhe sovjetike anti-NATO, “*Zapad-81*”, mbajtur më 1981.³³

Në epokën post-sovjetike, Rusia mbajti dy stërvitje të tjera “*Zapad*”, në vitin 1999 dhe 2009: e para, për të testuar aftësinë kundërpërgjigjëse ndaj një

29 The aviationist, Three U.S. B-52s Fly Mission Over Ukraine’s Sea Azov Coast In A Clear Show Of Force Toward Russia.

30 Forbes, U.S. Air Force B-52s Just Flew A Mock Bombing Run On Russia’s Zapad-2021 exercise.

31 NATO, Steadfast Defender 2021.

32 GlobalSecurity, Reforger.

33 Institute for the Study of War, Russia’s Zapad-2021 exercise.

agresioni të mundshëm të NATO-s, pas çakërdisjes së sistemit mbrojtës të shkaktuar nga shpërbërja e Traktaktit të Varshavës. Ky test tregoi dobësinë e sistemit rus të mbrojtjes dhe nevojën për të pranuar një sërë kushtesh ekonomiko-ushtarake në Evropë; e dyta, për të simuluar pasojat e një sulmi nga Polonia dhe aftësitë kundërsulmuese të ushtrisë ruse.

Sado të rëndësishme qofshin strategjikisht, misionet “Zapad” nuk kanë efektin demonstrues për sa i përket vëllimit të njerëzve dhe pajisjeve të mobilizuara në stërvitjet e epokës sovjetike, as të atyre të NATO-s. Në vitin 2021, megjithatë, Rusia shkel pedalën e gazit. Ndërsa ruan një karakter thelbësisht mbrojtës dhe me një përdorim më të ulët të mjeteve ajrore dhe detare sesa në stërvitjet e NATO-s, “Zapad 2021” është padyshim stërvitja më e madhe evropiane për sa i përket personelit të punësuar: mbi 200,000 burra dhe gra ruse dhe bjelloruse.

Për dashamirët e lojërave të strategjisë, loja mund të fillojë tani: tanket rreshtohen në tabelën e Riziko-s³⁴, letrat janë shpërndarë dhe provat e përgjithshme janë mbyllur. Tani duhet vetëm që një lojtar të hedhë zarin “i pari”.

34 Risiko, shqiptim Riziko, është lojë tavoline, me natyrë luftarake, e ambientuar në një konflikt botëror. Në këtë lojë duhen përdorur strategjitë e luftës për të rritur fuqinë e ushtrisë përkatëse, për të pushtuar sa më shumë territore e për të arritur kështu objektivin e vendosur. (Shën. i përkth.)

Presidenti i kamufluar

Ndërsa konflikti midis NATO-s dhe Rusisë ashpërsohet, edhe ekuilibrat e brendshëm në Ukrainë pësojnë ndryshim. Më 31 mars dhe 21 prill 2019, votohet për të zgjedhur Presidentin e ri.

Në garë ka vetëm pro-perëndimorë. Kandidatët kryesorë janë tre: Presidenti Poroshenko; Julia Tymoshenko, liderja historike e *Revolucionit Portokalli* 2004, e mundur në zgjedhjet presidenciale të 2010-s nga armiku i saj i përjetshëm Yanukovych, kryeministre nën presidencën e Yushenko-s, e dënur në 2011-n me shtatë vjet burg për shpërdorim detyre, e liruar nga burgu gjatë lëvizjes *EuroMaidan* në 2014-n, e pritur si sfiduesja e madhe e Presidentit; dhe Volodymyr Zelensky, kandidat i minutës së fundit, i panjohur në botën politike, por i njohur për publikun e gjerë si protagonist i një seriali të suksesshëm televiziv, ku personazhi që ai luan, sipas rrethanave të rastit, bëhet President i Ukrainës.

Siç pritej, Zelensky fiton, duke mundur Presidentin në dalje, me balotazh.

Seriali ku Zelensky është protagonist titullohet *Shërbëtori i popullit* dhe tregon historinë e një mësuesi të shkollës së mesme, pa lidhje me politikën, i cili falë një videoje të postuar nga nxënësit e tij në rrjetet sociale, ku filmojnë shkrimin tij kundër oligarkëve, bëhet popullor, kandidon për zgjedhje dhe fiton. Seriali debutoi në tetor 2015 dhe episodi i fundit u transmetua në mars 2019, një muaj para zgjedhjeve, në kanalën 1+1, kanali i dytë më i madh ukrainas për nga mbulimi gjeografik, që i përket 1+1 Media Group (në Perëndim, të drejtat i përkasin Netflix-it).

Ndryshe nga protagonistin imagjinar, presidenti i Ukrainës nuk është një qytetar i zakonshëm që e fiton bukën e tij duke dhënë mësim në një shkollë të mesme, por një biznesmen që fiton dhjetëra mi-

lionë dollarë nga operacionet miliarda dollarëshe në kompanitë offshore, përfshirë *Kvartal 95*, një kompani televizive e themeluar prej tij. Në mars 2018, avokati i *Kvartal 95* regjistron një parti të re në Ministrinë e Drejtësisë: *Shërbëtor i popullit*. Partia nuk ka një zyrë, as nuk është e regjistruar, dhe gjithçka luhet në televizion, ku ndodh dhe shpallja e kandidaturës së Zelensky-t për President gjatë emisionit të Vitit të Ri në TV 1+1. Dhe, pas pak muajsh, pasi trillimi është kthyer në realitet, Zelensky iu cakton njerëzve të tij nga *Kvartal 95* pozicione të rëndësishme pushteti, mes të cilave dhe drejtimin e policisë sekrete të Ukrainës.³⁵

Pas Zelensky-t qëndron Ihor Kolomoisky, një nga oligarkët kryesorë ukrainas, një nga ata që është bërë i pasur me tranzicionin në kapitalizëm dhe që tani kontrollon, ndër të tjera, Grupin *Media 1+1* dhe financon *Kvartal 95*. Në vitin 1992, ai ishte një nga themeluesit e *PrivatBank*, e cila do të shtetëzohet në vitin 2016, pas akuzave ndaj tij për mashtrim në shkallë të gjerë.

Hebre, me shtetësi të trefishtë, ukrainas, izraelit dhe qipriot, Kolomoisky luan një rol drejtues në komunitetin hebre: në vitin 1998, ai zgjidhet President i Komunitetit të Bashkuar Hebre të Ukrainës dhe, në vitin 2010, emërohet President i Këshillit Evropian të komuniteteve hebraike. Mediat lokale e përshkruajnë atë si njeriun e dytë më të pasur në Ukrainë dhe *Forbes* e rendit atë në mesin e tre njerëzve më me ndikim në vend.³⁶

Politikisht, përpos neverisë së tij të thellë ndaj komunizmit, ai është një kundërshtar i vjetër i Yanukovych-it e një mbështetës i Yushenko-s, dhe një financues i aktiviteteve filantropike. Me ndryshimin

35 Organized Crime and Corruption Reporting Project, Pandora papers reveal offshore holdings of Ukrainian President and his inner circle.

36 Kyiv Post, Rich Man In A Poor Country.

e regjimit pas *EuroMaidan*-it, presidenti i ri Poroshenko e emëron guvernator të rajonit të Dnipropetrovsk-it, në kufijtë e Donbass-it, ku ai është shumë aktiv në shtypjen e lëvizjes separatiste ruse.

Krijon batalionin *Dnipro*, në kryeqytetin e rajonit që administron, e konsideruar nga shumë si ushtria e tij private, dhe financon batalionet *Aidar* dhe *Azov*, me ideologji naziste. Kundërshtia e tij ndaj Rusisë dhe ndaj të gjithë llojeve të separatizmit nuk është vetëm e natyrës politike. Në fakt, Kolomoisky-t nuk i ka ikur inati nga sekuestrimi dhe shtetëzimi i asetëve të tij në Krime, pas aneksimit nga Rusia, dhe do t'i pëlqente të shkonte t'i rimerrte me mjete ushtarake.

Në vitin 2015, Kolomoisky hyn në konflikt me Poroshenko-n. Presidenti dëshiron të frenojë batalionet e “vullnetarëve”, të cilët janë në qendër të skandaleve për dhunë e abuzime të rënda, dhe që krijojnë pësjtjellim në mediat perëndimore.³⁷ Me ndryshimin e regjimit, Perëndimi do të donte të përshpejtonte procesin e reformave ekonomike të përcaktuara nga FMN-ja në atë që ata e paraqesin si *Ukraina e re demokratike*, dhe ngritja e dukshme e nazizmit nuk ndihmon në dialogun me demokracitë perëndimore. Kështu që me 25 mars 2015, presidenti pro-perëndimor e shkarkon Kolomoisky-n nga detyra.

Shtetet e Bashkuara nuk kanë asgjë kundër oligarkëve ukrainas të cilëve iu pëlqen nazizmi, dhe presidenca e Poroshenko-s e dëshmon këtë fakt. Problemi, po të bjerë puna, qëndron te shkalla e lirisë që duhet të kenë ata, dhe Shteteve të Bashkuara, siç e dimë, iu pëlqen të drejtojnë orkestrën. Oligarkët që promovojnë dhe financojnë ndryshimin janë më të dobishëm në fazën e destabilizimit të vendit sesa në atë të përafërimit me interesat e Perëndimit. Kolomoisky ka shumë autonomi e shumë pushtet dhe është më mirë të largohet.

37 Reuters, In the battle between Ukraine and russian separatists, shady private armies take the field.

Problemi është se oligarku ukrainas nuk është aspak dakord, ai po luan në shtëpi dhe e ka tashmë një plan. Më 16 nëntor 2015, në fakt transmetohet episodi i parë i Shërbëtorit të Popullit dhe pas tre vjet e gjysmë një nga njerëzit e tij bëhet President. Ndërsa plani i tij transmetohet në televizionin e tij, për të qenë i sigurtë, pas skandalit të PrivatBank-ut, në vitin 2017, Kolomoisky largohet nga vendi dhe shkon në Zvicër e Izrael, nga ku kthehet pas zgjedhjes së Zelensky-t në 2019-n, me garancinë e mosndëshkimit për akuzat ndaj tij.

Zelensky është një produkt i oligarkive lokale që janë në kontrast me Shtetet e Bashkuara. Në fushatën elektorale, ai nuk paraqet asnjë program politik real dhe e bazon gjithçka mbi populizmin dhe luftën kundër korrupsionit. Në marrëdhëniet ndërkombëtare, ai paraqitet si një mbështetës i qartë i Perëndimit, por shmang qëndrimet e qarta ndaj Rusisë dhe sugjeron që çështja e anëtarësimit në NATO të zgjidhet përmes një referendumit. Nga sondazhet, ndërsa elektorati i Poroshenko-s është i vendosur fort për anëtarësim në BE dhe NATO, votuesit e Zelensky-t janë më heterogjenë: shumica është në favor të Perëndimit, por më shumë se një e treta do të dëshironte të rivendoste marrëdhënie miqësore me Rusinë dhe, për çështjen e luftës, 30% e votuesve të Zelensky-t do të ishin gati të pranonin paqen me Rusinë, me çdo kusht.³⁸

Pasi fitoi edhe zgjedhjet parlamentare, më 9 dhjetor 2019, Zelensky pritet në Paris për takimin e tij të parë me Putin-in, në prani të Emanuel Macron-it dhe Angela Merkel-it: një moment i rëndësishëm për të kuptuar synimet reale të Presidentit të ri. Një muaj para takimit, Kolomoisky – i cili nga ana tjetër pretendon se pas krimeve për të cilat akuzohet qëndrojnë manovrat politike të FBI-së – zbulon lojën e tij. Qëndrimi jashtë vendit, vëmendja e marrë nga Shtetet e

38 German Council for Foreign Relations, The Mystery of Voldymyr Zelenskiy.

Bashkuara dhe prirja e lindur për biznes e kanë bërë dukshëm oligarkun e vjetër anti-rus t'i rishikojë pozicionet e tij.

Në një intervistë me New York Times, ai deklaroi se Shtetet e Bashkuara thjesht po e përdorin Ukrainën për të dobësuar rivalin e tyre gjeopolitik: “Njerëzit duan paqe, një jetë të mirë, ata nuk duan luftë. Dhe ju (Shtetet e Bashkuara) po na detyroni të bëjmë luftë, pa na dhënë as paratë për ta bërë atë”. Lidhjet me Rusinë duhen rindërtuar për mbijetesën ekonomike të vendit. Zelensky duhet të shpallë default mbi kreditë e FMN-së dhe të pranojë 100 miliardë dollarët nga Rusia. “Cila është mënyra më e shpejtë për të zgjidhur problemet dhe për të rivendosur marrëdhëniet? Paratë”.³⁹

Në këtë pikë, Shtetet e Bashkuara kërkojnë qartësi dhe besnikëri nga Zelensky. I takon atij të çlirohet nga zinxhiri i Kolomoisky-t e të gjithë oligarkëve që ai premtoi se do të luftonte. Zelensky e kupton shpejt se Shërbëtori i Popullit tani ka një regjizor të ri. Ai tashmë nuk ka më nevojë për TV-të lokale, atë janë duke e pritur TV-të nga e gjithë bota. Seria e katërt e reality show-t debutoi kështu me miratimin e të ashtuquajturit ligji anti-Kolomoisky, i cili, ndër të tjera, ndalon ish-pronarët të rikuperojnë asetet e shtetëzuara (fjala është padyshim për PrivatBank, mbi të cilën Kolomoisky kërkon pronësinë). Paralelisht, si pjesë e ritualit të fillimit të kërkuar nga Shtetet e Bashkuara, ai dëboi të gjithë njerëzit e afërt me Kolomoisky-n nga partia dhe qeveria.⁴⁰

Për ta shtyrë Zelensky-n që të përballet me të, më 5 mars 2021, duke ripërsëritur akuzat për korrupsion që dolën në 2015-n, Departamenti Amerikan i Shtetit vendosi sanksione kundër Kolomoisky-t, i cili, në

39 New York Times, A ukrainian billionaire fought Russia. Now he's ready to embrace it.

40 Kyiv Independent, Rumors of Zelensky stripping top oligarch Kolomoisky's citizenship gain ground.

këtë pikë, e sheh me leverdi të dalë nga skena.⁴¹ Zelensky më në fund është i lirë të veprojë, vetëm në interes të Perëndimit.

Fatkeqësisht edhe ai përfundon i përfshirë në skandalin e operacioneve offshore të Kolomoisky-t. Më 3 tetor 2021, të dy shfaqen në fakt në dosjen *Pandora Papers*, një hetim i madh gazetaresk mbi parajsat fiskale, pastrimin e parave, korrupsionin, evazionin fiskal dhe shmangien e taksave. Hetimi zbulon ekzistencën e një rrjeti kompleks kompanish offshore të kryesuar nga rrethi i ngushtë i Kolomoisky-t dhe Zelensky-t, me transferta miliarda parash që nga viti 2012.⁴²

Për kë besonte se *Shërbëtori i Popullit* do ta çlironte Ukrainën nga oligarkët, ky është një zhgënjim i madh. Për Shtetet e Bashkuara, nga ana tjetër, një dosje e nxehtë që qëndron gjithmonë mbi tryezën e Presidentit është një mënyrë e shkëlqyer për t'i kujtuar atij se interesat të cilëve duhet t'iu shërbejë fillimisht janë ato të Perëndimit.

Washington-i me siguri nuk ka nevojë për *Pandora Papers*-in për të njohur manovrat financiare të presidentit ukrainas dhe rrethit të tij. Thjesht, sipas praktikës, Shtetet e Bashkuara u japin dorë të lirë oligarkëve kur ata ushqejnë revolucionet portokalli, armatosin batalionet ushtarake dhe thonë se duan të luftojnë kundër korrupsionit, por i braktisin sapo kanë mospërputhjet e para të interesave.

Prej shkëputjes nga Kolomoisky, Zelensky nuk humbet vetëm mbështetjen e industrisë së medias që krijoi pëlqimin e tij, por humbet shumë edhe nga vetë pëlqyeshmëria. Ndryshimi i regjimit i cili duhej të sillte demokracinë dhe mirëqenien perëndimore

41 US Department of State, Public Designation of Oligarch and Former Ukrainian Public Official Ihor Kolomoisky Due to Involvement in Significant Corruption.

42 Organized Crime and Corruption Reporting Project, Pandora papers reveal offshore holdings of Ukrainian President and his inner circle.

ka sjellë vetëm luftë dhe shkatërrim. Populli është i lodhur dhe asnjë ukrainas nuk e pëlqen luftën deri në ushtarin e fundit. Shumë ukrainas e mendojnë vërtetë si Kolomoisky: iu ka ardhur në majë të hundës me luftën, punëtorët do të donin të ktheheshin në punë dhe sipërmarrësit të bënin biznes. Tani *Shërbëtori i Popullit* nuk i shërben më as popullit ukrainas dhe as qarqeve financiare nga vjen. Kontakti i vetëm i tij janë Shtetet e Bashkuara dhe fuqitë e NATO-s.

2. Pasojat ekonomike të luftës

Zhvillimet ushtarake në marrëdhëniet midis Ukrainës dhe Ruisë, dhe mbi të gjitha midis NATO-s dhe Ruisë, përbëjnë vetëm njërin dimension të problemit në strategjinë imperialiste të SHBA-së. Lufta e vërtetë që Shtetet e Bashkuara synojnë të bëjnë kundër Ruisë, të paktën për momentin, është në fakt kryesisht e natyrës ekonomike. Për më tepër, tani është e qartë se në shënjestrën e Shteteve të Bashkuara, më shumë se sa Rusia, gjendet BE-ja. Prandaj, le të analizojmë ndërhyrjen ushtarake ruse dhe pasojat ekonomike që ajo shkakton, duke u përpjekur të identifikojmë fituesit dhe humbësit e luftës ekonomike.

Operacioni ushtarak rus

Ndërhyrja e armatosur e Ruisë kundër Ukrainës bëhet pa asnjë *casus belli*. Të gjithë e dinin që do të ndodhte. Prej muajsh, Zelensky e akuzon Putin-in se po thur një grusht shteti kundër qeverisë së tij, dhe iu kërkon me ngulm vendeve të NATO-s të ndërmarin veprime parandaluese kundër Ruisë.⁴³ Shtetet e Bashkuara padyshim i dinë në kohë reale lëvizjet e trupave ruse në kufirin me Ukrainën ndërsa BE-ja pret në mënyrë pasive rrjedhën e ngjarjeve, sikur të ishin të pashmangshme.

Operacioni ushtarak fillon më 24 shkurt 2022, tre ditë pas njohjes zyrtare nga Moska të dy republikave të pavarura të Donbass-it. Dy janë arsyet në të cilat Rusia këmbëngul për të justifikuar ndërhyrjen: çmilitarizimi dhe çnazifikimi i territoreve fqinje.

Arsyeja e parë padyshim i referohet problemit të militarizimit të Ukrainës dhe agresionit të Donbass-it. Në të vërtetë, militarizimi i vendit, nëpërmjet grupeve paraushtarake dhe mercenarëve të stërvitur nga NATO-ja, ishte akti përgatitor për grushtin e shtetit, i cili u intensifikua më pas në fazën e represionit të forcave antifashiste. Mundësia që Ukraina të presë haptazi armatimet e NATO-s ose të marrë ndihmë indirekte ushtarake prej saj përbën një kërcënim objektiv për sigurinë kombëtare të Ruisë, veçanërisht pasi vetë NATO-ja e ka shpallur Rusinë një fuqi armiqësore.

Megjithatë, militarizimi që shqetëson Moskën nuk ka të bëjë vetëm me Ukrainën, por me të gjithë zonën. Përshkallëzimi që çon në ndërhyrjen e armatosur ka të bëjë më shumë me shqetësimet e Ministrisë së Mbrojtjes për praninë gjithnjë e më masive të trupave të NATO-s që lëvizin vazhdimisht përg-

43 Reuters, Zelenskiy says Ukraine uncovers coup plot involving Russians; Kremlin denies role.

jatë kufijve të Rosisë, sesa me popullsinë e Donbass-it, që jetojnë nën bomba prej tetë vitesh tashmë.

Edhe termi “çnazifikim” është domethënës: ai i përgjigjet qartas procesit të “çkomunistizimit” të nisur nga Poroshenko-ja dhe të zhvilluar nga qeveria puçiste e pas *EuroMaidan*-it, e cila, siç e pamë, e ndalon komunizmin në të gjitha format e tij reale dhe simbolike.

Rusia ka kohë që është distancuar nga komunizmi dhe është e integruar mirë në marrëdhëniet ekonomike me fuqitë kryesore kapitaliste. Por kujtimi i nazizmit është ende i pranishëm në vendin që e ndaloi atë. Duam apo s’duam, në Rusi, e dinë se ata që e ndaluan ish-in komunistët.

Kjo shfaqje e krenarisë historike kundër procesit të nazifikimit të Ukrainës është pjesë e një procesi më të përgjithshëm të rishqyrtimit të së kaluarës sovjetike nga ana e Rosisë. Nga fjalimet zyrtare të Presidentit deri te paradat ushtarake, shumë aspekte të socializmit real janë rivlerësuar, duke përfshirë simbolikën komuniste, sigurisht jo për përmbajtjen politike që ai shpreh ende sot, por për të mbrojtur, përballë botës, rolin historik të luajtur nga Bashkimi Sovjetik.

Me rënien e Bashkimit Sovjetik, Rusia u pòshtërua politikisht dhe ekonomikisht: asaj iu desh të hiqte dorë nga komunizmi dhe t’ia shiste pasurinë e vendit kapitalit perëndimor, si kusht për t’u integruar në marrëdhëniet me Perëndimin. Tani, përballë një NATO-je gjithnjë e më agresive, që përdor edhe luftëtarët nazistë dhe që do të dëshironte të ripropozonte skemat e Luftës së Ftohtë, thirrjet e Presidentit Putin për madhështinë e Bashkimit Sovjetik dhe Ushtrisë së Kuqe kthehen në një kundërpërgjigje me rëndësi historike, më shumë se politike. Nëse Evropa shtiret antifashiste e ndërkohë, duke iu bindur Shteteve të Bashkuara, armatos nazistët, Rusia përgjigjet duke kujtuar se kush e mposhti vërtet na-

zizmin në Evropë dhe kush e ngriti flamurin e fitores mbi Reichstag.

Në rrafshin ushtarak, ndryshe nga luftërat e NATO-s, të kryera me lëshime masive raketash dhe bombardimesh sistematike, përparimi rus në territorin ukrainas është relativisht i ngadaltë. Kur është e mundur, ushtria e shmang përplasjen deri në vdekje, duke u përpjekur në vend të kësaj që ta shtyjë armikun të dorëzohet, dhe shmang sulmin në zonat më të populluara.

Duke hetuar sulmet ruse në disa qytete të Donbass-it, Amnesty International zbulon nga ana tjetër përdorimin e taktikave famëkeqe luftarake nga ushtria ukrainase, të kundërshtuara edhe nga konventat ndërkombëtare, të tilla si sulmet nga brenda zonave të banuara dhe përdorimi i mburojave njerëzore për të mbrojtur ushtrinë, nëpër shkolla, në ndërtesa banimi dhe në spitale.⁴⁴ Qarkullojnë, gjithashtu, shumë video të tankeve ukrainas të fshehur në zona të banuara dhe të vrasjes së civilëve që përpiqen të arratisen përmes korridoreve humanitare.

Nga pikëpamja e së drejtës ndërkombëtare, ndihma ushtarake nga Shtetet e Bashkuara dhe vendet tjera të NATO-s (apo edhe ndërhyrja direkte e armatosur) ngre gjithashtu probleme të ndryshme, si për shkak se Ukraina nuk është pjesë e Paktit të Atlantikut dhe as nuk ka marrëveshje të veçanta mbrojtëse me vende të NATO-s, e si për shkak se shumica e vendeve evropiane refuzojnë (të paktën zyrtarisht) luftën si një mjet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërkombëtare.

Me hyrjen e ushtrisë ruse në territorin ukrainas, një tjetër aspekt i turpshëm i strategjive ushtarake të Shteteve të Bashkuara përfundon në qendër të vëmendjes, në mes të kontekstit pas-pandemik. Më 10 mars 2022, dukshëm e turpëruar, Victoria Nuland,

44 Amnesty International, Ukraine: Ukrainian fighting tactics endanger civilians.

Nënsekretare e Shtetit të SHBA-së – e filmuar nga televizionet botërore në vitin 2014 në EuroMaydan ndërsa, me një trastë plot me bukë, iu drejtohet protestuesve duke thënë: “We’re here from America, would you like some bread?” – thërritet në Senat për të dhënë llogari për zhvillimet në terren. Nga tonet triumfaliste, ajo ndryshon papritur shprehje kur i kërkohen sqarime për laboratorët biologjikë në Ukrainë: Nënsekretarja e Shtetit konfirmon ekzistencën e tyre dhe thotë se është e shqetësuar që “materiali kërkimor” mund të përfundojë në duart e rusëve, duke siguruar megjithatë se gjithçka është nën kontroll.⁴⁵

Arsyeja se përse ajo detyrohet ta pranojë publikisht është sepse rusët tashmë kanë shumë prova të luftës biologjike të kryer nga Shtetet e Bashkuara. Shkatërrimi me ngut i laboratorëve, në përpjekje për të fshirë gjurmët e tyre, nuk shërben për asgjë. Komandanti i forcave ruse të mbrojtjes radioaktive, kimike dhe biologjike, Igor’ Kirillov, ka folur tashmë publikisht për një rrjet prej rreth tridhjetë laboratorësh biologjikë të Pentagonit në Ukrainë. Kjo është konfirmuar edhe nga zëdhënësi i Ministrisë së Jashtme kineze Zhao Lijian, i cili saktëson se bëhet fjalë për majën e një ajsbergu të përbërë nga 336 laboratorë amerikanë, të vendosur në 30 vende të ndryshme.⁴⁶

Zonja Nuland do të mbahet mend mbi të gjitha për një tjetër episod, ku aftësitë e saj diplomatike avulluan, këtë herë jashtë formalitetit të sallave parlamentare. Në një bisedë telefonike me ambasadorin e SHBA-së në Ukrainë, Geoffrey Pyatt, e ngarkuar në YouTube në vitin 2014, dy amerikanët diskutojnë,

45 C-Span, Senator Rubio questions undersecretary Nuland over biolabs in Ukraine.

46 Ministry of Foreign Affairs of the People’s Republic of China, Foreign Ministry Spokesperson Zhao Lijian’s Regular Press Conference on March 8, 2022.

emër për emër, formimin e qeverisë së re ukrainase dhe divergjencat e interesave midis SHBA-së dhe BE-së: BE-ja luan një lojë ekonomike afatgjatë me Ukrainën, ndërkohë që Shtetet e Bashkuara duan një lojë të përshpejtuar kundër Ruisë; një problem delikat, që duhet trajtuar në mënyrë maksimalisht diplomatike, për të cilin Nënsekretarja e shtetit thotë mendimin e saj në mënyrë sintetike, të qartë dhe efikase: “*Fuck the EU!*”⁴⁷

47 Reuters, Leaked audio reveals embarrassing U.S. exchange on Ukraine, EU.

Sanksionet kundër Rusisë

Reagimi i Shteteve të Bashkuara, BE-së dhe vendeve të NATO-s ndaj sulmit rus është i gjithanshëm. Në rrafshin ushtarak, ato intensifikojnë dërgimin e armëve, mjeteve dhe njerëzve; në nivel ekonomiko-financiar, ata i shtrëngojnë ashpërsisht sanksionet me qëllim që ta izolojnë ekonomikisht Rusinë dhe ta shtyjnë atë drejt falimentimit të shtetit (procesi i sanksioneve filloi në të vërtetë në vitin 2014, si pasojë e grushtit të shtetit në Ukrainë dhe qëndrimin e Rusisë). Së fundi, një fushatë diskriminimi dhe censurimi ka nisur kundër çdo gjëje që ka të bëjë me Rusinë, përfshirë sferën kulturore, informative, shkencore, artistike dhe sportive. Qytetërimi rus është ndaluar dhe, nëpërmjet një silogjizmi anakronik për të paktën tridhjetë vjet, është shfrytëzuar mundësia për të dekomunistizuar pak edhe Perëndimin, duke hequr simbolet e komunizmit apo edhe statujat e Marksit, i cili nuk ishte tamam rus dhe që vdiq rreth tridhjetë vjet përpara Revolucionit të Tetorit.

Masa e parë e natyrës financiare kundër Moskës është ngrirja e fondeve të Bankës Qendrore të Rusisë. Shifra nuk specifikohet: autoritetet ruse raportojnë një sekuestrim prej 300 miliardë dollarësh, rreth gjysma e totalit të rezervave të Bankës Qendrore. Vlerësimet më të ulëta ndërkombëtare, nga ana tjetër, flasin për rreth 630 miliardë dollarë, dhe sipas ministrit francez të ekonomisë Le Maire, madje bëhet fjalë për rreth 1,000 miliardë euro. Le Maire deklaroi, me çiltërsi: “*Ne do të shkaktojmë kolapsin e ekonomisë ruse!*”⁴⁸

Sidoqoftë, kjo është një shumë e paprecedentë në dëm të një institucioni legjitim dhe sovran. Sakaq, duke ndjekur protokollin e testuar tashmë në

48 CNN, The West's \$1 trillion bid to collapse Russia's economy.

rastin e sekuestrimit të fondeve sovrane libiane dhe afgane, ministri gjerman i financave, Christian Lindner, sugjeron që nga ngjirja të kalohet në konfiskim, në mënyrë që të mund të disponohen lirisht fondet gjatë fazës së rindërtimit.⁴⁹

Pas kësaj vjen një masë e dytë domethënëse: përjashtimi i institucioneve kryesore financiare ruse nga sistemi i tregtisë financiare ndërkombëtare Swift, platforma kryesore globale për pagesat ndërkombëtare. Në këtë mënyrë, bllokohen materialisht transaksionet e mëdha ndërkombëtare me Rusinë përmes sistemit bankar.

Shtetet e Bashkuara ndërmarrin më pas një hap të tretë vendimtar, veçanërisht për aleatët: ndalojnë importet e naftës dhe gazit rus, duke këmbëngulur që të gjithë të bëjnë të njëjtën gjë. Problemi është se objektivisht vendet evropiane nuk janë në gjendje ta bëjnë këtë. Për SHBA-në, kjo është e lehtë pasi që nga viti 2019, ato nuk importojnë asnjë metër kub gaz nga Rusia dhe nafta ruse përbën vetëm 3% të importeve totale të naftës në vend.⁵⁰ Për aleatët evropianë, gjërat janë ndryshe: BE-ja importon 40% të nevojave të saj totale për gaz dhe 25% të nevojave të saj për naftë nga Rusia.⁵¹

Për të mundësuar BE-në që të ndërmarrë këtë hap të guximshëm që synon goditjen e ekonomisë ruse – të paktën kështu pretendohet – Shtetet e Bashkuara premtojnë të rrisin eksportet e gazit të lëngshëm në Evropë dhe ta ruajnë këtë rritje të paktën deri në vitin 2030.

Mbretëria e Bashkuar i bashkohet sakaq thirrjes së Shteteve të Bashkuara, duke u zotuar t'i eliminonjë shpejt importet e naftës ruse deri në fund të

49 EurActiv, Germany open to Russian Central Bank asset seizure to finance Ukraine's recovery.

50 Forbes, Ban On U.S. Imports Of Russian Natural Gas? No Imports Since 2019.

51 Energy Monitor. How can the EU end its dependence on Russian gas?

vitit 2022. BE-ja po ndjek zbatimin e sanksioneve më shumë formalisht sesa realisht, duke pasur parasysh varësinë nga energjia ruse. Ajo, në të njëjtën kohë, ia beson kryesisht Shteteve të Bashkuara detyrën për t'i rishqyrtuar marrëdhëniet me vendet prodhuese të naftës, përfshirë vetë Shtetet e Bashkuara.

Kompanitë gjermane po paguajnë pjesën më të madhe të sanksioneve: kancelari Olaf Scholtz në fakt duhet të bllokojë nisjen e aktivitetit të gazsjellësit *Nord Stream 2*, të përfunduar në vitin 2021. Ky është gazsjellësi më i gjatë në botë, i cili lidh Rusinë me Gjermaninë përmes Detit Baltik, dhe i cili duhet të ishte një burim kryesor i furnizimit me energji për të gjithë BE-në. Kjo është një zgjedhje drastike dhe e kushtueshme, që hedh në erë investimet strategjike afatgjata, dhe e cila është marrë brenda pak ditësh nën presionin e SHBA-së, padyshim me synimin për të goditur Rusinë. E para që bie, megjithatë, është kompania zvicerane *Nord Stream 2 AG*, ndërtuesja e gazsjellësit, e cila, pas vendimit gjerman, shpall falimentimin.⁵²

52 Reuters, Exclusive: Nord Stream 2 owner considers insolvency after sanctions.

Kundërmasat ruse

Rusia po i përgjigjet sanksioneve me një strategji gjithëpërfshirëse të bazuar në koordinimin e kujdesshëm midis Bankës Qendrore dhe qeverisë. Banka Qendrore ndërmerr tre veprime me karakter financiar. Qeveria ecën paralelisht me dy lloje veprimesh politiko-financiare.

Dy lëvizjet e para janë të Bankës Qendrore. Saponisin sanksionet, Banka Qendrore rrit normën e skontimit nga 9.5% në 20% dhe vendos kontrollë mbi lëvizjet e kapitalit, për të mbrojtur monedhën dhe për të parandaluar daljet e kapitalit.⁵³

Më pas, përsëri për të mbrojtur monedhën kombëtare, qeveria vendos që eksportet e gazit në vendet armiqësore do të paguhen në rubla (më saktë, skema parashikon që vendet evropiane të hapin një llogari në GazpromBank – krahu financiar i Gazprom-it – dhe të paguajnë faturat e tyre në euro, që të konvertohet më pas automatikisht në rubla). Edhe pse në debatin politik dhe mediatik, çështja fokusohet në aspektin formal të monedhës me të cilën duhet paguar gazi dhe nafta, lëvizja financiare e Ruisë është thelbësore. Nëpërmjet kësaj skeme, Rusia iu dërgon një mesazh shumë të qartë atyre që duan të spekulojnë kundër rublës: nuk do të jetë Banka Qendrore e Ruisë ajo që do të mbrojë rublën, por kërkesa evropiane për gaz dhe naftë.

Nëse ndaj Evropës qeverisë së Moskës i është dashur të tregojë forcën, ndaj vendeve aziatike që nuk i janë bashkuar thirrjes së SHBA-së ajo mban një qëndrim shumë të ndryshëm, duke iu ofruar atyre një zbritje prej 25% në gaz dhe naftë. Kjo është lëvizja e dytë e qeverisë ruse, e cila kalon nga mbrojtja në kundërsulm. Rritja e eksporteve aziatike, përveç se luan një rol taktik si një element i mëtejshëm i forcimit të rublës, në afatshkurtër është një faktor i rëndësishëm strategjik

53

Trading Economics, Russia interest rate.

në optikën e një ripërcaktimi të kuadrit ekonomik e politik global.

Më 25 mars 2022, Banka Qendrore vendos gjithashtu, ndonëse vetëm përkohësisht, konvertueshmërinë fikse të arit me çmimin 5,000 rubla për gram.⁵⁴ Me kursin aktual të këmbimit me dollarin, kjo nënkupton një zbritje të çmimit të arit në rubla, krahasuar me atë në dollarë. Arbitrazhi në tregun e këmbimit valutor – i penguar, por në fakt jo plotësisht i ndaluar nga sanksionet – çon kësaj me shpejtësi në forcimin e rublës ndaj dollarit dhe ndaj monedhave të tjera kryesore. Rusia është gjithashtu prodhuesi i dytë më i madh në botë i arit pas Kinës, gjë që përforcon besueshmërinë e rublës si një monedhë ndërkombëtare e mbështetur jo vetëm nga premtimet e pagesave të Bankës Qendrore, por edhe nga rezervat e arit dhe naftës.

Me këtë paketë kundërlëvizjesh, autoritetet ruse e rifitojnë shpejt besueshmërinë e tyre përkohësisht të humbur në tregun valutor. Nëse në ditët pas fillimit të konfliktit, rubla kishte rënë me më shumë se 50%, efekti i këtyre kundërmasave është ta kthejnë atë në nivelet e para krizës.

Gjatë dy viteve të fundit, kursi i këmbimit të dollarit ka mbetur i qëndrueshëm në rreth 75 rubla për dollar. Me nisjen e sanksioneve, rubla u zhvlerësua me shpejtësi, dhe më 10 mars 2022 arriti në nivelin më të ulët, në 135 rubla për dollar. Prej aty fillon rimëkëmbja e shpejtë: në fund të prillit, rubla është kthyer tashmë në 75 kundrejt dollarit dhe, ndërsa vendet evropiane pranojnë skemën e re për blerjen e gazit dhe naftës të propozuar nga Rusia, ajo forcohet më tej.

Me neutralizimin e sulmit financiar, me një rubël të fortë në tregjet valutore, Banka Qendrore Ruse i kthehet konvertueshmërisë së rublës në ar me një çmim të ndryshueshëm dhe, në prill, ul normën e skontimit dy herë me tre pikë përqindje, së pari në 17%

⁵⁴ Central Banking, Bank of Russia fixes gold price and increases loans.

dhe më pas në 14%, pa asnjë shenjë të rënies së rublës.

Shkurtimisht, sanksionet ekonomike dhe financiare, të cilat supozohej ta godisnin Rusinë dhe ta çonin atë shpejt në kolaps, kanë efekte vetëm në një afat shumë të shkurtër. Brenda dy muajsh, rubla e rifiton fuqinë në tregje dhe besueshmërinë në qarqet financiare. Pavarësisht deklaratave të institucioneve më të fuqishme financiare perëndimore, default-i i Rusisë nuk është më në rend të ditës.

Për më tepër, pikërisht atëherë kur Shtetet e Bashkuara fillojnë të rrisin normat e interesit (ndërhyrja e parë është në mes të marsit 2022), duke shkaktuar një rritje të fortë të vlerës së dollarit kundrejt monedhave kryesore, rubla fiton ende terren ndaj dollarit. Në maj, ajo këmbëhet me 58 rubla për dollar, duke bërë që Bloomberg, kompania lider amerikane në sektorin mediatik dhe financiar, t'i kushtojë rublës titullin e monedhës më fitimprurëse të vitit.⁵⁵

Madje, për të parandaluar një mbivlerësim të rublës, i cili tani ka arritur në 51 dollarë, më 26 maj, Banka Qendrore e Rusisë e ul normën e skontimit me tre pikë të tjera përqindje, duke e çuar atë në 11%.

Anasjellas, nëse ka një monedhë që është dobësuar padyshim gjatë rrjedhës së sanksioneve, ajo është euro-ja. Krahasuar me dollarin, midis fundit të shkurtit dhe majit, ajo bie nga 1.12 në 1.05 (-6.3%) dhe në shtator zbret poshtë barazisë. Kundrejt rublës, nga ana tjetër, euro-ja pëson një kolaps të vërtetë: nga 90 rubla për euro, në shkurt – pasi arrin maksimumin në 148, me 7 mars – bie në 60, në muajin maj (-33,3% nga periudha e para sanksioneve).

Edhe në terma afatgjatë, efektet e sanksioneve rrezikojnë të rezultojnë të kota apo edhe me efekt të kundërt: zhvillimi i tregtisë në rubla dhe forcimi i bazës së arit dhe naftës së rublës – të cilat deri më tani kanë luajtur një rol thelbësisht mbrojtës – i ba-

55 Bloomberg, Ruble Surpasses Brazil's Real as Year's Best-Performing Currency.

shkohen në fakt afrimit ekonomik-financiar me Kinën dhe zhvillimit të marrëdhënieve ndërmjet BRIKS (Brazil, Rusia, India, Kina dhe Afrika e Jugut) në procesin e ridimensionimit të hegjemonisë së dollarit dhe, paralelisht, të rolit të euros.

Fatet e Ukrainës

Në përpjekjen për të identifikuar fituesit dhe humbësit e luftës ekonomiko-ushtarake, një gjë është e sigurt: i vetmi vend i humbur që në nisje është Ukraina. Ajo ia ka shitur lëkurën Perëndimit dhe tani, siç do të thoshte Marksi, vetëm pret t'i thahet. Shteti ukrainas është në rrugën e falimentimit. Ai nuk do të jetë kurrë në gjendje t'i shlyejë borxhet e tij. Presidenti Zelensky nuk ka asnjë plan për pasluftën përveçse t'ia ofrojë vendin kapitalit të huaj për rindërtimin.

Henry Kissinger-i, nëntëdhjetë e nëntë vjeç, me përvojë në çështjet strategjike, Zelensky-n e përshkruan kështu: *“Ai nuk është shprehur se si do të jetë bota pas luftës me të njëjtën qartësi dhe bindje me të cilën ka vijuar luftën ... por e konsideroj atë një figurë të madhe”*.⁵⁶ Dhe në të vërtetë, kjo është ajo për të cilën kanë nevojë Shtetet e Bashkuara në Ukrainë: për një figurë, pa fuqi vendimmarrëse, që të vazhdojë luftën, që t'i mbajë tensionet e larta me Rusinë dhe ta shesë vendin për armë, ndërsa përgatitet për falimentimin përfundimtar.

Për të ardhmen e Ukrainës – arsyeja e vërtetë formale e të gjithë operacionit anti-rus – as që diskutohet. Për Perëndimin, e vetmja e ardhme e mundshme për popullin ukrainas qëndron në lëmshën e dhënë nga kapitali që do të shkojë për ta shfrytëzuar atë në fund të luftës. Dhe e vetmja e tashme e mundshme është vazhdimi i financimit dhe armatimi i saj për ta çuar drejt vdekjes në luftën kundër ish motrës së saj ushtarakisht superiore, Ruisë.

Vendet e NATO-s po konkurrojnë për të dërguar para dhe armë përmes huave dhe dhuratave, duke u përpjekur të kënaqin kërkesat e vazhdueshme të

56 Time, Henry Kissinger: The Internet Does Not Make Great Leaders.

luftës të Presidentit Zelensky. Megjithatë, asnjë vend, parti apo grup solidariteti nuk shqetësohet se si populli ukrainas, i shkatërruar nga lufta dhe nga lufta civile, do të shlyejë borxhet e tij.

Sipas parashikimeve të Bankës Botërore, në vitin 2022, Ukraina do të pësojë një tkurrje të prodhimit të brendshëm bruto prej 45% në krahasim me vitin 2021.⁵⁷ Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim është më e kujdesshme dhe vlerëson se rënia e prodhimit do të jetë “vetëm” me 30%, duke theksuar megjithatë se 30% deri në 50% e kompanive tashmë kanë ndërprerë plotësisht aktivitetin e tyre, me humbjen e rreth gjysmës së vendeve të punës.⁵⁸ Tërheqjet e parave janë të kufizuara dhe transaksionet ndërkomëtare kontrollohen nga autoritetet qeveritare. Humnera fiskale e shkaktuar nga rënia e të ardhurave, nga taksat dhe shpenzimet marramendëse të armëve, vlerësohet në 5 miliardë dollarë në muaj.⁵⁹ Financiarisht, Ukraina është tashmë teknikisht në default.

Nga janari 2021 deri në janar 2022, Banka Qendrore e Ukrainës rriti normën e skontimit gjashtë herë radhazi nga 6% në 10% në një përpjekje për të frenuar inflacionin dhe për të mbrojtur kursin e këmbimit.⁶⁰ Një politikë që shkon, së paku, kundër rrymës, në një kohë kur Shtetet e Bashkuara dhe BE-ja e mbushnin sistemin monetar me likuiditet në kundërpërgjigje të krizës ekonomiko-financiare të shkaktuar nga strategjia antipandemike. Megjithatë, është me ndërhyrjen ruse ose, më saktë, me sanksionet perëndimore kundër Rusisë, që gjendja financiare e Ukrainës merr taktëpjetën.

57 World Bank, Russian Invasion to Shrink Ukraine Economy by 45 Percent this Year.

58 European Bank for Reconstruction and Development, Ukraine overview.

59 Reliefweb, War to cause Ukraine economy to shrink nearly a third this year - EBRD report.

60 Trading Economics, Ukraine interest rate.

Fillimisht, Banka Qendrore heziton të shtrëngojë më tej politikën monetare dhe mbështetet kryesisht në ndihmat e jashtme. Këto, megjithatë, e shtyjnë në kohë problemin pa e zgjidhur dhe, në të vërtetë, përfundojnë duke e përkeqësuar. Vazhdimi i huamarrjes së parave, ndërkohë që angazhimi në luftë mbizotëron mbi prodhimin, me një borxh publik tashmë jashtë kontrollit, mundëson shmangien e default-it të menjëhershëm, por rrezikon çdo konsolidim të mundshëm të financave publike në të ardhmen.

Në mungesë të një plani të besueshëm të shlyerjes së borxhit, tregjet financiare vendosin kushte financiare gjithnjë e më të vështira për Ukrainën. Brenda pak muajsh, ndërsa të gjithë po shikonin Rusinë dhe krizën e supozuar financiare që duhet t'i jepte goditjen përfundimtare, Banka Qendrore e Ukrainës u detyrua të ndryshonte strategjinë e saj.

Përballë dobësisë në rritje të hryvnia-s – monedhës kombëtare të Ukrainës – më 2 qershor 2022, Banka Qendrore rrit normën e skontimit me plot 15 pikë përqindje, duke e çuar atë në 25%, një nivel që Ukraina nuk e njihte që nga viti 2015. Kjo i asgjëson investimet në një vend ku më shumë shkatërrohet se sa prodhohet.

Mirëpo kjo nuk shërben për asgjë: problemi nuk është thjesht financiar, janë bazat e ekonomisë që janë në rënie të lirë. Më në fund, më 21 korrik 2022, Banka Qendrore njofton zhvlerësimin e hryvnia-s me 25% kundrejt dollarit: nga 29.25 në 36.57 hryvnia për dollar.⁶¹

Para grushtit të shtetit të shkurtit 2014, monedha ukrainase ishte e qëndrueshme në rreth 8 hryvnia për dollar. Viti i parë pas grushtit të shtetit shënroi shkatërrimin e hryvnia-s, e cila, në shkurt 2015, u zhyt në 27 kundrejt dollarit, për t'u stabilizuar më

61 Reuters, Ukraine devalues hryvnia currency by 25% against U.S. dollar.

pas në vitet në vijim në një interval prej 23-27 hryvnia për dollar, falë ndihmës ndërkombëtare. Me zhvlerësimin e fundit, humbja në vlerë e hryvnias që nga viti 2014 është 350%. Konkretisht, për popullin ukrainas, do të thotë të paguajnë gjithçka më shumë, nga ilaçet te armët: ajo që kushtonte 1, tani kushton 4.5.

Për një vend me varësi të madhe nga tregtia me jashtë, një zhvlerësim i këtyre përmasave do të thotë se ora e falimentimit është afër. Ukraina ka - ose, më saktë, kishte - Rusinë si partnerin e dytë më të madh të importit (pas Kinës) dhe si destinacionin e tretë më të madh të eksportit (pas Kinës dhe Polonisë).⁶² Lufta ekonomike, edhe para luftës ushtarake, është thjesht e papërballueshme për Ukrainën.

Pasi hoqi dorë nga avantazhet tregtare dhe zbritjet e çmimeve të ofruara nga Rusia, veçanërisht në çështjet energjitike, Ukraina tani importon naftë dhe gaz rus përmes aleatëve të saj perëndimorë: në vend të një zbritjeje prej 30% mbi çmimin e tregut (që në mungesë të tensioneve politike do të ishte afërsisht gjysma e asaj që mbizotëron aktualisht), vendi aspirant për BE/NATO blen me çmimet aktuale, tani në rritje, për të cilat, vendeve perëndimore, iu paguan edhe një komision ndërmjetësimi. Dhe, sikur të mos mjaftonte, paguan gjithçka katër herë e gjysmë më shtrenjtë për shkak të zhvlerësimit të hryvnia-s.

Një fuçi naftë, e cila në kohë normale do të kushtonte 50 dollarë në tregjet ndërkombëtare, do t'iu kushtonte 35 dollarë sipas kushteve ruse, domethënë 280 hryvnia (35 shumëzim për 8). Ndërsa tani, nafta kushton 100 dollarë dhe, duke lënë mënjanë kostot shtesë të kalimit në një vend të tretë, e njëjta fuçi naftë kushton 3.657 hryvnia (100 shumëzim për 36.57). Me një rritje të tillë të kostove dhe me normën e interesit 25%, asnjë aktivitet ekonomik nuk mund të jetë fitimprurës në Ukrainë, përveç industrisë së luftës.

Recesioni, inflacioni, zhvlerësimi dhe borxhi nuk janë argumentet më të mira për të shkuar në tregjet financiare e për të kërkuar më shumë ndihmë. Besueshmëria financiare e Ukrainës tani është inekzistente dhe këto masa ekstreme e vërtetojnë këtë. Nuk është më çështje çmimi, por çështje kohe. Financiarisht, letrat me vlerë të borxhit të Ukrainës janë si letër bakalli. Nëse çmimi i tyre nuk shkon drejtpërdrejt në zero, kjo është vetëm falë politikës.

Në fakt, ndërkohë që kreditorët institucionalë – kryesisht vendet perëndimore – në këtë fazë janë gati të bëjnë gjithçka për të shmangur default-in e shtetit ukrainas, investitorët privatë nuk janë aspak të të njëjtit mendim. Kësisoj, ndërsa Grupi i Kreditorëve – i cili përfshin Shtetet e Bashkuara, Kanadanë, Mbretërinë e Bashkuar, Gjermaninë, Francën dhe Japoninë – bie dakord të shtyjë mbledhjen e interesit mbi borxhin, kompanitë private kërkojnë në vend të tyre pagesën e borxhit.⁶³

Prandaj, në thelb, është kapitali publik i shteteve perëndimore që i lejon Ukrainës të shlyejë borxhet e kontraktuara me investitorët privatë (perëndimorë), duke e shtyrë default-in në një datë të papërcaktuar. Dhe, në momentin e default-it, që është i pashmangshëm financiarisht, do të jenë sërish shtetet që do t'i përballojnë kostot, duke ia lënë përfitimet kapitalit privat. Por, në fakt, një e dhënë e njohur nga të gjithë – shtetet, bankat, kompanitë dhe organizatat ndërkombëtare – është se Ukraina nuk ka para për të shlyer e as nuk do ketë.

Ndërkohë, ukrainasit (dhe rusët) që arratisen nga dhuna naziste, të cilët përgjatë viteve ishin refugjatë në vendet e BE-së, kanë parë t'iu bllokohen procedurat e bërjes së dokumenteve, për t'ua lënë vendin emigrantëve të rinj të klasit të parë. Në Ukrainë, nga ana tjetër, qindra fëmijë të lindur nga nëna surrogate janë

63 US Department of Treasury, Statement by the Group of Creditors of Ukraine.

lënë në pritje për të njohur prindërit e tyre, dhe qindra gra shtatzëna me fëmijë të tjerëve, që kanë ikur nga zonat e konfliktit, nuk dinë ku të lindin, nga frika se mos e gjejnë veten nëna edhe ligjërisht – kundër qëllimeve të tyre – nëse lindja nuk bëhet në një klinikë të paracaktuar në kontratë. Ndërsa Evropa ngre dollari për çifte të gjitha gjinive dhe të drejtën e tyre për të pasur fëmijë, Ukraina është ndër vendet ku mitrat me qira janë më të lira: ka 50 klinika riprodhuese, të cilat lindin 2,500 foshnja në vit, të destinuara për çifte të huaja. Fatkeqësisht, me luftën, gjithçka është bërë më e rrezikshme: nga prodhimi deri te dorëzimi i maltrave.⁶⁴

Përballë dramës së situatës në Ukrainë, Beton-ët – një grup punk pak a shumë i panjohur nga Kievi – fituan një sukses të madh mediatik për interpretimin e këngës së famshme të The Clash, *London calling*, me nota anti-Putin, duke e shndërruar atë në *Kyiv calling*. Në këngë, treshja ukrainase me frymëzim britanik bën thirrje për ndihmë ushtarake dhe armë për Ukrainën dhe zëvendëson mbylljen e grupit anglez “*And after all this, won't you give me a smile?*” me “*And after all this, won't you give me an airforce?*”. Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula Von Der Leyen, e cila gjithashtu mburret me një të kaluar punk, shpërbleu krijimtarinë e Beton-save duke i garantuar Ukrainës armë dhe para. Megjithëse i vetmi refren që i ka mbetur në kokë, qysh kur merret me Ukrainën, nuk është nga The Clash por nga Sex Pistols: “*No future, no future, no future for you!*”

64 DW, Ukraine's surrogate mothers trapped between the frontlines.

Fitues dhe humbës në Frontin Lindor

Kodi i heshtur i operacioneve ndërkombëtare parashikon që plaçka e luftës – nga rindërtimi deri te privatizimet dhe emërimet politike – të ndahen në përpjesëtim me ndihmën e dhënë në luftë. Në një rast si ky, ku asimetria e fuqisë dhe e interesave mes Shteteve të Bashkuara dhe BE-së është e dukshme, ka dyshime të ligjshme se kjo do të ndodhë. Por BE-ja ka zgjedhur prapëseprapë që të qëndrojë përkrah vendit udhëheqës dhe të mbajë mbi supe të gjithë çmimin e sanksioneve. Pavarësisht se janë të ngarkuara me borxhe, vendet evropiane po vazhdojnë me kreditë për Ukrainën dhe sanksionet kundër Ruisë, duke e ditur se të parat nuk mund të shlyhen dhe se këto të fundit kanë efekte serioze ekonomike për vetë BE-në.

Për Washington-in, e për rrjedhojë për BE-në, problemi nuk ka qenë kurrë ndërtimi i një të ardhmeje për Ukrainën, por lënia e Ruisë pa një perspektivë. Problemi është se, veçanërisht për BE-në, antagonizmi i Ruisë nuk është tamam një lojë dytësore.

Rusia është vendi më i madh në botë: sipërfaqja e saj është pothuajse dyfishi i asaj të Kanadasë, Kinës dhe Shteteve të Bashkuara dhe është pothuajse tre herë më e madhe se ajo e Evropës jo-ruse (vetëm pjesa evropiane e Ruisë mbulon rreth një të tretën e tokës evropiane). Në vitin 2020, ajo ishte eksportuesja më e madhe në botë i gazit, grurit, hekurit gjysëm të gatshëm, peshkut të ngrirë, nikelit të papërpunuar dhe gizës. Është gjithashtu e pasur me lëndë të para të rëndësishme – jo vetëm hidrokarbure – dhe është teknologjikisht e avancuar në shumë sektorë strategjikë. Për dekada ajo ka funksionuar duke e raciona-

lizuar tregtinë brenda një ekonomie të planifikuar, dhe ka jetuar në armiqësi me perëndimin gjatë gjithë periudhës sovjetike.

Ekonomikisht, ajo është ekonomia e njëmbëdhjetë më e madhe në botë për nga prodhimi i brendshëm bruto dhe tani është plotësisht e integruar në tregtinë botërore. Partneri kryesor tregtar i saj është BE-ja, ku shkojnë 37.9% e totalit të eksporteve dhe nga e cila vijjnë 40% e importeve. Nga ana tjetër, duke marrë parasysh vendet individualisht, vendi i parë i destinacionit për eksportet ruse është Kina, e ndjekur nga Gjermania dhe Holanda, ndërsa renditja e vendeve nga të cilat importon Rusia, në vendet e para janë Kina, Mbretëria e Bashkuar dhe Gjermania.⁶⁵

Nga pikëpamja financiare, Rusia është e qëndrueshme: rubla konsiderohet një monedhë e besueshme dhe të dhënat e financave publike janë absolutisht të mira. Borxhi publik është 17.7% e PBB-së, i nënti më i ulët në botë, kundrejt 90.0% të BE- në, 97.2% të zonës së euros, 128.0% të Shteteve të Bashkuara dhe 93.9% të Mbretërisë së Bashkuar.⁶⁶

T'i vendosësh embargo një vendi të tillë është ekonomikisht e kushtueshme dhe e rrezikshme. Edhe pse padyshim jo për të gjithë njësoj: për Shtetet e Bashkuara, kostot dhe rreziqet janë të papërfillshme; ndërsa për BE-në, përkundrazi, janë të papërbalueshme. Për të mos përmendur rrezikun që nga lufta ekonomike të kalohet në armë, sepse teatri i konfliktit është në Evropë, jo në Shtetet e Bashkuara.

Të dhënat gjeografike dhe makroekonomike nuk janë sekrete shtetërore. Sanksionet thjesht kanë dhënë efektin e dukshëm, të parashikueshëm e të parashikuar nga të gjithë aktorët në lojë: BE-ja ka parë t'i dyfishohet çmimi i gazit dhe i naftës, por, duke mos

65 OEC World, Russia.

66 Trading Economics, Country list government debt to Gdp.

bërë dot pa to, vazhdon ta importojë duke paguar më shtrenjtë. Rusia, nga ana e saj, ndërsa lidhet me evropianët sipas ligjeve të tregut aq të dashur për ta, ofron zbritje për vendet jo-armiqësore dhe zgjerohet mbi të gjitha në Azi.

Rezultati: ndërsa Ukraina është vënë në rrezik të madh ushtarakisht dhe ekonomikisht, dhe BE-ja lufton në kërkimin e burimeve të reja të furnizimit me energji, Azia dyfishon importet e saj të gazit dhe naftës ruse në krahasim me nivelet para sulmit rus, duke u bërë tregu kryesor për Rusinë, përpara Evropës. Për sa i përket valutave, përpjekja për të fundosur rublën përfundon me një rritje të madhe të monedhës ruse dhe rënien e lirë të euros. Ndërsa fitimet e kompanive perëndimore që bëjnë biznes me Rusinë bien ndjeshëm.

Me pak fjalë, me hedhjen poshtë të objektivit sipas të cilit Perëndimi, pasi ka destabilizuar zonën dhe ka shkaktuar grushtin e shtetit, është i interesuar papritur për fatin e popullit ukrainas, bie edhe objektivi për të dobësuar Rusinë. Ose të paktën, nëse ky ishte vërtet qëllimi përfundimtar, rezultati është vështirë të arrihet, dhe e gjithë strategjia e SHBA-BE duket paksa e palogjikshme. Nëse, në të kundërt, shikojmë strategjitë e zgjerimit të kapitalit amerikan në Evropë, nënshtrimin historik të BE-së ndaj Shteteve të Bashkuara dhe interesat e kundërta brenda BE-së, gjërat marrin më shumë kuptim.

Fitues dhe humbës në Frontin Perëndimor

Le të shqyrtojmë marrëdhëniet e brendshme në Frontin Perëndimor. Të parët që vendosën embargon ndaj gazit dhe naftës ruse janë Shtetet e Bashkuara, menjëherë pas pushtimit rus. Sakaq pas kësaj, ata ushtruan presion ndaj BE-së për të miratuar masa të ngjashme.

Pasi sulmoi ushtarakisht dhe ekonomikisht furnizuesit historikë të energjisë nga të cilët Evropa furnizohej (Iran, Irak, Libi, Venezuelë), Shtetet e Bashkuara tani janë kundër Ruisë. Nuk është hera e parë që përfshijnë aleatët evropianë në fushata ekonomike dhe ushtarake me interes të dyshimtë për sigurinë e BE-së dhe për marrëdhëniet e saj tregtare. Megjithatë, këtë herë, për vendet e BE-së, embargoja ndaj Ruisë është një vetëvrasje e vërtetë ekonomike: Rusia sot është furnizuesi kryesor evropian dhe pa energjinë ruse ekonomia evropiane shuhet.

Shtetet e Bashkuara, megjithatë, nuk duan aspak vdekjen ekonomike të Evropës. Ata duan të bëjnë biznes me BE-në dhe të fitojnë para. Për këtë, ndërsa i imponojnë BE-së një problem që nuk e kishte, i japin edhe zgjidhjen: jo më gaz rus, por gaz amerikan.

Nëse kostot e armiqësisë ndaj Ruisë janë asimetrike midis vendeve të Paktit të Atlantikut, përfitimet janë vërtet të njëanshme dhe shkojnë të gjitha matanë oqeanit. BE-ja paguan dhe SHBA-ja fiton. BE-ja ndryshon importuesin e saj, Shtetet e Bashkuara fitojnë një treg.

Zëvendësimi i importit të gazit nga Rusia në Shtetet e Bashkuara është një proces i gjatë dhe i kushtueshëm, i cili shton zëra të rinj shpenzimesh në procesin e transformimit dhe shpërndarjes, të gjitha në ngarkesë të BE-së: transpor-

ti me anije çisterna, terminalët e ngarkimit dhe shkarkimit, infrastruktura e stokimit, rigazifikimi dhe lidhjet me tubacionet tradicionale të gazit. Ndërtimi i këtyre infrastrukturave nuk mund të improvizohet. Përkundrazi, kërkon investime shumëvjeçare të cilat do të rëndojnë mbi çmimin përfundimtar të energjisë.

Nëse kjo është tabloja, rritja e çmimeve të energjisë, sot e lidhur me spekulimet dhe pasigurinë e situatës politike ndërkombëtare, nuk duhet të konsiderohet aspak e përkohshme. Përkundrazi, Evropa duhet të mësohet të jetojë me çmimet në rritje të energjisë për arsyen e thjeshtë se po përjashton nga lista e furnizuesve më të mëdhenjtë e më të lirët.

Sipas vlerësimeve, rritja e importeve të gazit nga Shtetet e Bashkuara nuk do mjaftonte për të zëvendësuar importet e gazit nga Rusia. Shkurt, për BE-në, problemi nuk është vetëm çmimi, por edhe sasia: rritje çmimesh dhe sasi e pamjaftueshme energjie.

E vërteta është se qëllimet strategjike të Washington-it ndaj BE-së, në frontin e energjisë, kanë një histori të gjatë. Pas krizës financiare 2007-2009, Shtetet e Bashkuara investuan shumë në sektorin e energjisë: midis 2011-s dhe 2014-s, prodhimi amerikan i gazit natyror të lëngshëm u rrit me 70% dhe, në vitin 2018, Shtetet e Bashkuara u bënë prodhuesi kryesor në botë i naftës, duke tejkaluar Rusinë dhe Arabinë Saudite.⁶⁷ Kjo rritje e shpejtë e prodhimit padyshim që ka nevojë për shitje dhe Shtetet e Bashkuara po mbështeten në Evropë. Në vitin 2021, përpara pushtimit rus të Ukrainës, eksportet e gazit të lëngshëm të SHBA-së në BE ishin rritur tashmë me 37% krahasuar me vitin e mëparshëm.

Për t'iu imponuar tregjeve botërore këtë rritje mbresëlënëse të prodhimit të energjisë, Shtetet e

67 EIA, Oil and petroleum products explained.

Bashkuara nuk po përdorin thjesht levën ekonomike të përfitimit reciprok, por po lëvizin, si gjithmonë, përmes kanaleve politike e diplomatike. Edhe sepse gazi i lëngshëm amerikan është më i shtrenjtë, me cilësi më të dobët dhe prodhohet me teknika shumë më ndotëse se gazi rus.

Gjatë ndërtimit të gazsjellësit Nord Stream 2, i cili lidh Rusinë me Evropën Perëndimore, Shtetet e Bashkuara e kundërshtuan fuqishëm projektin. Nga pikëpamja juridike, nuk ka rregulla që lejojnë një vend të shqyrtojë një projekt të ndërmarrë në një kontinent tjetër, nga kompani krejtësisht të ligjshme, brenda marrëveshjeve midis shteteve sovraane. Nga pikëpamja ekonomike, gjithsesi, është e qartë për të gjithë – shtetet dhe kapitalet private – se Shtetet e Bashkuara mbrojnë interesat e kompanive të tyre të naftës pavarësisht kufijve territorialë. Në fund, për t'i dhënë dritën jeshile projektit, ata i kanë kërkuar Gjermanisë të ndërtojë një platformë rigazifikimi për gazin e lëngshëm të prodhuar në SHBA. Në fushën e energjisë, Gjermania është sidoqoftë jo vetëm një nga vendet evropiane më të varura nga Rusia, por luan gjithashtu një rol të rëndësishëm në tranzitin dhe ridrejtimin e energjisë ruse drejt pjesës tjetër të Evropës.

Në lidhje me aleatët dhe armiqtë, plani i Washington-it është i njëjtë: të pushtojë një treg të ri të rëndësishëm për kompanitë e naftës amerikane dhe të parandalojë zhvillimin e marrëdhënieve midis Ruisë dhe BE-së, duke i dobësuar të dyja. Ajo që mbetet për t'u sqaruar dhe që nuk do të jetë e qartë derisa perspektiva e analizës të zgjerohet për të përfshirë kuadrin global imperialist, është strategjia e BE-së, për të mos thënë pak, deri tani kontradiktore.

Default-et financiare ndërkombëtare

Lufta ekonomiko-financiare kundër Ruisë i jep një rol të rëndësishëm, të paktën në narrativën mediatike, problemit të borxhit publik rus, i cili, siç e pamë, praktikisht nuk ekziston.

Kundër borxhit rus, të parat që lëvizin janë tre agjencitë e mëdha “të pavarura” të *rating* ndërkombëtar: Moody’s, Fitch dhe Standard and Poor’s. Menjëherë pas pushtimit rus, në mars të vitit 2022, të tria agjencitë i ulin treguesit për obligacionet ruse me shumë pikë, deri në të ashtuquajturin nivel “junk” (mbeturinë).⁶⁸

Megjithatë, vetëm në qershor, Shtetet e Bashkuara arrijnë të sajojnë default-in teknik të Ruisë. Kjo në fakt përbën lajm për gazetatat politike, por jo për tregjet financiare: default-i teknik në fakt është shkaktuar nga vendimi i Shteteve të Bashkuara për të përjashtuar Ruisë nga sistemi i pagesave ndërkombëtare, i cili, teknikisht, pengon pagesën e interesave kreditorëve amerikanë.

Efektin e vetëm real të default-it e paguajnë kursimtarët amerikanë. Por besueshmëria e Ruisë nuk preket aspak: sepse default-i nuk vjen nga paaftësia financiare e Ruisë ose mungesa e vullnetit politik për të shlyer borxhet e saj, por nga pamundësia teknike për ta bërë këtë, si pasojë e vendimit të kreditorit.

Pra, në tregje nuk ndodh absolutisht asgjë: asnjë panik financiar dhe asnjë ikje nga rubla ose nga obligacionet ruse. Titujt në gazeta tingëllojnë më shumë si propagandë politike sesa si paralajmërim për inve-

68 CBS News, Russia’s credit rating slashed to junk, same as Angola and Nicaragua.

stitorët. Ato kanë të njëjtën peshë si supozimet për shëndetin e dobët të Presidentit Putin, dhe për rezistencën heroike ukrainase, e cila do ta mposhte pushtuesin sikur të kishte pak ndihmë nga miqtë, si në këngën e The Beatles-ave: “Oh, I get by with a little help from my friends”, me Zelensky-n si Ringo Starr dhe liderët e vendeve të NATO-s që bëjnë korin.

Kremlini nuk shqetësohet aspak dhe zëdhënësi i tij Dmitry Peskov replikon, me thjeshtësinë e fëmijës: “Pagesa në valutë është bërë, fakti që fondet nuk u janë transferuar marrësve nuk është problemi ynë”.⁶⁹

Autoritetet ruse e kanë denoncuar gjithashtu që në fillim paligjshmërinë e sekuestrimit të qindra miliardë dollarëve pronë të Bankës Qendrore të Ruisë, duke e barazuar atë me një default faktik të Shteteve të Bashkuara, Mbretërisë së Bashkuar dhe BE-së ndaj Ruisë. Megjithatë, pikërisht për shkak të peshës së ulët të borxhit publik ndaj buxhetit të shtetit, Rusia ka preferuar të vazhdojë të paguajë borxhet e saj, të paktën për aq kohë sa është teknikisht e mundur.

Problemi i vërtetë me të cilin amerikanët dhe evropianët nuk duan të përballen është se në një moment Rusia mund të ndryshojë qëndrimin e saj edhe në nivel ekonomik-financiar, përveçse në atë ushtarak. Në të vërtetë, Banka Qendrore e Ruisë nuk ka nevojë të presë për ndonjë default teknik nëse vendos të godasë kreditorët anglo-saksonë ose evropianë. Thjesht, ai mund t’u thotë: “*rimbursohuni nga qeveritë tuaja me fondet që na kanë sekuestruar në mënyrë të paligjshme*”.

Sipas së drejtës ndërkombëtare, kjo do të ishte një përgjigje koherente dhe konsistente ndaj konfiskimit të fondeve nga Banka Qendrore e Ruisë. Megjithatë, në nivelin ekonomik-financiar, autoritetet monetare ruse dinë t’i bëjnë mirë llogaritë e tyre. Strategjia financiare e Moskës, ndonëse në thelb

69 Reuters, Russia, rejecting default, tells investors to go to western financial agents.

mbrojtëse, mund të jetë çdo gjë përveçse e improvizuar. Besueshmëria financiare ndërkombëtare nuk vihet në rrezik për disa tituj të borxhit publik.

Zhvillimet e luftës ekonomike

Në nivel strategjik, Shtetet e Bashkuara nuk kanë interes për zgjidhjen e shpejtë të konfliktit. Vendet evropiane duhet të ndjekin një trajektore energjetike e tregtare që i largon nga Rusia një herë e përgjithmonë. Në fushën e energjisë dhe më gjerë. Ky është qëllimi afatgjatë.

Ndërkohë, embargoja energjetike ndaj Ruisë hap derën e tregut evropian për gazin natyror të lëngshëm amerikan. Për momentin, përmes përdorimit më intensiv të impianteve ekzistuese. Me kalimin e kohës, nëpërmjet riorganizimit të të gjithë sistemit të furnizimit me energji të kontinentit të vjetër.

Kostot e tranzicionit janë tërësisht në ngarkim të vendeve evropiane: në fakt janë ato që duhet të ndërtojnë një rrjet të ri infrastrukturor të përshtatshëm për transformimin dhe shpërndarjen e gazit amerikan.

Kostove të tranzicionit iu shtohet edhe rritja e shpenzimeve për blerjen e energjisë, duke qenë se në skenarin e ri pa energjinë ruse, kostot më të larta do të përkojnë me çmimet më të larta.

Pastaj është një problem i tretë, të cilin sapo e përmendëm: deri më tani, me sa duket, BE-ja ka dëgjuar kryesisht zërin e Shteteve të Bashkuara – e cila në këtë konflikt ka shumë pak për të humbur – pa u kujdesur shumë për angazhimet me Rusinë. Megjithatë, është e qartë se, gjatë gjithë periudhës së tranzicionit, për sa kohë që Evropa vazhdon të jetë e varur nga gazi rus dhe të shkelë marrëveshjet ndërkombëtare (konfiskimi i fondeve nga institucionet sovraane kombëtare përbën një shkelje mjaft serioze të së drejtës ndërkombëtare), vendet evropiane mbeten të ekspozuar ndaj masave të mundshme hakmarrëse nga Rusia.

Për këtë arsye, ndërsa Perëndimi po hedh benzinë në marrëdhëniet me Rusinë, në të njëjtën kohë po maksimizon rezervat e naftës dhe gazit në të dyja anët e Atlantikut. Në fakt, si në Washington ashtu edhe në Bruxelles e dinë se nëse Rusia vendos vërtet të mbyllë rubinetin e gazit për vendet armiqësore, Evropa nuk do ta kalonte dimrin.

Efekti destabilizues i një kundër-embargoje ruse në vetë stabilitetin e BE-së do të ishte i menjëhershëm. Sigurisht që rreziqet e një përshkallëzimi ushtarak, me një rezultat të pasigurt, do të rriteshin më tej. Por, nga pikëpamja e luftës ekonomike, është e qartë se Rusia ka armë më të fuqishme në duart e saj dhe, edhe politikisht, nuk është një armik i lehtë për t'u nënshtruar.

Nga këndvështrimi i Ruisë, megjithatë, marrëdhëniet me Perëndimin janë vetëm një aspekt i problemit. Pikërisht për shkak se është e detyruar nga SHBA-ja dhe BE-ja, qeveria ruse po punon për të krijuar hapësirën e saj ekonomike dhe për të ndërtuar reputacionin e saj financiar. Edhe në periudhën afatmesme dhe afatgjatë, strategjia perëndimore kundër Ruisë rrezikon të kthehet në një bumerang: duke vendosur barriera kundër vendeve me madhësinë e kontinenteve, Perëndimi përfundon duke u izoluar ekonomikisht dhe duke përshpejtuar rënien e tij në lidhje me blloqet kundërshtare të cilat ai vetë ndihmon që të forcohen.

Në ekonominë reale, dinamikat më të fundit tregojnë se roli i grupit BRIKS-it po rritet: pikërisht në përgjigje të politikës së SHBA-së, më 27 qershor 2022, edhe Irani e Argjentina kërkuan t'i bashkohen grupit.

Në fushën financiare, krahas lëvizjeve propagandistike, siç e pamë, vendimi që ndryshon në thelb shifrat në bilanci e institucioneve publike dhe private, ruse dhe perëndimore, është sekuestrimi i fondeve të Bankës Qendrore të Ruisë. Mirëpo, edhe

në këtë rast, kemi të bëjmë me një lëvizje me pasoja të dyfishta për Shtetet e Bashkuara. Nga njëra anë, Shtetet e Bashkuara po i tregojnë botës se levat financiare i kanë akoma në dorë ata. Nga ana tjetër, pikërisht kjo shfaqje arrogance dhe pushteti tregon prapambetjen e financave amerikane në proceset ndërkombëtare të rregullimit financiar, të cilat gjithnjë e më shumë bazohen në grabitje sesa në ligjet e tregut.

Që nga lufta në Libi e këtej, Shtetet e Bashkuara kanë nisur një protokoll të ri të luftës ekonomike që fillon pikërisht me sekuestrimin e fondeve të bankave qendrore të shteteve sovraane të shpallura armike. Në të ardhmen e afërt, këto akte pa bazë juridike ndërkombëtare, të bazuara vetëm në arrogancën ekonomiko-ushtarake, i shkaktojnë dëme serioze vendit të synuar. Kjo është si një vjedhje e mirëfilltë nga arkat e bankës qendrore: qindra miliarda dollarë, të barazvlefshme me vite eksporte, të investuara në qendrat financiare të konsideruara më të besueshmet, të zhdukura përgjithmonë, me një të rënë të lapsit, pa vlefshmëri ligjore. Në terma afatgjatë, këto abuzime minojnë besueshmërinë e institucioneve bankare dhe financiare që i zbatojnë ato.

Sado që qendrat financiare më të zhvilluara dhe më tërheqëse janë në Perëndim, shumë banka qendrore dhe institucione financiare ndërkombëtare po rishikojnë strategjitë e tyre për alokimin e rezervave monetare. Tanimë, kur një investitor ndërkombëtar vlerëson nëse do të investojë në Shtetet e Bashkuara, ai duhet të llogarisë primin e rrezikut që lidhet me ngrirjen e mundshme të fondeve. Nuk është rastësi që në vitin 2021, për herë të parë që nga viti 2010, ekspozimi i Kinës ndaj borxhit të qeverisë amerikane ra nën 1 trilion dollarë, një rënie prej 100 miliardë dollarësh krahasuar me një vit më parë.⁷⁰

70 CNBC, China holdings of U.S. debt fall below \$1 trillion for the first time since 2010. Wall Street Journal, If Russian

Zhvillimi i zonave të reja ekonomike dhe valutave alternative ndaj dollarit dhe ripërcaktimi i bilanceve financiare ndërkombëtare janë procese që nuk janë të shkruara një herë e përgjithmonë, dhe ka shumë faktorë rreziku në strategjinë e SHBA-së. Por ky është një rrezik i llogaritur.

Nga pikëpamja financiare, hegjemonia e dollarit sigurisht që është duke perënduar, por ka ende shumë për të bërë. Qendrat financiare amerikane mbeten më të rëndësishmet dhe nuk është rastësi që, ndërkohë që janë të vetëdijshme për rreziqet politike, institucionet financiare, duke përfshirë bankat qendrore, gjenden të papërgatitura kur vendosen sanksionet.

Dollari, për momentin, nuk shfronësohet dot. Kjo u pa qartë me krizën financiare të marsit 2020, kur Rezervës Federale (Fed, Banka Qendrore e Shteteve të Bashkuara) iu desh t'iu shkante në ndihmë të gjitha bankave qendrore të botës (duke lënë jashtë vetëm Bankën Qendrore Kineze) në mënyrë që të mund të shpëtonin sistemet përkatëse bankare, me këmbime të mëdha rifinancimi në dollarë. Në të gjithë botën, në tregti nevojiten dollarë, dhe pjesët e mallrave në tregjet ndërkombëtare caktohen në dollarë. Forcimi i rublës mund të jetë një fakt politik pozitiv për Rusinë, por sigurisht nuk është një problem financiar për dollarin.

Megjithatë, nga pikëpamja e financave ruse, rritja e kursit të këmbimit i përgjigjet në mënyrë të efektshme luftës ekonomike të nisur nga perëndimi, por nënkupton edhe që të ardhurat nga eksporti të shkojnë për të forcuar monedhën në vend që të shkojnë për zhvillimin e ekonomisë reale. Në afatshkurtër kjo është një përgjigje pothuajse e detyrueshme. Në planin afatgjatë, ka rrezik të jetë më problematike. Rusia mund të fitojë një lojë, por fijet i lëvizin Shtetet e Bashkuara.

Currency Reserves Aren't Really Money, the World Is in for a Shock.

Në fakt, po ta shohim me kujdes, në efektshmërinë e tyre, përgjigjet ruse janë tipike të ekonomisë politike, nuk janë befasi për askënd, të paktën në qendrat strategjike të lojtarëve në fushë. Për më tepër, Rusia do të kishte preferuar të vazhdonte të bënte biznes me Evropën, ndërkohë që rishënonte hapësirën e saj në Azi, në vend që të gjendej në një luftë ekonomiko-ushtarake kundër fuqisë së parë ekonomiko-ushtarake në botë dhe të gjithë aleatëve të saj. Dhe nëse do donte vërtet të ishte ajo që do t'i shpallte luftë Perëndimit, sigurisht që nuk do të priste fundin e dimrit për të nisur fushatën ushtarake dhe luftën energjetike.

E vërteta këtu është se të gjitha këto tendenca potencialisht kontradiktore janë vënë në lëvizje prej Shteteve të Bashkuara që, në nivel strategjik, sigurisht nuk improvizojnë. Ndeshja me Rusinë është në fakt pjesë e përplasjes imperialiste globale për kontrollin e teknologjive të reja, e cila është ndezur me ardhjen e pandemisë, dhe ku Shtetet e Bashkuara janë mes protagonistëve kryesorë. Në lojë nuk janë vetëm armiqtë e vjetra politike dhe planet për pushtime ushtarake, të përcaktuara pas rënies së Bashkimit Sovjetik, por vendosja, në mbarë botën, e një modeli të ri marrëdhëniesh ekonomike dhe sociale, të përqëndruara në teknologjitë e reja.

3. Përplasja ruso-ukrainase në kontekstin post-pandemik

Lufta midis Rusisë dhe Ukrainës nuk është thjesht pjesë e procesit të zgjerimit të NATO-s, por është pjesë e një konteksti shumë specifik të përplasjes imperialiste mes blloqeve kapitaliste të kombësive të ndryshme, që veprojnë në sektorë të ndryshëm të ekonomisë.

Paketa e masave ekonomike dhe sociale të miratuara në shkallë globale, në emër të luftës kundër pandemisë, është pjesë e strategjive përmes të cilave këta blloqe kapitalistë koordinohen dhe përplasen. Në këtë proces, Rusia dhe Ukraina sigurisht që nuk janë protagonistë.

Në fakt, pas strategjisë për të luftuar kundër Covid-it fshihen interesa të forta ekonomike nga ana e kapitalit ndërkombëtar. Dhe është pikërisht duke qartësuar këto interesa – më shumë se duke e paraqitur Rusinë si një fuqi imperialiste me synime luftarake ekspansioniste – që ne e kuptojmë më mirë rëndësinë strategjike të detyrimit të Rusisë për të ndërhyrë ushtarakisht në Ukrainë.

Kjo analizë thekson gjithashtu rëndësinë e Evropës si një terren për t'u pushtuar nga sektorët më të avancuar teknologjikisht të Amerikës së Veriut dhe Kinës. Kjo nuk do të thotë aspak se Evropa është një subjekt pasiv që iu nënshtrohet proceseve të vendosura në Washington dhe, deri diku, në Pekin. Në Evropë, si në çdo kontinent, ka kapitale mjaftueshëm të mëdha e të fortë për të hyrë në aleancë apo për të konkurruar me gjigantët amerikanë e ki-

nezë. Janë këta kapitale të cilët operojnë në sektorë të teknologjisë së lartë – që përfshijnë energjitë e rinovueshme – që drejtojnë politikat e BE-së për transformimin teknologjik dhe ekologjik. Dhe janë pikërisht këta kapitale që përfitojnë më shumë nga pasojat ekonomike të pandemisë dhe luftës.

Në këtë këndvështrim, pas irracionalitetit në dukje të strategjisë së BE-së ndaj Rusisë, natyrisht humbëse sipas logjikës të së tërës, shfaqet një pamje më koherente: thjesht, disa sektorë – dhe disa kompani në veçanti – marrin përfitimet, dhe sektorë të tjerë dhe kompani të tjera, si dhe e gjithë popullata, paguajnë kostot.

Kjo asimetri në marrëdhëniet ndërmjet sektorëve ka pasoja në marrëdhëniet ndërmjet shteteve. Brenda BE-së, vendet më të avancuar teknologjiki-sht kanë shumë për të përfituar nga këto procese, ndërsa më të prapambeturit janë të destinuar të vuajnë kryesisht pasojat.

Në përgjithësi, shkallët e lirisë së BE-së mbeten të kufizuara nga nënshtrimi politik e ushtarak ndaj Shteteve të Bashkuara dhe, nga ky këndvështrim, efekti bumerang i sanksioneve energjetike është thjeshtë pjesë e një procesi më të përgjithshëm.

Krahasuar me zonat e tjera më të avancuara ekonomike, BE-ja ka gjithashtu një problem historik strukturor, një mëkat fillestar që e mbart me vete qysh nga lindja: BE-ja nuk është një komb, nuk ka sistem taksash dhe nuk ka ushtri. Shkalla më e lartë e integritit është tregtare e financiare dhe ka të bëjë me zonën e euros, një zonë valutore e rëndësishme në kuadrin global, e cila megjithatë bazohet në ekonomi kombëtare mjaft të ndryshme nga njëra-tjetra, me probleme në disa raste të kundërta.

Përmbledhje e krizës pandemike

Versioni zyrtar i pandemisë, dihet botërisht, thotë se me ardhjen e koronavirusit në fund të vitit 2019, qeveritë në mbarë botën, krejt papritur, njëzëri, kuptojnë rëndësinë e shëndetit dhe sakrifikojnë disa liri dytësore në altarin e kësaj vlere supreme (të nëpërkëmbur gjithmonë nga shteti dhe nga kapitali në emër të logjikës së fitimit). Për herë të parë në historinë e kapitalizmit, vende me tradita historike e vlera kulturore shumë të ndryshme – që shkojnë nga lartësimi i lirive individuale deri te autoritarizmi – adoptojnë një sferë të përbashkët morale, sipas së cilës shëndeti kolektiv është i shenjtë dhe mbizotëron mbi lirinë individuale dhe mbi të drejtat sociale.

Nisur nga ky koncept i ri për shëndetin dhe shoqërinë, me ndihmën e organizatave ndërkombëtare, të gjithë vendet mobilizohen për të frenuar pandeminë, duke miratuar masa ekonomike dhe ligjore deri atëherë të perealizueshme apo edhe të pamendueshme. Nga futja e mjeteve të kontrollit dhe shtypjes, deri te bllokimi i aktiviteteve prodhuese, dhe te planet e pastajme të rimëkëmbjes, në pak muaj, pandemia revolucionon marrëdhëniet ekonomike dhe sociale.

Nuk është ky vendi për një kritikë sistematike të kësaj narrative. Për qëllimet e analizës sonë, është më e dobishme të rindërtojmë interesat dhe strategjitë e aktorëve në lojë, duke parë pasojat ekonomike të asaj që ata bëjnë, më tepër sesa vlerat morale të asaj që thonë.

Për ta përmbledhur, historia e treguar këtu është kjo: në mes të krizës ekonomike globale, shpërtheu një luftë midis blloqeve kapitaliste, të udhëhequra kryesisht nga SHBA-ja dhe Kina, që synonte përshpejtimin e transformimit teknologjik

që po ndodhte dhe ripërvijimin e marrëdhënieve shoqërore dhe marrëdhënieve ndërkombëtare. Kri-za e koronavirusit është pjesë në fakt e një konteksti të një krize globale paraekzistuese, të cilën politikatat monetare dhe fiskale nuk kishin arritur ta zgjidhnin.

Kuadri makroekonomik global para ardhjes së pandemisë është gjithçka tjetër përveçse i trëndafil-të. Më 2019-n, FMN-ja dhe Banka Botërore kishin paralajmëruar për rrezikun e një recesioni të afërt global. Qysh në fund të 2018-s, pasiguritë për pasojat e Brexit-it, lufta tregtare e Shteteve të Bashkuara kundër Kinës dhe nisja e një politike të re tarifash doganore kundër Evropës i kishin tronditur tregjet.

E ashtuquajtura “kriza subprime” e vitit 2007, ka lënë shenjat e saj: në BE, kriza është zhvilluar si një krizë e borxhit publik dhe, pak a shumë në të gjithë botën, masat shtrënguese të vendosura nga qeveritë e të gjitha ngjyrymeve politike, përpos përkeqësimit të kushteve të punëtorëve, kanë ngadalësuar rritjen dhe tregtinë ndërkombëtare.

Pavarësisht niveleve të favorshme të normave të interesit, investimet kanë mbetur të ndrydhura nga pritshmëritë e ulëta të rritjes dhe situatat e vështira financiare të kompanive, borxhi i të cilave shkon nga 84% e PBB-së botërore në vitin 2009 në 92% në 2019-n, duke rritur brishtësinë e përgjithshme të sistemit industrial dhe varësinë e tij nga tregjet financiare.

Një e dhënë teknike e rëndësishme për ekonomistët jepet nga përmbysja e kurbës së rendimenteve në SHBA, në prill 2019: rendimentet e letrave me vlerë afatgjata të borxhit bien nën ato të letrave me vlerë afatshkurtra, fenomen të cilin ekspertët e interpretojnë si sinjal të një krize të afërt (pasi tregon një përkeqësim konstant të parashikimeve të rritjes).

Në tregun e punës, ulja e pagave dhe humbja e të drejtave, në një kontekst ku kemi një përhapje të pasigurisë, nuk ka prodhuar asesi një zgjerim të

rritjes – siç premtuhej nga recetat neoliberales – por, përkundrazi, ka ulur më tej kërkesën përmes rënies së konsumit.

Rezultati: në fund të vitit 2019 shumë vende kapitaliste të përparuara janë tashmë në recesion.

Kina dhe Shtetet e Bashkuara, të paraqitura zakonisht si ekonomi rivale, kanë në realitet, njëkohësisht, një përputhshmëri të gjerë të interesave në këto procese. Lufta tregtare e nisur nga administrata Trump në vitin 2018 shkakton masa simetrike nga ana e Republikës Popullore: taksat doganore dhe tarifat prekin rreth 550 miliardë dollarë eksporte kineze në Shtetet e Bashkuara dhe 185 miliardë dollarë eksporte amerikane në Kinë.⁷¹ Shtetet e Bashkuara dhe Kina nuk duan që konkurrenca ndërkombëtare të luhet në shtëpinë e tyre. Megjithatë, në të njëjtën kohë, të dyja superfuqitë ekonomike synojnë liderшипin teknologjik dhe që të dyja kanë vështrimin e tyre drejt tregjeve botërore mbi të cilat do të imponojnë modelin e ri ekonomik të bazuar në teknologjinë e lartë. Rritja e përgjithshme e sektorit është padyshim një synim i përbashkët. Sidomos nëse ndeshja luhet në fushë të huaj.

BE-ja, të cilën shumë e shohin si pretendente të tretë, është në realitet një entitet heterogjen, me interesa të kundërta brenda saj. Siç do të shohim më imtësisht në kapitullin vijues, në kundërshtim me idenë e një poli të tretë imperialist, BE-ja lind dhe zhvillohet pikërisht me mbështetjen e Shteteve të Bashkuara, të cilat përbëjnë pikën e saj të referimit në fushën ekonomike, financiare dhe ushtarake. Brenda saj mbizotërojnë pozitat e Gjermanisë, Francës dhe vendeve nordike, teknologjikisht më të avancuara dhe financiarisht më solide, në kurriz të vendeve periferike. Me përkeqësimin e krizës, pas masave “anti-pandemike”, janë sidomos Gjermania

71 South China Morning Post, US-China trade war timeline: key dates and events since July 2018.

dhe Franca që po bëjnë përpjekjet më të mëdha për të pajtuar konfliktet brenda BE-së, për të nisur planet e rimëkëmbjes, nga të cilat vendet teknologjike sht më të avancuar kanë shumë për të fituar.

Përplasja brenda kapitalit financiar nxitet nga sektorët e teknologjisë së lartë (aerohapësira, armët, financat, elektronika, teknologjia e informacionit, media, farmaceutika, *green economy*) në dëm të sektorëve tradicionalë (naftë-gaz-qymyr, transport, turizëm, bujqësi, prodhim, pasuri të paluajtshme, ushqim, tekstile). Qëllimi është të detyrohet përhapja e teknologjive të reja, të depërtojnë në çdo sektor dhe të përfitojnë nga kriza e koronavirusit (ose, më mirë, nga kriza që vjen prej masave kufizuese të miratuara kundër pandemisë) për t'i rishtrukturuar ato sipas paradigmës së re teknologjike. Në këtë proces, nuk është në lojë vetëm riorganizimi i të gjithë aparatit industrial, por edhe ripërcaktimi i marrëdhënieve shoqërore në përputhje me modelin e ri të shfrytëzimit global.

Lojtarët në fushë

Procesi global i tranzicionit teknologjik dhe ekologjik kërkon një shkallë të lartë koordinimi ndërkombëtar dhe bashkëpunimi aktiv ndërmjet tre aktorëve kryesorë: shteteve, organizatave ndërkombëtare dhe kapitaleve të mëdha private.

1. SHTETET. Roli i shteteve (kapitaliste) është i dyfishtë. Së pari, shtetit i kërkohet të përballojë kostot e përgjithshme të operacionit nëpërmjet planeve të rimëkëmbjes, të justifikuara teorikisht nga pandemia. Është fjala për para që nuk ekzistojnë dhe që shteti duhet t'i marrë hua, edhe pse e di që brenda pak vitesh do të jetë i paaftë për të paguar. Së dyti, ka për detyrë të vendosë kushtet shoqërore të përshtatshme për modelin e ri të shfrytëzimit, nëpërmjet masave të jashtëzakonshme të mbikëqyrjes, kontrollit dhe shtypjes, të cilat e shpërbëjnë rezistencën dhe kapacitetin opozitar të klasës punëtore, duke e privuar atë nga mjetet e luftës së saj. Falimentimi i mëvonshëm i shteteve do të jetë arma për t'i transferuar të gjitha pushtetet drejtpërdrejt te kreditorët (bankat, tani në krizë), të cilët do të përcaktojnë reformat strukturore që shtetet do të duhet të zbatojnë kundër popujve të tyre për të shlyer mëkatin e të paturit shumë borxhe.

2. ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE. Roli i organizatave ndërkombëtare është të udhëheqin dhe koordinojnë këtë transformim global të ekonomisë dhe shoqërisë. Në një nivel ngushtësisht shëndetësor, Organizata Botërore e Shëndetësisë luan një rol kyç që nga vendimi për shpalljen e pandemisë, duke nxjerrë në dritë ndërhyrjen ekonomike dhe politike të cilës i nënshtrohet ky organ. Në planin ushtarak, struktura kryesore koordinuese e vende-

ve kapitaliste perëndimore është padyshim NATO-ja, ku SHBA-ja ka një lidhshmëri të padiskutueshëm. Vetë zgjedhja e shumë vendeve perëndimore për të shpallur gjendjen e jashtëzakonshme as që mund të imagjinohet pa mbikëqyrjen e kujdesshme të SHBA-së dhe NATO-s. Nga pikëpamja ekonomike, urgjenca shëndetësore ka mundësuar më në fund që Banka Botërore, FMN-ja, BE-ja dhe organizatat e tjera ekonomike rajonale të drejtojnë procesin e transformimit teknologjik duke ndarë fonde të reja që shtetet do të duhet të shpenzojnë në përputhje me treguesit strategjikë të vetë organizatave ndërkombëtare. Në fakt, paratë e huazuara nga shtetet për planet e rimëkëmbjes nuk shkojnë për zgjidhjen e problemeve sociale e shëndetësore të shkaktuara nga pandemia, por për digjitalizimin, ekonominë e gjelbër dhe zhvillimin e teknologjive të reja. Në mes të një krize ekonomike, me shtete në prag të falimentimit dhe një krizë të rëndë shëndetësore, organizatat ekonomike ndërkombëtare i transferojnë kështu tek shtetet kostot e ristrukturimit kapitalist.

3. KAPITALI FINANCIAR. Pas strategjive të shteteve dhe organizatave ndërkombëtare qëndrojnë interesat e kapitaleve të mëdha. Dhoma e regjisë së këtyre proceseve gjendet në qendrat vendimmarrëse të kompanive shumëkombëshe. Ka disa qarqe të financave të larta në të cilat strategjitë midis kapitaleve të mëdha janë të koordinuara dhe është vetë procesi i përqendrimit të kapitalit që i krijon ato. Grupi Bilderberg dhe Forumi Ekonomik Botëror – World Economic Forum (WEF) – janë sigurisht ndër organizatat më të fuqishme në këtë kuptim. Takimet e tyre mbahen me dery të mbyllura dhe marrin pjesë eksponentë të botës financiare, të biznesit, politikës dhe medias të kooptuar sipas strategjive të përgjithshme të drejtuesve të lartë të këtyre organizatave dhe objektivave specifike të

përcaktuara herë pas here. Pikërisht në këto mjedisë institucionale, shprehje e kapitalit financiar, merr formë procesi i bashkërendimit ndërmjet aktorëve në terren, që përcakton rolin e medias, shkencës, politikës, shtetit dhe investimeve publike e private. Kundërvëniet ideologjike zgjidhen në forume të tjera. Për këtë arsye, gjigantët teknologjiko-financiarë kinezë mund të ulen rehat pranë kompanive shumëkombëshe “made in USA”, pa pasur nevojë të diskutojnë për komunizmin dhe kapitalizmin. Pikërisht në një nga këto mjedisë u mbajt prova e përgjithshme mbi sjelljen që duhet adoptuar në rast të një pandemie vetëm pak muaj para shpërthimit të pandemisë: *Ngjarja 201*, organizuar nga Qendra Johns Hopkins për kujdesin shëndetësor, WEF dhe Fondacioni Bill dhe Melinda Gates në tetor 2019. Sigurisht, pas këtyre vendeve formale të koordinimit të kapitalit financiar qëndrojnë kapitalet e mëdha financiare reale, firmat e mëdha të investimeve, si Blackrock, Vanguard dhe State Street, të cilat janë praktikisht hegjemonike në të gjitha tregjet botërore dhe të afta për të udhëhequr, nëpërmjet strategjive të tyre financiare, zhvillimin dhe tkurrjen ekonomike mes sektorëve të ndryshëm prodhues, në zona të ndryshme gjeografike të planetit.

Nga pandemia te lufta në Ukrainë

Për sa i përket qëllimeve të tranzicionit teknologjik, pandemia është një mundësi unike për t'i vënë të gjithë rreth një tryeze dhe për të bashkëpunuar. Rezultatet mund t'i shikojnë të gjithë. Strategjia kundër pandemisë ka pasur në fakt efekte të rëndësishme ekonomike, politike, sociale dhe kulturore.

Ekonomikisht, dy vjet masa “anti-pandemike” kanë lënë gjurmë. Sektorët ekonomikë më të penalizuar janë ato tradicionalë: bujqësia, industria, transporti, turizmi, tregtia, kultura, sporti, koha e lirë, që e kanë paguar shtrenjtë izolimin, distancimin fizik e social dhe kufizimet në jetën shoqërore. Nga ana tjetër, sektorët e teknologjisë dhe të ekonomisë së gjelbër, veç fitimeve të shumëfishuara gjatë pandemisë, marrin edhe 90% të fondeve shtetërore në planet e rimëkëmbjes dhe të reziliencës⁷², emri i ri i programeve të rimëkëmbjes në epokën e pas pandemisë.

Këto plane, si në SHBA ashtu edhe në BE, nuk arrijnë t'u bëjnë ballë as mangësive strukturore të sistemin shëndetësor, të cilat pandemia i ka bërë të dukshme. Ndërhyrjet e vetme në sektorin e shëndetësisë kanë të bëjnë me vaksinimin, digjitalizimin dhe telemjekësinë. Prioritetet e vendosura nga Washington-i dhe Bruxelles-i e vënë theksin, nga ana tjetër, në zhvillimin e ekonomisë së gjelbër dhe teknologjitë e reja. Në planin italian, për shembull, fondet e destinuar për kujdesin shëndetësor në kuptimin e ngushtë të fjalës (domethënë ato që synojnë efektivisht shëndetin e qytetarëve, jo efikasitetin e sistemit të informacionit ose zhvillimin

72 Termi reziliencë, italisht resilienza, i referohet aftësisë së diçkaje, qoftë ai send, njeri apo komunitet, për të reaguar ndaj një ndryshimi të fortë, ndaj një thyerjeje, vështirësie, traume apo krize. (shën. i përkth.)

e teknologjive që bëjnë të mundur heqjen qafe të pacientëve pa i vizituar) llogariten në qindra milionë euro, nga një plan total prej më shumë se 200 miliardë eurosh në favor të dixhitalizimit dhe tranzicionit teknologjik e ekologjik.

Në Shtetet e Bashkuara, sfida e Joe Biden-it dhe Trump-it është zhvilluar, qysh në krye të herës, si një përplasje mes *new* dhe *old economy*. Trump-i përfaqëson interesat që kundërshtojnë kthesën e gjelbër. Ai është njeriu i sektorëve dhe energjive tradicionale dhe tallet duke thënë se ngrohja globale është një mashtrim i shpikur nga kinezët për të dëmtuar ekonominë amerikane. Në vitin 2017, ai njofton tërheqjen e Shteteve të Bashkuara nga Marrëveshja e Parisit për klimën (formalisht doli në vitin 2019) dhe, gjatë fushatës zgjedhore, propozon eliminimin e kufizimeve në nxjerrjen e lëndëve djegëse fosile. Në vend të kësaj, Biden mbështetet nga sektorët e rinj teknologjikë. Ai është për dekarbonizimin⁷³ dhe energjinë e rinovueshme, dhe premton një plan prej 2,000 miliardë dollarësh për t'u bërë ballë ndryshimeve klimatike dhe për të reduktuar përdorimin e lëndëve djegëse fosile.⁷⁴

Përplasja mes dy kandidatëve padyshim ka të bëjë me çështje të ndryshme: emigracioni, aborti, marrëdhëniet racore. Por kjo është një ndeshje ekonomike. Të dyja palët e dinë këtë dhe prandaj zgjedhja e Biden-it interpretohet sakaq nga tregjet si fitore e sektorit të gjelbër kundër ekonomisë tradicionale.

Në marrëdhëniet ndërkombëtare, përplasja e brendshme e kapitalit amerikan shfrehet në kontekstin ruso-ukrainas në dy mënyra: së pari, duke përshpejtuar procesin e depërtimit të kapitaleve të

73 Term që përdoret për të përshkruar procesin e heqjes dorë nga përdorimi i lëndëve djegëse fosile. (shën. i përkth.)

74 MarketWatch, Fracking and the 'Green New Deal': Here's where Trump and Biden atand on climate change.

gjelbra dhe teknologjike në Evropë; së dyti, duke i ofruar një dalje sektorit të naftës në SHBA, që është në vështirësi në frontin e brendshëm pas humbjes elektorale të Trump-it. Në strategjitë e luftës ushtarake dhe ekonomike të Pentagon-it, një përshpejtim i tensioneve në Ukrainë në fakt i kënaq të dyja palët: nga njëra anë u lejon shumëkombësive të gjelbra të pushtojnë tregun evropian; nga ana tjetër, u jep kompanive të naftës mundësinë për të kompensuar jashtë vendit humbjen e pësuar brenda vendit.

Pandemia shkakton pasoja të rëndësishme edhe në vetë parimet e politikës ekonomike. Pas disa dekadash politikash të kufizimit të shpenzimeve, shtetet më në fund mund të fillojnë të shpenzojnë sërish. Më në fund kthehemi te ai keqnesianizmi i bukur, që shpenzon shumë dhe shpenzon keq, gjithmonë i dobishëm kur vjen puna për të kaluar nga privatizimi i fitimeve në socializimin e kostove.

Të japësh fonde për luftën në një kohë ashpërsie fiskale do të ngjallte polemika ekonomike dhe politike; ta bësh atë në kontekstin e një politike fiskale ultra-ekspansive është diçka tjetër: nga pak për të gjithë nuk i bën keq askujt (dhe më pas, në fshehtësi, numërohen zerot e zërave të ndryshëm të shpenzimeve). Kështu, debati politik mund të fokusohet në vlerat më të larta, si shëndeti dhe jeta në komunitet, ose ruajtja e paqes dhe mbrojtja e më të dobtëve. Edhe nëse në realitet financohen kompanitë farmaceutike, sektori i teknologjisë së lartë dhe lufta.

Për momentin nuk ka asnjë diskutim për kthimin e parave. Megjithatë në pak vite letrat me vlerë të borxhit publik me të cilat financohet bujarisht tranzicioni teknologjik do të arrijnë maturimin dhe shtetet që sot shpenzojnë në favor të kapitalit të madh do të detyrohen të kapitullojnë para kreditorëve të mëdhenj. Masha e kapitalit ka dy krahë: njërin në ekonominë reale, tjetrin në atë financiare.

Më pas janë marrëdhëniet klasore: dy vjet menaxhim emergjencash anti-pandemike i kanë detyruar punëtorët të bëjnë kthim pas me dekada për sa i përket të drejtave dhe kushteve të punës dhe pagave. Popullsia në tërësi i është nënshtruar masave të pashembullta të kontrollit dhe disiplinës. E drejta për të studiuar është shndërruar në një detyrë për të mësuar – nga distanca ose ballë për ballë, nuk ka rëndësi – dhe lëvizjes studentore i janë hequr hapësirat e përdorshme. Reagimi i lëvizjes punëtore dhe lëvizjeve shoqërore është reduktuar në zero.

Merreni me mend cilat mund të jenë rreziqet e zhvillimit të një mobilizimi kundër luftës! Më së shumti, mund të diskutohet për të mirën e përbashkët ose një moral abstrakt pacifist, por sigurisht jo për interesat konkrete ekonomike të klasës punëtore, të cilës nuk i ka ardhur kurrë asgjë e mirë nga lufta.

Së fundi, lufta kundër pandemisë ka lënë gjurmë në rrafshin kulturor: nga mendimi i vetëm, i ndërtuar në media, në politikë dhe në kulturën zyrtare, ne kemi kaluar në ndalimin e shprehjes së opinioneve të kundërta. E vërteta është një dhe ajo vërtetohet nga organet e veçanta zyrtare kombëtare dhe ndërkombëtare, ose nga menaxherët e rrjeteve sociale. Kritika, që dikur konsiderohej, të paktën formalisht, një pjesë thelbësore e marrëdhënieve demokratike dhe përparimit shkencor, është ndaluar dhe zëvendësuar nga censura. Informacioni antikonformist, për të mirën e përbashkët, është errësuar.

Edhe në këtë rast, kushtet kulturore të trashëguara nga politika anti-pandemike, produkt, të kuptohemi mirë, i proceseve të gjata që kanë nisur në të kaluarën, janë të shkëlqyera për përgatitjen e luftës. Që në fillim, metodat e informimit dhe propagandës në luftën kundër Covid-it kanë qenë tipike për regjimet në luftë. Tani bëhet fjalë thjesht për kalimin nga fjalët te faktet. Jo më një luftë simbolike kundër një virusi, por një luftë e vërtetë kundër një vendi.

Nëse më përpara duheshin heshtur “mohuesit” dhe “komplotistët”, tani nga kujdesi dhe për të mirën e popujve perëndimorë ndalohen kanalet ruse të informacionit ose të konsideruara pro-ruse, të cilat si doqoftë janë shumë aktive në demaskimin e gënjeshtreve të Perëndimit

Përgënjeshtrimi i një organi të shtypit, në kohë normale, është punë e medias, jo e qeverive. Edhe një fëmijë e di se në luftë është më mirë të njohësh versionin e armikut, dhe kushdo që bën vërtetë luftë përdor të gjitha kanalet për të zbuluar se si po ecin gjërat në kampin kundërshtar. Por në Perëndim, që nga Covid-i e këtej, ekziston vetëm një e vërtetë, e vendosur drejtpërdrejt nga komitetet shkencore të Inkuizionit të Shenjtë. Janë ata që vendosin, me dekret, se kush ka të drejtë dhe kush mund të flasë.

Pa një fushatë të përshtatshme mediatike, është e dyshimtë që popujt evropianë, të cilët sapo kanë dalë nga një pandemi dyvjeçare, do të pranonin të përfshiheshin në një konflikt në të cilin ata paguajnë vetëm faturën. Por gjithsesi: Putini barazohet me një car (i zgjedhur, në të vërtetë, nga një shumicë e madhe) që do të donte të rindërtonte perandorinë, të nënshtronte popujt dhe të shkonte deri kusheidi se ku në Evropë. Është presidenti i ri i Shteteve të Bashkuara që ka vendosur se gjërat janë kështu. Një president i zgjedhur me një grusht votash, mes mashtrimeve, protestave dhe grushteve të shtetit-farsë, në një shtet në të cilin, për nga ndërtimi institucional, komandojnë lobet financiare. Një njeri, një votë, në kabinat e votimit; një dollar, një votë, në vendimet politike. Kjo është demokracia që Shtetet e Bashkuara synojnë të eksportojnë në Evropë dhe në pjesën tjetër të botës.

Efektet e luftës mbi përplasjen imperialiste

Marrëdhënia midis krizës pandemike dhe konfliktit ruso-ukrainas është e dyanshme. Sapo pamë se si strategjia anti-pandemike kontribuon objektivisht në përcaktimin e kushteve që bëjnë të mundur dhe lehtësojnë shpërthimin e konfliktit ruso-ukrainas. Le të shqyrtojmë tani marrëdhënien e kundërt: efektet e luftës në Ukrainë në strategjitë imperialiste në lojë në të ashtuquajturën luftë kundër Covid-it.

Me sulmin ndaj naftës ruse, Shtetet e Bashkuara po arrijnë një objektiv të dyfishtë, taktik dhe strategjik: së pari, kompanitë amerikane të naftës depërtojnë dhe bëhen hegjemonike në tregun evropian të gazit, një rezultat që do të ishte i pamundur duke luajtur vetëm me përfitimet e ndërsjellta ekonomike, dhe që tani bëhet i mundur falë forcës politike të ushtruar mbi “aleatët”, falë emergjencës së luftës (rezultat i rëndësishëm në afatmesëm, por i destinuar të ulet me kalimin e kohës). Së dyti, kostot më të larta për energjinë tradicionale rrisin aftësinë konkurruese të ekonomisë së gjelbër dhe të energjisë së rinovueshme në të cilën Shtetet e Bashkuara shkëlqejnë.

Objektiv i dytë është ai strategjik, ai që lëviz strategjitë globale imperialiste të Shteteve të Bashkuara. Nga pikëpamja globale, Shtetet e Bashkuara më shumë sesa Rusinë, ata shikojnë në fakt Kinën dhe Evropën: e para, si prodhuesi kryesor rival në zhvillimin e sektorit të gjelbër dhe teknologjik; e dyta, si tregu kryesor për shitjen e produkteve dhe shërbimeve të gjelbra dhe të teknologjisë së lartë.

Prej kohësh, problemi qendror në zhvillimin e ekonomisë së gjelbër dhe energjive të rinovueshme është se, me çmimet aktuale, ato nuk janë ekono-

mikisht fitimprurëse: pa incentivët qeveritarë, të cilët kanë vite që aplikohen, nuk ka energji të erës apo diellore që mund të konkurrojnë me gazin, naftën, qymyrin dhe produktet e reja të izolimit termik e të performancës energjitike, do të mbeteshin të gjitha në magazinat e prodhuesve nëse blerësit përfundimtarë do t'i paguanin ato vërtet me çmimet e tregut.

Nga ky këndvështrim, tensionet në Ukrainë – ose, më mirë, sanksionet kundër Rusisë – japin një kontribut vendimtar në procesin e transformimit industrial. Rritja e çmimeve të energjisë që buron nga kjo, dhe që është e destinuar të qëndrojë për aq kohë sa të zgjasë konflikti, në fakt rrit konkurrencën e sektorëve të rinj të teknologjisë dhe të energjive të rinovueshme. Në të njëjtën kohë, procesi i zëvendësimit të importeve të energjisë nga Rusia, që i është imponuar BE-së nga Shtetet e Bashkuara, e përforcon dhe e bën kronike rritjen e çmimeve të energjisë.

Problemi kryesor në proceset e ndryshimit të modelit teknologjik diktohet nga kohët. Kur janë në lojë investime të mëdha, që projektet të jenë të zbatueshme, ata duhet të jenë relativisht të shpejtë. Në periudhën fillestare, në të cilën diskutohen kostot në funksion të të ardhurave të ardhshme, kompanitë e gjejnë veten të ekspozuara financiarisht. Në një kontekst financiar të paqëndrueshëm, rreziku është që projektet të mos realizohen dhe të ndalojnë përpara se të fillojnë realisht të grumbullojnë fitime. Edhe projekti më fitimprurës në letër është në fakt i perealizueshëm pa flukset e nevojshme financiare dhe transformimin e njëkohshëm të mjedisit ekonomik përreth.

Operacioni i madh koordinues ndërmjet shteteve, organizatave ndërkombëtare dhe kapitalit të madh ofron garancinë e nevojshme në këtë kuptim. Rritja e çmimeve të energjive dhe teknologjive konkurrue-

se zvogëlon rrezikun që mbart procesi i tranzicionit dhe rrit konkurrencën e teknologjive dhe energjive të reja të gjelbra.

Vetë interesi i Perëndimit për Ukrainën përtej arsyeve gjeopolitike, lind nga roli drejtues që kanë marrë sektorët teknologjikë në politikat e Shteteve të Bashkuara dhe BE-së. Që në fillim, ato që shtyjnë për hyrjen e Ukrainës në BE janë kompanitë që kanë interesa në energjitë e rinovueshme, infrastrukturë dhe në agroindustri.

Gara për akaparimin e tokës bujqësore të Ukrainës nga ana e kompanive bioteknologjike, ndonëse është e rëndësishme për zhvillimin e OMGJ-ve dhe hyrjen e tyre në BE, është vetëm pjesë e një strategjie më të përgjithshme që synon të transformojë të gjithë ekonominë evropiane e botërore. Teknologjitë e reja nuk duhet vetëm të rriten në kurriz të të vjetrave. Ato duhet gjithashtu t'i përvetësojnë sektorët tradicionalë dhe t'i transformojnë ata në paradigmen e re teknologjike.

Loja nuk kufizohet aspak vetëm në aplikimin e teknologjisë së lartë në miliona hektarë tokë që i janë marrë Ukrainës nga korporatat shumëkombëshe. Por ajo ka të bëjë edhe me transformimin teknologjik të të gjithë hapësirës evropiane, në çdo vend dhe në çdo sektor ekonomik, dhe me transformimin pasues të të gjithë sistemit të marrëdhënieve shoqërore dhe të punës, që janë të nevojshme për zhvillimin e këtij modeli të ri të shfrytëzimit global.

Ekonomia e gjelbër

Zhvillimi i teknologjive të reja dhe ekonomisë së gjelbër është një nga forcat kryesore ekonomike që drejton marrëdhëniet ndërkombëtare midis kapitaleve, dhe merr një rëndësi vendimtare me ardhjen e pandemisë.

Ekonomia e gjelbër është një model zhvillimi që synon të promovojë rritjen ekonomike duke respektuar mjedisin dhe ekosistemin. Brenda saj shkrihen trajektore të ndryshme teknologjike dhe plane të ndryshme kërkimore dhe investimi: e ashtuquajtura ekonomi rrethore (bazuar në riciklimin, riparimin e materialeve dhe reduktimin e mbetjeve), energjitë e rinovueshme, teknologjitë e reja dhe materialet e reja që synojnë përmirësimin e performancës energjitike dhe të ndotjes, transformimi i ndërtesave sipas standardeve të reja të efektivitetit energjitik, unifikimi i rrjeteve elektrike të pesë kontinenteve, shndërrimi i mjeteve të transportit publik dhe privat në automjete elektrike dhe reduktimi i përgjithshëm i emetimeve të dioksidit të karbonit.⁷⁵

Në debatin publik, ky koncept i ri ekologjik zhvillohet brenda polemikës mbi ngrohjen globale të fillim viteve 2000 dhe merr rëndësi me rritjen e investimeve në sektorin e teknologjisë së lartë, me të cilin ekonomia e gjelbër është e lidhur ngushtë.

Në vitin 2007, me shpërthimin e krizës financiare, ideja e një *Green New Deal* mori formë në Shtetet e Bashkuara: një plan masiv investimi në stilin e *New Deal*-it të viteve 1930, por në një drejtim ekonomikësor. Me *New Deal*-in, Presidenti Franklin Delano Roosevelt synonte të ringjallte Shtetet e Bashkuara nga Depresioni i Madh që pasoi rrëzimin e tregut të aksioneve të vitit 1929; me *Green New Deal* tani synohet rimëkëmbja e Shteteve të Bashkuara nga

Recesioni i Madh që filloi me rrëzimin e tregut të akcioneve në 2007-n.

Në vitin 2008, projekti u zhvillua në Mbretërinë e Bashkuar, me themelimin e grupit të *Green New Deal*, dhe u bë pjesë integrale e Programit Mjedisor të Kombeve të Bashkuara, i cili u bë nismë e *Global Green New Deal*.

Një etapë e rëndësishme e këtij proces është Marrëveshja e Parisit për ndryshimet klimatike. Kjo është marrëveshja e parë ligjërishme e detyrueshme në botë, e nënshkruar më 22 prill 2016, e cila ka hyrë në fuqi më 4 nëntor. Qëllimi është që ndryshimet teknologjike të shkojnë në një drejtim të gjelbër, në dëm të sektorëve tradicionalë dhe paralelisht të detyrohen edhe vendet më të varfra dhe më pak të zhvilluara të ndërmarrin projekte të shtrenjta të transformimit teknologjik, duke iu hapur rrugën kompanive të reja shumëkombëshe të sektorit të gjelbër.⁷⁶

Shpejt, edhe në rrafshin kulturor, problemet ekologjike dhe klimatike bëhen tema prioritare, për të cilat nuk mund të ketë asnjë hezitim. E gjelbra është përparim, pëlqehet nga burrat, gratë, të moshuarit dhe fëmijët, është e mirë për të pasurit dhe të varfrit, në vendet e përparuara dhe në ato të prapambetura. Pas dekadash beteja, më në fund ka unanimitet për sa i përket të gjelbrës. Natyrisht, nuk mund të thuhet se ky ndryshim politiko-kulturor është vërtet fryt i përpjekjeve të ekologëve militantë (të cilët përgjithësisht arrestohen kur kundërshtojnë mallfikimin e planetit, si në Itali, në protestën e No-Tav). Përkundrazi, ai është produkt i fushatave mediatike të organizuara dhe financuara në nivelet më të larta institucionale në mbarë botën.

Rasti më i spikatur është padyshim "*fenomeni Greta*": ndërsa interesi i shtypit për problemet mjedisore rritet, pushtetet e forta i vërsulen pamëshirshëm

⁷⁶ Consiglio Europeo, Accordo di Parigi sui cambiamenti climatici.

një vajze pesëmbëdhjetëvjeçare, të diagnostikuar me autizëm, Greta Thunberg, duke e shndërruar atë në një fenomen mediatik.

Tre muaj pasi nisi një protestë të vetmuar para Parlamentit Suedez, ambientalistja e re me vështirësi në marrëdhëniet shoqërore, që vuan nga memecëria selektive, e gjen veten të katapultuar në qendrat më të larta të pushtetit botëror: dëgjohet në OKB, është mysafire WEF të Davos-it, mban fjalime para Parlamentit Francez, atij Britanik e Evropian, dhe takohet gjithashtu me Papa Francesco-n, i cili, duke interpretuar pa dyshim zërin e Zotit, në vend që të lutet për të dhe ta mbrojë nga pushtetet e forta, i vë barrën dhe e inkurajon atë që të vazhdojë.

Përpos konferencave të ndryshme, ikona e re e green-it, që e konsideron shkollimin e detyrueshëm thjeshtë një opsion, gjen kohë edhe për të shkruar disa libra.⁷⁷

“Ju thoni se i doni fëmijët tuaj mbi gjithçka tjetër, e megjithatë ju po ua vidhni të ardhmen para syve të tyre. ... Ne nuk kemi ardhur këtu për t’u lutur udhëheqësve të veprojnë. Juve ju kanë mbaruar justifikimet dhe ne po na mbaron koha.” Me këto fjalë, Thunberg pushton botën nga selia e Kombeve të Bashkuara.⁷⁸

Në këtë konceptim të ri, betejat mjedisore nuk lindin si një shtysë kolektive nga poshtë, nga subjektet shoqërore që e kundërshtojnë transformimin kapitalist të mjedisit duke dalë në terren. Ato lindin në kokën e një vajze autike, e cila, pa kontakte, pa përvojë, del nga tufa dhe bëhet yll. Në botën e përrallave, të *self-made-man* dhe superheronjve, na duhej edhe një *self-made-girl* që t’i jepej titulli i

77 Greta Thunberg, Svante Thunberg, Malena Ernman e Beata Ernman, *La nostra casa è in fiamme*, Mondadori, 2019. Greta Thunberg, *Nessuno è troppo piccolo per fare la differenza*, Mondadori, 2019.

78 Democracy now!, *You Are Stealing Our Future: Greta Thunberg, 15, Condemns the World’s Inaction on Climate Change*.

superheroines së mjedisit: na ishte një vajzë e vogël që, një ditë, në vend që të shkonte në shkollë, vendosi të ndryshonte botën! Kështu nis përralla e Greta-s.

Kur bëhet fjalë për mjedisin, nuk ka më të djathtë e të majtë, lëvizje shoqërore dhe interesa ekonomike kundërshtare, por është vetëm Greta dhe “*haters*”-at e saj. Kështu i përshkruajnë mediat ata që kritikojnë idetë e ambientalistes së re. Ekonomia e gjelbër nuk është një opsion (që është i leverdisshëm për disa grupe kapitaliste), por është një domosdoshmëri, për të mirën e planetit. Kushdo që nuk pajtohet është një *hater*. Ambientalizmi i ri, i ngritur mbi financimin e gjigantëve teknologjikë, qëndron sipër marrëdhënieve klasore dhe marrëdhënieve të pushtetit. Është e mira kundër së keqes. Vetëm pastërtia e një fëmije të pafajshëm mund të arrijë në zemrën e përparimtarëve të rinj.

Gjatë gjithë këtij procesi, asnjë ambientalisti apo progresisti, të majtë apo të djathtë, *lover* apo *hater* i Greta-s, nuk i ka shkuar në mendje që ndoshta një vajzë e vogël që vuante nga sindroma Asperger do të integrohej më mirë në komunitetin e saj duke ndjekur shkollën me shokët e saj, në vend që të vraponte nga një qendër e pushtetit te tjetra, pa e ditur rolin e tyre, as historinë e tyre. Greta e vogël, viktima e sakrifikuar e operacionit më spektakolar mediatik, e rrethuar dhe e përkëdhelur nga fuqitë e mëdha, e njohur dhe e dashur në mbarë botën, e hedhur në kthetrat e financës nga prindërit e saj ndërsa përpiquej të dilte nga autizmi, tani është vërtet e vetme. Nga pikëpamja njerëzore, ky është fenomeni Greta: shfrytëzimi i fëmijëve i shndërruar në një luftë për progresin, nën duartrokitjet e opinionit publik. Dhe të investitorëve të gjelbër.

Por, le të kthehemi te investimet. Me shpërthimin e pandemisë në vitin 2020, *Green New Deal*-i i gjen më në fund fondet për t'u ngritur në planet e

rimëkëmbjes së SHBA-së dhe BE-së. Tashmë përplasja botërore ka filluar, të mbetesh mbrapa do të ishte e pafalshme.

Në të njëjtën kohë, një element që konsiderohet thelbësor për qëllimet e transformimit të gjelbër ka të bëjë me transformimin digjital. Në realitet, digjitalizimi konvergjon interesa të një natyre shumë të ndryshme: ekonomike, ushtarake dhe të rendit publik. Nëse në fushën ushtarake dhe të rendit publik, policia dhe shërbimet e inteligjencies kanë avantazhet e tyre për sa i përket kontrollit dhe mbikëqyrjes, nga pikëpamja ekonomike, janë gjigantët teknologjikë të informatikës dhe platformave informative dhe të shkëmbimit ata që kanë përfitimet më të mëdha nga ky proces.

Fakti është se, në të gjithë botën, ekonomia e gjelbër dhe digjitalizimi ecin paralelisht kur bëhet fjalë për investime. Në rastin e BE-së, *Green New Deal-i evropian* dhe një *Evropë e gatshme për digjitalen* janë dy prioritetet e Komisionit Evropian për pesëvjeçarin 2019-2024.⁷⁹

79 Commissione Europea, Le priorità della Commissione Europea.

Përplasja teknologjike dhe kontrolli i informacionit

Loja kryesore në transformimin teknologjik të ngjyrosur me të gjelbër luhet në botën e parë. Vetëm vendet më të avancuara teknologjikisht dhe ekonomikisht kanë potencialin për të qenë në gjendje të bëjnë këtë hap cilësor drejt «revolucionit të katërt industrial», siç përkufizohet nga themeluesi i Fem, Klaus Schwab-i.⁸⁰ Nga pikëpamja teknologjike, është e domosdoshme një shkallë e mjaftueshme zhvillimi në infrastrukturë dhe në të mirat e shërbimet teknologjike për të ndërtuar një sistem vërtet të integruar të teknologjisë së lartë. Nga pikëpamja ekonomike, mallrat dhe shërbimet e reja me përmbajtje të lartë teknologjike kanë çmime që nuk janë të aksesueshme për vendet me të ardhura të ulëta, dhe në vend të tyre synojnë, të paktën fillimisht, vendet më të pasura. Krahasuar me format e tjera të përplasjes imperialiste, ku luftohet për vendet më të prapambetura teknologjikisht dhe më të varfra ekonomikisht, këtë herë qëllimi është pushtimi i Evropës!

Sigurisht, mes vendeve të para ku do të shtrihet modeli i ri teknologjik janë tregu kinez dhe ai amerikan. Por këta janë dy tregje të mbrojtur mjaftueshëm nga qeveritë përkatëse dhe marzhet e depërtimit të kapitalit të huaj në fakt janë zvogëluar. Domethënës është rasti i kompanive kineze që operojnë në sektorin e telefonisë, rrjeteve sociale dhe mediave, të ndaluara në tregun amerikan me akuzën e kryerjes së spiunazhit politik në emër të Partisë Komuniste Kineze.

Rregulli është i thjeshtë: nga brenda, dy superfuqitë ekonomike inkurajojnë zhvillimin e sektorëve

80 Klaus Schwab, The fourth industrial revolution, World Economic Forum.

të tyre teknologjikë; në marrëdhëniet ndërkombëtare, ato i shoqërojnë kompanitë e tyre në pushtimin e tregjeve të reja. Me ndryshimin që Kina në thelb luan në terrenin e konkurrencës ekonomike për të depërtuar në të gjithë sektorët, ndërsa Shtetet e Bashkuara nuk hezitojnë të përdorin forcën në sektorët ku humbasin garën ekonomike.

Në këtë përplasje – ashtu si në konfliktin rus-ukrainas – BE-ja duket se po lëviz pa një strategji reale. Zgjedhjet e saj duken pa racionalitet ekonomik: përse ta pranojë këtë përshpejtim në konkurrencën teknologjike, në territoret e veta, kur ia nis në disavantazh? Megjithatë, çështja nuk është vetëm ekonomike, por ka të bëjë edhe me rrezikun e lënies së menaxhimit të flukseve të informacionit, të rrjeteve dhe produkteve e shërbimeve të reja teknologjike në botën e re të teknologjisë së lartë, kapitaleve të huaja.

Akuzat e qeverisë amerikane ndaj kompanive kinëze kanë në fakt një kuptim të dyfishtë: së pari, siç thamë, të natyrës ekonomike, për të eliminuar një konkurrent të pakëndshëm nga tregu amerikan dhe, ndoshta, nga ai evropian; së dyti, me karakter politik, pasi dihet nga të gjithë se kontrolli i infrastrukturave teknologjike ofron mundësi të mëdha për të ndikuar në funksionimin dhe përmbajtjen e tyre.

Kontrolli i fluksit të informacionit është një aspekt qendror i politikës së spiunazhit ekonomik dhe politik të Shteteve të Bashkuara. Midis fundit të viteve 1990 dhe fillimit të viteve 2000, institucionet evropiane u përballën me çështjen Echelon: një sistem i integruar spiunazhi me mbulim botëror, sekret dhe i paligjshëm, që synon të kontrollojë të gjithë komunikimin telematik. Ai menaxhohet nga Agjencia Kombëtare e Sigurisë (NSA), organizëm i cili, së bashku me CIA-n dhe FBI-në, merret me sigurinë kombëtare të Shteteve të Bashkuara, në bashkëpunimin me agjencitë e inteligjencies dhe spi-

nazhit të Britanisë së Madhe, Kanadasë, Australisë dhe Zelandës së Re.

Në atë rast, institucionet evropiane u mjaftuan me përfundimin se nuk kishte asnjë provë se sistemi po përdorej për qëllime ushtarake ose politike kundër BE-së por kishte vetëm qëllime ekonomike: t'u kalonte informacione të ndjeshme kompanive amerikane.⁸¹

Që atëherë, sistemi i kontrollit të informacionit të NSA-së ka bërë një hap cilësor përmes analizës së metadatave, inteligjencies artificiale dhe kibernetikës. Në vitin 2013, Edward Snowden – ish-teknik i CIA-s dhe i një kompanie të teknologjisë së informacionit që ofron konsulencë për NSA-në – zbulon ekzistencën e programit të NSA-së për mbikëqyrjen masive *Prism* (një program i mbikëqyrjes elektronike, luftës kibernetike dhe përgjimit të sinjaleve) dhe sistemeve të ngjashme të zhvilluara nga inteligjencia britanike, në bashkëpunim me NSA-në, mes të cilëve *Temporal* dhe *Muscular*. Tekniku informatik nxjerr gjithashtu prova se këto sisteme janë përdorur kundër kompanive kineze, BE-së dhe G-20-s, politikanëve dhe diplomatëve, si dhe kundër miliona qytetarëve amerikanë dhe evropianë.⁸² Komenti i ashpër i kancelares gjermane Angela Merkel, e cila gjithashtu përfundoi nën sytë kureshtarë të spiunëve anglo-amerikanë, tregon qartë marrëdhëniet e vërteta të vëllazërisë dhe nënshtrimit mes aleatëve: “*spiunimi i miqve është absolutisht i papranueshëm!*”. Më pas presidenti Barack Obama e merr atë në telefon, duke e siguruar se tani e tutje nuk do ta spiunojnë më dhe do të jenë sërish miq si më parë.⁸³

81 European Parliament, Temporary committee on the ECHELON interception system.

82 The Guardian, Boundless informant: the NSA's secret tool to track global surveillance data.

83 Reuters, Merkel frosty on the U.S. over 'unacceptable' spying allegations.

Kuadri që del nga e gjithë kjo është i qartë. Strategjitë e SHBA-së për kontrollin e informacionit dhe komunikimit tregojnë një qëndrim të qartë armiqësor edhe ndaj aleatëve ushtarakë dhe ekonomikë. Armiq apo aleatë, nuk bën ndryshim: America first!

Në rastin e BE-së, problemi është se vetë lindja dhe zhvillimi i saj ndodhin nën ndikimin e Shteteve të Bashkuara, dhe nuk është e mundur të gjykohet racionaliteti i saj nëse lihet mënjanë ky fakt historik, i cili nuk është tamam dytësor. Prania ushtarake në territorin evropian, fuqia ekonomike dhe supremacia financiare përbëjnë kornizën e politikave të mbikëqyrjes dhe kontrollit, por janë rezultat i një procesi të gjatë, të nisur në fundin e Luftës së Dytë Botërore.

4. Strategjia e SHBA-së në Evropë

Strategjia e SHBA-së për t'u imponuar si fuqi financiare hegjemonike botërore prezantohet në Konferencën e Bretton Woods-it në korrik 1944, ndërkohë që lufta vazhdon, dhe pasi Bashkimi Sovjetik ka sprasur nazistët dhe ka përmbysur fatin e luftës botërore.

Marrëveshja parashikon një sistem të kurseve fikse të këmbimit, të bazuar në konvertueshmërinë e dollarit në ar, me monedhat botërore të lidhura me dollarin. Në ekonominë reale, Plani Marshall është shtylla qendrore përmes së cilës Shtetet e Bashkuara financojnë rindërtimin evropian. Kjo shtyllë e dytë nuk mund të ekzistonte pa të parën, që ka natyrë financiare: një plan gjithëpërfshirës për Evropën, në të gjithë sektorët dhe në të gjitha vendet janë larguar nga ndikimi i Bashkimit Sovjetik, do të ishte i paimagjinueshëm në xhunglën e kurseve të këmbimit që lëvizin në mënyrë të pavarur. Pikërisht në këtë kontekst zhvillohet procesi i bashkimit ekonomik evropian.

Procesi i unifikimit ekonomik

Procesi i bashkimit ekonomik evropian fillon zyrtarisht në vitin 1951 me krijimin e Komunitetit Ekonomik të Qymyrit dhe Çelikut dhe ka si objektiv parësor krijimin e tregut të vetëm evropian, një treg pa kufizime për të gjithë mallrat. Procesi është i gjatë dhe kërkon dekada për t'u shpalosur plotësisht.

Ata që shtyjnë në këtë drejtim janë, pikësëpari, Shtetet e Bashkuara: është në fakt në këtë treg që kompanitë amerikane i hedhin mallrat e tyre (fondet amerikane për rindërtimin evropian janë të destinuara për këtë) dhe sjellin kapitalin e tyre në kërkim të punës me kosto të ulët dhe për blerje të lira. Pak a shumë siç do të donin të bënin evropianët me afrikanët tani, amerikanët i ndihmojnë evropianët në shtëpinë e tyre, duke vendosur për siguri disa baza ushtarake “në mbrojtje të tyre”.

Eksportet e forta të kapitalit amerikan drejt Evropës bëjnë që kapitali amerikan dhe ai evropian të ndërliken në mënyra të ndryshme, si financiarisht ashtu edhe në aspektin e prodhimit, në një fazë në të cilën raportet e forcave janë në favor të investitorëve amerikanë. Këta të fundit shfaqen si mirëbërës që sjellin investime por, në fakt, bëhen edhe pronarë të rinj të kapitalit evropian. Kështu fillon depërtimi i kapitalit amerikan në Evropë.

Shtetet e Bashkuara janë gjithashtu mbështetësi më i fortë i një regjimi të rregullt të kursit të këmbimit në Evropë, të lidhur me dollarin. Fillimisht, siç thamë, përmes marrëveshjeve të shkëmbimit të Bretton Woods-it. Më pas, kur ngopen me të, në vitin 1971, dhe dekretojnë në mënyrë të njëanshme përfundimin e tij – default-i më i madh në historinë e kapitalizmit – ata shtyjnë sakaq që Evropa të adoptojë një sistem të qëndrueshëm shkëmbimi të përqëndruar te marka gjermane, duke i besuar Bundesbank-ut detyrën e

transmetimit në Evropë të vendimeve të Federal Reserve. Kështu lindi gjarpri monetar⁸⁴ evropian dhe sistemi monetar evropian, në pritje të formave më të ngurta të kurseve të këmbimit evropian.

Pikërisht përmes këtyre proceseve, Gjermania, pas disfatës më të rëndë të historisë së saj, rikthehet në “komandimin” e Evropës, si nga pikëpamja industriale, ashtu edhe nga pikëpamja monetare dhe financiare: përmes depërtimit të kapitaleve amerikane në ato gjermane, si në sektorin industrial ashtu edhe në atë bankar-financiar. Një rol i ngjashëm me atë që i është caktuar Japonisë në zonën e Paqësorit – humbësi tjetër i madh i luftës botërore – si një fuqi rajonale plotësisht e nënshtruar ndaj interesave ekonomike dhe ushtarake të SHBA-së.

Me rënien e Murit të Berlinit më 9 nëntor 1989, hapet një fazë e re e strategjisë së SHBA-së në Evropë. Shtetet e Bashkuara synojnë të përfitojnë nga fitorja në Luftën e Ftohtë mbi vendet post-socialiste dhe të shfrytëzojnë mundësitë e fitimit të ofruara nga privatizimi dhe liberalizimi, si dhe fuqia e bollshme e punës së kualifikuar me kosto të ulët. Ekonomikisht, Evropa kapitaliste dhe Shtetet e Bashkuara janë tashmë ndër rajonet më të integruara në botë. Tani bëhet fjalë për ndarjen e Evropës Lindore, duke respektuar hierarkitë në terren. Nga ky këndvështrim, BE-ja dhe NATO-ja përcaktojnë një kuadër institucional tejet të favorshëm, përmes të cilit kapitalet amerikane pushtojnë Evropën.

Plaça e parë e luftës është pikërisht Republika Demokratike Gjermane, e cila më 3 tetor 1990 aneksohet nga Gjermania Federale.

84 “Gjarpri monetar” është marrëveshja e vitit 1972 e bërë mes vendeve të Komunitetit Ekonomik Evropian e cila përcakton marzhet e luhatjes brenda një fashe të monedhave evropiane krahasuar me markën gjermane (shën. i përkth.)

Pas ribashkimit të Gjermanisë, fleksibiliteti relativ i SME-së (Sistemi Monetar Evropian), me rregullime të shpeshta në paritetet e kursit qendror të këmbimit, bëhet pengesë, dhe presionet për të ecur drejt kursit të vërtetë fiks të këmbimit rriten. Për sa i përket Evropës Lindore, miratimi i monedhës së përbashkët dhe procesi i mëposhëm i zgjerimit të BE-së dhe euro-s, nën kujdesin e NATO-s, favorizojnë zgjerimin e kapitalit perëndimor dhe pushtimin e tregjeve të reja të çliruara nga komunizmi. Në aspektin e brendshëm, monedha e vetme vepron si një mjet disiplinimi fiskal dhe social, duke i ndaluar vendet me inflacion më të lartë (siç është Italia) të përdorin zhvlerësimet konkurruese për t'u rikthyer në rrugën e duhur, dhe duke i detyruar ato të angazhohen në kufizimin e inflacionit nëpërmjet mosrritjes së pagave, terren në të cilin Gjermania e ribashkuar ka një avantazh absolut.

Fundi i SME-së dhe konvergjenca në euro

SME-ja përfundoi efektivisht në shtator 1992, me sulmet spekulative kundër paundit dhe lirës, të udhëhequra nga Soros-i i gjithëpranishëm, me pëlqimin e Bundesbank-ut.

Banka Qendrore Gjermane mund ta kishte shpëtuar lehtësisht SME-në dhe t'u shkaktonte humbje kolosale spekulatorëve thjesht duke shitur marka (të cilat mund t'i printojë pa kufi) dhe monedha të tjera të forta në këmbim të stërlinave dhe lirave, siç përcaktonin marrëveshjet (edhe pse, faktikisht, Bundesbank-u ka urdhëruar gjithmonë që të jenë monedhat e dobëta ato që mbrojnë paritetin apo kërkojnë riorganizimin e kërkesës).

Vendi që nuk e respekton paritetin e dakordësuar të këmbimit, sidoqoftë, është pikërisht Gjermania, që duke rritur normat e interesit, për të tërhequr kapital për investim në aneksimin ekonomik të Gjermanisë Lindore, hedh në erë gjithë sistemin e paritetit të kurseve të këmbimit duke ekspozuar valutat e vendeve me inflacion të lartë ndaj sulmeve spekulative.

Guvernatori i Bankës së Italisë, Carlo Azeglio Ciampi – i cili që nga viti 1979 kishte grumbulluar në fakt njëfarë përvoje në zhvleftësime – nuk është dakord dhe vendos të mbrojë lirën i vetëm kundër spekulimeve ndërkombëtare. Rezultati është i qartë: atë që humbet Bankitalia (një pjesë e madhe e rezervave valutore), e fitojnë Soros & Co.

Në të vërtetë, siç parashikohet nga marrëveshjet e Masstricht-it, të nënshkruara pak muaj para krizës valutore, duhet të kalohen disa faza për krijimin e monedhës së përbashkët. Shtetet duhet fillimisht të vërtetojnë se janë në gjendje të plotësojnë kushtet

ekonomike dhe financiare të nevojshme për kalimin në një regjim të kurseve fikse të këmbimit.

Në Itali, hapet kështu sezoni i qeverive teknike dhe “planeve të rimëkëmbjes”, domethënë i manovrave kufizuese dhe planeve antishoqërore që duhet të miratohen si kusht për hyrjen në BE. Pasi tregoi cilësitë e tij teknike në krye të institutit emetues, Ciampi është protagonist edhe i këtij procesi. Pasi zbrazti krejt rezervat valutore të vendit, zbrazti edhe pagat e punëtorëve. Në vitin 1993, ai largohet nga Bankitalia dhe merr Kryesinë e Këshillit të Ministrave, i pari Kryeministër jashtëparlamentar në historinë e Republikës. Që këtej, ai dikton rregullat e reja për bashkërendimin, frenimin e pagave dhe frenimin e c publik, në funksion të konvergjencës me euron. Më në fund, në vitin 1999, pak muaj pas nisjes së euros, ai zgjidhet President i Republikës.

Procesi është i ngjashëm në të gjithë Evropën. Vitet 1990 nuk janë vite të debatit politik, por të konvergjencës me euron. Nuk ka rëndësi kush shkon në qeveri. Gjëja e rëndësishme është përafrimi i shpejtë me standardet fiskale dhe financiare të Gjermanisë.

Roli qendror i Gjermanisë në institucionet e BE-së dhe euros rrjedh nga ky proces historik i udhëhequr nga Shtetet e Bashkuara, i cili hapet me pushtimin e Gjermanisë Lindore nga Gjermania Perëndimore dhe me vendosjen e kritereve të konvergjencës evropiane të kalibruara mbi parametrat e rreptësisë së financave publike gjermane, për të mbrojtur vlerën e monedhës së përbashkët.

Banka Qendrore Evropiane është projektuar sipas modelit të Bundesbank-ut dhe, duke parë kontekstin në të cilin lind, asaj i besohet një objektiv i vetëm: frenimi i inflacionit, në kontrast me statutet e bankave qendrore kryesore botërore, të cilat, të paktën zyrtarisht, duhet të ndjekin edhe rritjen e prodhimit dhe luftën kundër papunësisë.

Në të njëjtën kohë, sërish nga një këndvështrim

anti-inflacionist, vendet e Bashkimit Evropian marrin përsipër të respektojnë Paktin e Stabilitetit dhe Rritjes, i cili vendos masa shtrënguese mbi financat publike dhe kufizimin e kërkesës.

Në kontekstin e ri institucional, shtetet e humbasin plotësisht autonominë monetare dhe një pjesë të autonomisë fiskale. Dhe kjo shkon në avantazh të institucioneve të centralizuara në nivel mbikombëtar, që kanë rregulla asimetrike të politikës monetare dhe fiskale, të orientuara në një drejtim kufizues, duke i detyruar vendet e euros që, si kusht për të qenë konkurrues në tregun e vetëm, të hyjnë në garë për uljen pagave.

Ky shtjellim i shkurtër sigurisht që nuk synon të minimizojë rolin politik të shteteve evropiane dhe peshën ekonomike të kapitalit evropian në ndërtimin e tregut të përbashkët dhe të monedhës së përbashkët. Por regjia e këtyre proceseve ndodh në anën tjetër të oqeanit, në vendin që u hodh i fundit në luftë kundër nazizmit, dhe që ka luftuar gjithmonë kundër komunizmit.

Në fund të luftës, Shtetet e Bashkuara janë vendi që ka pësuar më pak humbje njerëzore dhe materiale, i vetmi me kapital me bollëk. Me rindërtimin e pasluftës dhe marrëveshjet valutore, dollari bëhet monedhë hegjemonike dhe kapitali amerikan depërton në Evropën kapitaliste. Fundi i Luftës së Ftohtë i mundëson kapitalit amerikan të zgjerohet në vendet post-socialiste. Kjo është tabloja e marrëdhënieve mes SHBA-së dhe BE-së. Krijimi i BE-së dhe euros nuk përbëjnë aspak një sfidë për kapitalin amerikan dhe hegjemoninë e dollarit. Përkundrazi, ato janë pjesë e strategjive të pushtimit të vendeve post-socialiste nga kapitali amerikan, tashmë i integruar mirë me ato evropiane.

Konfliktet e brendshme të Bashkimit Evropian

Në eurozonë bashkëjetojnë tre grupe vendesh me kushte ekonomike, peshë vendimmarrëse dhe objektiva të ndryshëm. I pari përbëhet nga vendet financiarisht më të shëndetshëm dhe teknologjikisht më të avancuar: Austria, Belgjika, Finlanda, Franca, Gjermania, Luksemburgu dhe Holanda.

Grupi i dytë është ai i të ashtuquajturve PIGS ose PIIGS, me inflacion më të lartë dhe financiarisht më të dobët: Portugalia, Italia, Greqia dhe Spanja, të cilave më vonë iu bashkua edhe Irlanda. Përveç Greqisë, që e ka futur euron më 1 janar 2001, të gjithë vendet e përmendur kanë qenë anëtarë themelues të euros që nga viti 1999.

Së fundi, grupi i tretë përbëhet nga aneksime të mëvonshme, të pas 2007-s. Këta janë vende, objektivist më pak të aftë të ndikojnë në politikën e euros, të përfshirë në eurozonë në procesin e zgjerimit drejt lindjes: Sllovenia, Qiproja, Malta, Sllovakia, Estonia, Letonia, Lituania, Kroacia.

Që prej hyrjes së euros, vendet me inflacionin më të ulët, ato të grupit të parë, e kanë rritur aftësinë konkurruese dhe peshën e tyre në tregun e përbashkët evropian, me efekte pozitive në bilancin tregtar. Vendeve të grupit të dytë u ka ndodhur pikërisht e kundërta.

Kalimi në monedhën e përbashkët i ka transferuar gjithashtu të gjithë çekuilibrat financiarë në normat e interesit. Në vendet me inflacionin më të lartë, tensionet financiare – të cilat, në një sistem të kurseve fleksibël të këmbimit, do të zgjidheshin me riorganizimin e kurseve të këmbimit – shkarkohen në diferencat e normave të interesit krahasuar me Gjermaninë, duke e bërë gjithnjë e më të vështirë ri-

financimin e borxhin. Në këtë sistem, kriza financiare, cilido qoftë shkaku i saj, shfaqet si krizë e borxhit publik të vendeve periferike.

Si në nivel ekonomik, ashtu edhe në atë financiar, ajo që ndodhi përkon fjalë për fjalë me atë që parashikojnë manualët e ekonomisë ndërkombëtare mbi kalimin nga kurset fleksibël të këmbimit në kurset fikse. Për Gjermaninë dhe vendet me inflacion të ulët, euroja është mjeti për t'u rritur dhe afirmuar në Evropë. Anasjelltas, për vendet me inflacion të lartë, i vetmi nxitës për të futur euron është i natyrës së brendshme, si një instrument i rregullimit të punës, që u mbyll gojën pretendimeve për paga në emër të konkurrencës ndërkombëtare. Për këtë arsye, edhe nëse vendet e grupit të dytë janë derra, janë vendet e grupit të parë që i mbajnë gjallë: për të mos hedhur në erë të gjithë stallën e derrave me të cilën ata nxjerrin fitime.

Në historinë e euros, problemi me PIIGS-at është se, megjithëse ata formojnë një grup me probleme të ngjashme të financave publike, ata nuk veprojnë si grup. Përkundrazi, ata janë të detyruar të lëvizin individualisht, për më tepër në momentin e dobësisë më të madhe të secilit. Trojka – e formuar nga FMN-ja, BQE-ja dhe Komisioni Evropian – vepron kompakte, ndërsa PIIGS-at, njëri pas tjetrit, me përjashtim të Italisë (të paktën tani për tani), duhet të pranojnë programet e saj të rregullimit, që përmbajnë privatizime, masa shtrënguese dhe shkurtime në shpenzimet sociale.

Me shpërthimin e pandemisë, BE-ja është ndërlyshas. Evropa nuk mund të përballet me problemin e borxhit ndërsa konkurrenca ndërkombëtare po përshpejtohet. Problemi i PIIGS-ave mund të presë. Tani duhen investime. BE-ja duhet të ndryshojë strategjinë e saj. Më 20 mars 2020, për herë të parë në historinë e Bashkimit, Presidentja e Komisionit von der Leyen njofton pezullimin e Paktit të Sta-

bilitetit dhe Rritjes. Nga rubrikat e Financial Times, ish-Guvernatori i BQE-së Mario Draghi iu bën thirrje shteteve të Bashkimit të hyjnë në borxhe.⁸⁵ Pas vitesh masash kufizuese, paktet ndërkombëtare që kufizojnë shpenzimet, deficitet dhe borxhin, shantazhet e *spread*-it dhe planet strukturore për ata që gabojnë, papritur, parimet e shenjta të ashpërsisë buxhetore përmbysen, për t'i lejuar shtetet të ndërmarrin planin më të madh të investimeve publike në mbështetje të kapitalit teknologjik privat.

Historikisht, Gjermania dhe vendet nordike e kanë kundërshtuar gjithmonë menaxhimin e ndërsjelltë të borxhit. Tani, përballë rrezikut të shpërbërjes së euros dhe BE-së, pikërisht teksa po luhet loja e tranzicionit teknologjik, këto vende duhet të heqin dorë nga ky parim i shenjtë. Ndërmjetësimi brenda BE-së bëhet nga boshti franko-gjerman dhe kompromisi është sigurisht me interes pikërisht për vendet nordike.

Për të financuar planet evropiane të rimëkëmbjes – Next Generation EU – Komisioni Evropian është i autorizuar të mbledhë deri në 750 miliardë euro në tregjet financiare për llogari të Bashkimit Evropian, për t'ua transferuar shteteve që i kërkojnë, të cilët duhet t'i shpenzojnë sipas prioriteteve të përcaktuara nga vetë Komisioni.

Nga njëri krah, shtetet me më shumë borxhe përfitojnë kështu norma interesi të favorshme në krahasim me ato të tregut. Nga ana tjetër, shtetet më të qëndrueshme financiarisht i mbrojnë interesat e tyre duke përcaktuar sektorët e synuar dhe kriteret për shpenzimin e fondeve të marra në hua.

Këta të fundit, të cilët gëzojnë interesa më të ulëta se obligacionet evropiane, padyshim që nuk kanë arsye për t'iu drejtuar fondeve evropiane. Gjermania, për shembull, gëzon norma negative: shteti gjerman

85 Financial Times, Draghi: we face a war against coronavirus and must mobilise accordingly.

shih që borxhi i tij të reduktohet automatikisht nga viti në vit, pa pasur nevojë të marrë asnjë masë kufizuese. Këto vende jo vetëm që nuk kanë nevojë për obligacione evropiane, por as nuk e mirëpresin faktin që duhet të kontribuojnë në garantimin e kredive për PIIGS-ët. Për më tepër, teknikisht, në tregjet e obligacioneve, emetimi i obligacioneve evropiane konkurren me bondet gjermane në fushën e letrave me vlerë më të sigurt, duke bërë që obligacionet gjermane të humbasin një pjesë të primit të rrezikut si një garanci e sigurt.

Krahas huave, Komisioni jep edhe grante, marrja e të cilave varet nga prezantimi i Planit Kombëtar të Rimëkëmbjes dhe reziliencës prej shteteve anëtare. Në përlllogaritjen e kosto-përfitimeve të çdo vendi, qoftë edhe të atyre me normat më të ulëta të interesit, kjo i shtyn të respektojnë prioritetet e Komisionit.

Në përgjithësi, rezultati i arritur është se të gjithë vendet e Bashkimit inkurajohen të hyjnë në borxhe, përmes kanaleve të tyre ose lehtësirave evropiane, për të favorizuar tranzicionin teknologjik.

Kalimi në ekonominë e gjelbër është një proces i gjatë. Ndërsa Shtetet e Bashkuara dhe Kina e përshkallëzojnë përplasjen mes tyre, edhe Evropa duhet të përshpejtojë. Nuk është momenti të kapemi me PIIGS-at, është tregu i teknologjisë së lartë që duhet ndarë. Problemi i borxhit do të trajtohet në të ardhmen.

Kriza monetare

Ndër vendet perëndimore, Shtetet e Bashkuara janë të parat që u kthyen në nivelet e prodhimit të para krizës, pas goditjes së prodhuar nga izolimi. Kjo ndodh në tremujorin e dytë të vitit 2021, ndërkohë që vendet evropiane janë ende në vështirësi. Fituesja e vërtetë e *stop-and-go* të izolimit është Kina, e cila u ndal e para, në fillim të vitit 2020, dhe rifilloi pa probleme. Falë planifikimit, ajo praktikisht e thithi goditjen brenda një tremujori, dhe tashmë nga tremujori i tretë i 2020-ës ka rinisur funksionimin me kapacitet të plotë.⁸⁶

Rimëkëmbja e ekonomisë në Shtetet e Bashkuara dhe në Evropë është më e ngadaltë dhe shoqërohet me një rritje të shpejtë të çmimeve. Shkaqet kryesore janë të dyfishta dhe lidhen me kushtet monetare dhe me ngushtimin e ofertës.

Nga pikëpamja monetare, ekspansioni i ri i nisur gjatë izolimit të vitit 2020 nuk prodhon efekte të menjëhershme inflacioniste pikërisht sepse ekonomia është e detyruar me forcë të ecë ngadalë. Prandaj, likuiditeti i injektuar në sistemin bankar derdhet tërësisht në tregjet financiare, duke fryrë çmimet e aksioneve dhe obligacioneve, të cilat fluturojnë drejt niveleve më të larta të të gjitha kohërave. Në vitin 2021, megjithatë, me rinisjen e aktiviteteve prodhuese, rritja e likuiditetit gjen një dalje të pjesshme edhe në ekonominë reale, duke shkaktuar rritjen e çmimeve.

Nga ana e ofertës, për më tepër, rimëkëmbja duhet të merret me ndërprerjet në zinxhirin e prodhimit botëror të shkaktuar nga *lockdown*-i dhe me pasojat e mungesës së mallrave dhe shërbimeve të nevojshme për prodhimin. Çmimet nuk rriten sepse të gjithë do të donin të blinin më shumë (duke pasur parasysh,

sidoqoftë, rënien e të ardhurave të fashave të mëdha të popullsisë pas masave anti-pandemike), por sepse të prodhosh, në këto kushte, kushton më shumë.

Viti 2021 është një vit i zi për inflacionin në SHBA: nga 1.4 % në janar, ai rritet në 7.0% në dhjetor.⁸⁷ Me një normë nominale interesi zero, inflacioni 7% nënkupton një normë reale interesi prej -7% (norma reale e interesit është e barabartë me diferencën midis normës nominale të interesit dhe normës së inflacionit). Normat reale negative të këtyre vlerave nuk u panë as gjatë niveleve më të ulëta historike të viteve 1974 dhe 1980, pas krizës së naftës, dhe duhet të kthehemi në periudhën midis viteve 1947 dhe 1951 për të gjetur vlera kaq të ulëta.⁸⁸

Me norma reale negative, bankat humbasin, nuk fitojnë. Një bankë që jep hua 100 dollarë me një normë nominale interesi prej 2%, merr 102 dollarë pas një viti. Megjithatë, nëse ndërkohë çmimi i bananeve ka shkuar nga 1 dollar në 1.07 dollarë (norma e inflacionit 7%), me ato 102 dollarë banka nuk do të mund të blejë më 100 banane, si në momentin e dhënies së kredisë, por vetëm 95.3 (102 dollarë pjesëtuar me 1.07). Në terma nominalë, banka fitoi dy dollarë; në terma realë, humbi pesë banane.

Federal Reserve nuk mund të bëjë asgjë tjetër: ajo duhet të rrisë normat e referencës dhe duhet ta bëjë atë me vendosmëri. Jo dhe aq sepse kjo në fakt mund të ndryshojë rrjedhën e inflacionit në një periudhë afatshkurtër, që është efekt i vendimeve monetare të kaluara dhe problemeve të ofertës, të cilat mbeten të pandryshuara pavarësisht nga veprimi i kërkesës. Por sepse është e vetmja mënyrë për të rritur normën reale të interesit: norma nominale e interesit duhet të rritet më shpejt se inflacioni. Është një çështje aritmetike dhe jo ekonomie.

87 Statista, Monthly 12-month inflation rate in the United States.

88 Longtermtrends, The Real Interest Rate.

Kthesa në politikën monetare u njoftua në fillim të janarit 2022, kur asnjë tank rus nuk kishte kaluar kufijtë e Ukrainës dhe tregjet financiare amerikane dhe evropiane ndryshuan menjëherë trendin e tyre, i cili deri në atë moment ishte thellësisht rritës.

Kriza monetare fillon më 17 mars 2022, me një rritje fillestare të normës së interesit të referencës, normës së fondeve federale, me 25 pikë bazë, e ndjekur në maj me një rritje me 50 pikë të tjera bazë dhe me tre ndërhyrje nga 75 pikë secila, në qershor, korrik dhe shtator, duke kaluar nga intervali 0-0.25% në intervalin 3.0-3.25%.⁸⁹

Në konferencat për shtyp pas vendimeve të Fed-it, ku fjalët e Guvernatorit kanë bërë që Nasdaq të lëvizë në kohë reale, Jerome Powell flet për mbrojtjen e familjeve dhe kursimtarëve të vegjël dhe për inflacionin fajëson Covid-in dhe Rusinë. Deri në atë moment tregjet nuk lëvizin. Është në momentin kur ai komenton strategjinë e reduktimit të bilancit të Federal Reserve, pas vitesh *quantitative easing* (janë programet e blerjeve të mëdha të letrave me vlerë të llojeve të ndryshme nga banka qendrore), dhe nevojën për t'i sjellë normat e interesit në një zonë kufizuese, si kusht për të mundur inflacionin në garën se kujt i rritet më shumë, që tregjet lëvizin.

Hera e fundit që Fed-i ka zbatuar një politikë kaq agresive ndaj normave të interesit ishte në vitet 1980. Nga viti 1979 deri në 1987, guvernator ishte Paul Volcker-i, i cili mbahet mend si njeriu që mundi inflacionin. Motoja e tij ishte “No pain, no gain” (e rimarrë edhe nga Arnold Schwarzenegger-i): nuk ka fitim pa dhimbje, e para padyshim ishte për kapitalistët dhe bankierët dhe e dyta për punëtorët. Kriza monetare në fakt ndodhi në koordinim me sulmin klasor të nisur nga Ronald Reagan-i dhe Margaret Thatcher-i në emër të tregut të lirë.

Edhe në këtë rast, në lojë ishte një ndryshim i

rëndësishëm paradigmatic: kalimi global në paradigmen neoliberalë, me ndryshimet sociale dhe kulturore përkatëse. Këto procese, për ata që e njohin historinë e kapitalizmit, janë gjithmonë të dhunshme dhe nënkuptojnë kosto sociale të larta dhe asimetrike, të cilat prekin veçanërisht segmentet më pak të mbrojtura të popullsisë.

Por le të kthehemi në të tashmen. Ndërsa Fed-i mbyll rubinetat e kredisë, inflacioni në SHBA arrin një maksimum prej 9.1% në qershor 2022, përpara se të bjerë në 8.5% në korrik dhe 8.3% në gusht.⁹⁰

Kuadri në Evropë është i ngjashëm. Në pjesën më të madhe të BE-së, rimëkëmbja është më e ngadaltë se në SHBA e po ashtu edhe inflacioni. Eurozona vjen nga norma inflacioni negative në gjysmën e dytë të 2020-ës: *lockdown*-i ka pasur efekte ekonomike katastrofike në Evropë dhe deflacioni është pasojë e tij.

Edhe në këtë rast, rimëkëmbja ndeshet me të njëjtat probleme të bollëkut të madh të parave dhe pengesave në zinxhirin e prodhimit. Inflacioni fillon të rritet më ndjeshëm vetëm në tremujorin e fundit të vitit 2021; shpërthen në mars 2022 me sanksionet ndaj Rusisë; tejkalon atë të Shteteve të Bashkuara në korrik 2022, në 8.9%; dhe rritet sërish në gusht, duke shkuar në 9.1%.⁹¹

Edhe BQE-ja, kësisoj, duhet t'i përshtatet krizës monetare, që po zhvillohet tashmë në të gjithë vendet e zonës së dollarit. Kuptohet, pasi vendet e euros i kanë nisur planet e tyre të rimëkëmbjes, tërësisht në borxhe, kur normat e interesit ishin zero.

Në këtë kontekst, merr një rëndësi të veçantë Simpoziumi vjetor i Jackson Hole-it, i gushtit të vitit 2022, ku drejtuesit e bankave qendrore, politikanët dhe ekonomistët nga e gjithë bota, me ftesë të Federal Reserve të Kansas City-t, mund të mbajnë shën-

90 Statista, Monthly 12-month inflation rate in the United States.

91 Eurostat, Inflation in the euro area.

im udhëzimet e guvernatorit Powell mbi metodat e koordinimit mes bankave qendrore në menaxhimin e krizës monetare. Shtetet e Bashkuara janë, në fakt, të shqetësuara që rritja e normave të interesit të brendshëm, nëse nuk shoqërohet me masa të ngjashme nga bankat e tjera qendrore, do të prodhojë një mbivlerësim të dollarit dhe do të ulë konkurrencën e kompanive amerikane në tregjet ndërkombëtare. Kështu, më 8 shtator 2022, BQE-ja nis fazën e re të kufizimit të kredisë me një rritje fillestare të normave të referencës me 75 pikë bazë, e cila e çon normën e operacioneve kryesore të rifinancimit në 1.25 %.⁹²

Efektet e krizës monetare globale janë lehtësisht të parashikueshme. Në frontin e kapitalit, rritja e normave të interesit tenton të shfryjë tregjet financiare, të pastrojë tregun e kompanive në vështirësi, veçanërisht në sektorët tradicionalë, dhe të favorizojë procesin e centralizimit në dobi të kapitaleve financiare më të mëdha e më të qëndrueshme.

Në frontin e punës, papunësia, pushimet nga puna dhe punët e pasigurta priren të rriten, duke i detyruar punëtorët të përshtaten shpejt me paradigmen e re teknologjike. Nga ky këndvështrim, përsosja e mjeteve të kontrollit dhe disiplinimit shoqëror të aplikuara në luftën kundër pandemisë, nga ku buron fragmentimi i mëtejshëm i lëvizjes punëtore – tashmë e ndarë edhe në funksion të vaksinës apo lejekalimit –, përcaktojnë një kuadër të marrëdhënieve shoqërore objektivisht të favorshme për kapitalin, që synon ta shkarkojë barrën e tranzicionit tërësisht mbi klasën punëtore.

Në fund, në frontin e borxhit publik, rritja e normave të interesit afron momentin e krizës së borxhit sovran dhe kalimin e pushteteve ekonomike nga shtetet me borxhe te institucionet financiare ndërkombëtare.

Borxhi publik

Një nga treguesit më domethënës të qëndrueshmërisë financiare të një shteti është raporti borxh publik/PBB. Madhësia e PBB-së në fakt përcakton shkallën e aftësisë së shtetit për të shlyer borxhet nëpërmjet mbledhjes së taksave.

Një nivel i lartë borxhi, i shoqëruar nga të ardhura të forta tatimore ose, në përgjithësi, nga aftësia për të gjeneruar teprica të mëdha buxhetore (për shembull, nëpërmjet shkurtimeve të shpenzimeve publike ose nëpërmjet privatizimeve) nuk i shqetëson kreditorët. Anasjelltas, i njëjti nivel borxhi, në një ekonomi të vogël, nënkupton një default teknik për shtetin dhe rrjedhimisht për bankat kreditore: bankat që fitojnë para duke u dhënë hua vendeve me një raport të lartë borxh/PBB (nga ku përfitojnë norma interesi të leverdisshme) janë të dënuara me falimentim nëse mbesin “me dobiçin në prehër” kur shteti është i detyruar të ndalojë pagesat.

Për vite me radhë, problemi i borxhit publik mbetet i kufizuar te PIIGS-at, të cilët karakterizoheshin pikërisht nga një raport i lartë borxh/PBB. Megjithatë, ngadalësimi i rritjes dhe planet e rimëkëmbjes ekonomike tërësisht të bazuara në borxhe po e kthejnë atë në një problem të përgjithshëm. Nga njëra anë, në fakt, planet e rimëkëmbjes kanë rritur numëruesin e raportit borxh/PBB në Shtetet e Bashkuara dhe në të gjithë Evropën; nga ana tjetër, përkeqësimi i krizës ekonomike, pas masave anti-pandemike dhe luftës ekonomike kundër Rusisë, e tkurri ndjeshëm emëruesin. Raporti borxh/PBB po rritet me shpejtësi.

Rritja e normës së interesit iu dha goditjen e fundit shteteve borxhlinj. Në fakt, rritja e shpenzimeve për interesat ka tendencën ta bëjë dinamikën e borxhit shpërthyesë, në një kontekst ku shtetet duhet

të vazhdojnë të marrin hua për të mbështetur tranzicionin teknologjik dhe luftën ekonomike kundër Rusisë. Paralelisht, në emërues, kriza monetare po frenon rritjen ekonomike, në një klimë pasigurie në të cilën sipërmarrësit në shumë sektorë po pyesin nëse duhet t'i mbyllin përfundimisht bizneset e tyre, në vend që t'i zhvillojnë ato me investime të reja. Raporti borxh/PBB po fulturon.

Problemi tani nuk janë PIIGS-at, është sistemik. Zgjerimi i borxhit, në një kontekst krize ekonomike dhe rritje të normave të interesit, zvogëlon hapësirën për manovrim edhe për ato ekonomi historikisht më të qëndrueshme në nivel financiar.

Sistemi bankar, i cili nuk ka dalë kurrë nga kriza bankare që filloi në vitin 2007 në Shtetet e Bashkuara, është në rrezik të madh në këtë proces. Një gjë është të përballesh me humbjet që lidhen me default-in e një vendi, me një peshë ekonomike dytësore brenda BE-së; dhe tjetër gjë është të merresh me default-in e njëkohshëm të disa vendeve, disa prej tyre me përmasa të konsiderueshme ekonomike.

Për të mos përmendur hipotezën – që për fatin e mirë të kapitalit nuk merret vërtet në konsideratë nga asnjë prej forcave kryesore politike – që një shtet i një kalibri të caktuar ekonomik e kundërshton borxhin në bllok, si një akt politik. Në luftën ekonomike, kjo do të ishte një bombë e vërtetë atomike mbi sistemin bankar.

E vërteta është se sistemi bankar është në krizë prej shumë vitesh. Në vitin 2008, fillimi i fazës së quantitative easing dhe normave të interesit zero, fillimisht në SHBA dhe më pas në Evropë, nuk ka të bëjë aspak me vlerësimet për ekonominë reale. Ajo shërben vetëm për të shpëtuar bankat e zhytura në krizën e subprimeve, që në Evropë merr formën e krizës së borxhit publik.

Në vitin 2021, ndërkohë që shumë banka ende po përballen me këtë problem, shpërthen bomba

e normave reale negative të interesit, duke prekur të gjithë sistemin bankar. Përsëri, bankat qendrore duhet të nxitojnë për t'i shpëtuar, këtë herë duke rritur ndjeshëm normën e interesit: sigurisht jo duke parë kërkesën për investime (e cila, në kontekstin e post-pandemisë, në fakt është ende e ulët), por vetëm normën e inflacionit, këtë numër të mallkuar që norma e interesit duhet ta ndjekë dhe ta kalojë, për ta kthyer normën reale në zonën pozitive.

Megjithatë, pompimi dhe transferimi i parave nuk shërben për asgjë nëse nuk ndryshojnë kushtet ekonomike nga të cilat përfitojnë bankat. Ajo që nevojitet është një krizë e thellë ekonomike, e cila prek në radhë të parë sektorët tradicionalë, që prodhon papunësi dhe që rrit shkallën e përgjithshme të shfrytëzimit të punës. Vetë Powell e thotë mes rreshtave, kur flet për spiralen paga-çmime: inflacioni luftohet duke ulur pagat.

Kështu, kriza kalon nga bankat te punëtorët, me kontributin e shtetit. Bankat janë në fakt kreditorët kryesorë të shteteve. Ata janë në krizë prej disa kohësh dhe shtetet e bankat qendrore po bëjnë gjithçka për t'i shpëtuar. Por kur spekulimet financiare sulmojnë shtetet borxhlinj dhe i detyrojnë ata të bien në default të kontrolluar, janë bankat që, nëpërmjet trojkës, diktojnë reformat strukturore për t'i shtrydhur më mirë punëtorët.

Në këtë proces të rishpërndarjes së pushteteve, shtetit i mbeten funksionet shtrënguese dhe shtypëse ndaj popullit të tij dhe një pushtet i kufizuar ekonomik. Ky i fundit në fakt kryhet drejtpërdrejt nga kreditorët ndërkombëtarë. Punëtorëve, ndërkohë, nuk u mbetet gjë tjetër veçse të punojnë më shumë, në kushte më të këqija, për një pagë më të ulët, si kusht për shlyerjen e borxheve që shteti ka marrë në emër të tyre. Sigurisht, në mbrojtje të shëndetit të tyre dhe demokracisë në Evropë.

Konkluzione

Fakti më evident i konfliktit ruso-ukrainas është se të gjithë këtë proces nuk e fillon aspak Rusia, sepse synon të zgjerojë sferën e saj të interesave ekonomike dhe gjeopolitike. Aq më pak Ukraina e cila, sipas rrëfimit perëndimor, është teatër i një lëvizjeje spontane të një populli të gatshëm të bëjë gjithçka për të hyrë në BE, dhe të shtypur brutalisht (tetë vjet pas grushtit të shtetit pro perëndimor) nga ndërhyrja ushtarake ruse.

Përkundrazi, konflikti nis nga Shtetet e Bashkuara, si një sulm ekonomik kundër BE-së në një kontekst post-pandemik, dhe si një zhvillim i mëtejshëm i procesit të përgjithshëm të kapitalizimit, nga pikëpamja ekonomike dhe ushtarake, të fitores kundër Bashkimit Sovjetik në Luftën e Ftohtë. Rënia e Murit të Berlinit shënon rezultatin përfundimtar të konfliktit dhe, vit pas viti, vend pas vendi, Shtetet e Bashkuara u kërkojnë të mundurve të paguajnë faturën.

Nga pikëpamja ushtarake, Ukraina është një element strategjik në zgjerimin e NATO-s drejt Rusisë. Procesi i destabilizimit të Ukrainës është i gjatë: ai fillon me shpërbërjen e Bashkimit Sovjetik dhe, pas shtrembërimit të disa zgjedhjeve popullore dhe një grushti shteti, shpie në krijimin e një qeverie pro-SHBA, shoqëruar me ngritjen e nazizmit, edhe ky i nxitur dhe i financuar nga shoqëria civile e Soros-it dhe nga degët sekrete të NATO-s. Kufijtë e autonomisë së Ukrainës në zgjedhjet ekonomike, politike dhe ushtarake tani janë reduktuar në zero. Ukraina është vetëm një pozicion i përparuar i NATO-s kundër Rusisë, pa asnjë autonomi politike.

Nga pikëpamja ekonomike, Ukraina luan një rol të rëndësishëm në procesin e depërtimit të kapitalit amerikan në Evropë, i cili fillon pas Luftës së Dytë

Botërore në vendet e bllokut perëndimor dhe zhvillohet në Lindje me rënien e socializmit real. Ukraina përbën në fakt një vend kyç për t'i imponuar BE-së mallrat e prodhuara me teknologji të avancuar nga kapitali amerikan, dhe për të zgjeruar dominimin ekonomik të SHBA-së në Evropën Lindore.

Që nga vitet 1990, Shtetet e Bashkuara kanë pasur vetëm një shqetësim në lidhje me procesin e zgjerimit të BE-së të udhëhequr nga Gjermania: që Gjermania dhe Rusia të zhvillonin marrëdhënie të privileguara ekonomike që do të dobësonin në mënyrë të pashmangshme rolin udhëheqës të kapitalit amerikan në Evropë.

Destabilizimi i Ukrainës u mundëson Shteteve të Bashkuara të shtyjnë kundër boshtit ekonomik ruso-gjerman, me mjete të gjithanshme: nga ndërhyrja në çështjet ekonomike midis dy vendeve – një shembull i bujshëm është bllokada e gazsjellësit *Nord Stream 2*, përpara ndërhyrjes ushtarake ruse – deri tek presionet politiko-ushtarake për të futur BE-në në luftë kundër Rusisë.

Por në fazën imperialiste të kapitalizmit shtetet nuk janë gjithçka. Pas politikave kombëtare dhe ndërkombëtare ka kapitale në konkurrencë me njëri-tjetrin, herë në kërkim të marrëveshjeve, herë në konflikt të hapur. Gjermania, si çdo vend, ka brenda saj kapitale të natyrës së ndryshme. Dhe është pikërisht konkurrenca mes kapitaleve, më shumë se përplasja mes shteteve, që i shpjegohen strategjitë ekonomike dhe ushtarake – në dukje vetëvrasëse nga këndvështrimi i shteteve – të secilit shtet anëtar të BE-së dhe të BE-së në tërësi.

Nuk bëhet aspak fjalë thjesht për servilizëm politik ndaj Shteteve të Bashkuara. Edhe kapitalet evropiane kanë shumë për të fituar nga këto procese. Në veçanti, kompanitë teknologjike më të avancuara, veçanërisht ato gjermane, franceze dhe nordike, përfitojnë nga

zhvillimi i sektorëve të rinj dhe rriten në kurriz të atyre të vjetër. Kjo është logjika e imperializmit: interesat kombëtare u nënshtrohen atyre të kapitaleve më të mëdha dhe më të fortë. Për Gjermaninë, Francën dhe çdo vend evropian, acarimi i marrëdhënieve me Rusinë ka pasoja katastrofike ekonomike për sistemin-vend. Nga ana tjetër, për kompanitë gjermane, franceze apo të vendeve të tjera të përparuara në sektorët teknologjikë dhe në energjitë e rinovueshme, konflikti përbën një burim fitimesh të reja.

Përshpejtimi i konkurrencës ndërkombëtare mes kapitaleve teknologjike, kryesisht të Shteteve të Bashkuara dhe Kinës, nuk i lë BE-së hapësirë për manovrim. Nuk mund të lejohet shkatërrimi i BE-së në këtë fazë. Tani duhet mbështetur kapitali evropian në aleancat e tij me kapitalin amerikanoverior dhe të kufizohet depërtimi i kapitalit kinez (i cili, për më tepër, ka hyrë në Evropë edhe përmes marrëveshjeve dhe projekteve të përbashkëta me kompanitë evropiane, të cilat, dukshëm, e kishin nënvlerësuar rrezikun politik për të bërë biznes me Kinën në territoret e kontrolluara nga NATO-ja).

Shtetet e Bashkuara sulmojnë ekonomikisht Rusinë, por kanë Kinën në horizontin e tyre. Nga ky këndvështrim, BE-ja është vetëm një instrument i politikës imperialiste të SHBA-së dhe një hapësirë për t'u mbrojtur kundër ekspansionit ekonomik kinez. Ka ikur koha kur Kina eksportonte vetëm tekstile të lira dhe produkte të teknologjisë së ulët. Sot Kina eksporton gjithçka, mallra dhe kapital, është një vend lider në shumë degë të sektorëve të teknologjisë së lartë dhe ka një forcë unike ekonomike pas saj, falë planifikimit shtetëror nën udhëheqjen e partisë. Shtetet e Bashkuara kanë ende epërsinë financiare dhe ushtarake. Por Kina është tashmë një konkurrente reale, një superfuqi ekonomike, me synime tregtare globale, e cila sigurisht nuk luan në mbrojtje në ndeshjen e tranzicionit teknologjik.

Nëse tani Washington-i po përpiqet me nxitim të bëjë paqe me Bruxelles-in, duke i hequr tarifat e vendosura në epokën e Trump-it dhe duke punuar për të gjetur furnizues të rinj energjie për BE-në (si dhe natyrisht duke i shitur prodhimin e tepërt të saj me çmime më të larta), këtë e bën vetëm sepse përndryshe BE-ja shpërbëhet. Do të ishte një problem i madh për kapitalin amerikan që në Evropë të përballej vetëm mbi baza ekonomike – pa qenë në gjendje të ushtrijë forcën politiko-ushtarake që kanë nga pas – me kompanitë kineze të gatshme për të investuar dhe për ta shkatërruar konkurrencën pikërisht në sektorët kyç të tranzicionit teknologjik.

Ashtu si pas Luftës së Dytë Botërore, Shtetet e Bashkuara janë të gatshme për ta ndihmuar Evropën, me kusht që kjo të lidhet gjithnjë e më shumë me kapitalin e përtej oqeanit, duke pranuar në mënyrë ashiqare rolin e fuqisë ekonomike të varur ndaj qendrës së perandorisë financiare amerikane. Por tani, ashtu si atëherë, Shtetet e Bashkuara raportohen me aleatët evropianë – si ushtarakisht ashtu edhe ekonomikisht – sipas të njëjtës logjikë me të cilën raportohen me armiqtë e tyre rusë e kinezë, sipas të vetmes logjikë që qendra imperialiste botërore ka konceptuar ndonjëherë, dhe të cilën ne tashmë e kemi pagëzuar: America first!

Ndërrhyrja ushtarake ruse ndodh në një kontekst gjeopolitik pothuajse pa rrugëzgjidhje. Është e qartë se Rusia do të kishte preferuar të vazhdonte strategjinë e saj të konsolidimit dhe zgjerimit të marrëdhënieve me BE-në, nga njëra anë, dhe me Kinën, me vendet e tjera aziatike dhe me BRIKS, nga ana tjetër. Rusia nuk ka sulmuar, ajo është kundërpërgjigjur. Por është gjithashtu e qartë se strategjia ekonomike dhe e sigurisë kombëtare e Rusisë, e kishte gati prej kohësh opsionin ushtarak në Ukrainë dhe luftën ekonomike me bllokun e NATO-s.

Edhe pse e natyrës mbrojtëse, strategjia e Rusisë në luftën ekonomike të nisur nga SHBA-ja dhe BE-ja nuk është shenjë dobësie. Përkundrazi, Rusia e di se rruga që ka marrë nuk ka kthim dhe tashmë po shikon për reputacionin e saj në afatgjatë: po shikon të gjitha ato vende të cilat, për një arsye ose një tjetër, janë ose mund të gjenden në kundërshti me Shtetet e Bashkuara. Rusët nuk i tregojnë muskujt dhe nuk bëjnë kërcënime. Kur ia mbyllin rubinetat e gazit Evropës, thonë se, për fat të keq, një tubacion gazi duhet të riparohet. Amerikanëve që blejnë borxhin publik, ata u kthejnë çdo qindarkë të dollarit (pavarësisht se Thesari amerikan ka përvetësuar ilegalisht rezervat e bankës qendrore ruse). Dhe atyre që nuk sillen si armiq, ata u bëjnë zbritje te gazi dhe u propozojnë marrëveshje valutore alternative ndaj dollarit.

Ekonomikisht, po shkohet drejt një mbylljeje progresive të marrëdhënieve midis blloqeve ndërkombëtare. Lufta tregtare, me taksa doganore dhe kufizime të ndryshme, e nisur nga Shtetet e Bashkuara në 2018-n, fillimisht kundër Kinës, e pastaj kundër BE-së, është vetëm hapi i parë. Lufta ekonomike kundër Rusisë, me pasojë forcimin e një blloku botëror alternativ ndaj atij Perëndimor, vazhdon në këtë drejtim dhe përgatit terrenin për një ballafaqim në nivel më të lartë midis kapitaleve ndërkombëtare shumë të përqëndruara, që konkurrojnë me njëri-tjetrin mbi baza ekonomike, dhe janë të ndarë në blloqe kundërshtarë mbi baza gjeopolitike.

Nga pikëpamja tregtare, çështja e energjisë është në qendër të politikës së mbylljes së Shteteve të Bashkuara ndaj Kinës. Eksportet amerikane të gazit, naftës dhe qymyrit në Kinë kanë rënë ndjeshëm pas konfliktit ruso-ukrainas pasi Shtetet e Bashkuara i devijojnë shitjet e energjisë tek aleatët evropianë dhe Kina rrit furnizimet nga Rusia.

Por mbyllja e tregtisë po prek gjithnjë e më shumë edhe sektorë të tjerë ekonomikë, mes të cilëve bujqësinë, industrinë e manufakturës dhe gjysmëpërçuesit.⁹³ Në kontekstin e ri global, ku tregtia bazohet gjithnjë e më shumë në blloqe të shkëputur gjeopolitikë, inflacioni është i pashmangshëm. Gjithçka kushton më shumë sa më tepër që vazhdohet në trajektoren e mbylljes së tregtisë. Rritja e inflacionit në Shtetet e Bashkuara dhe Evropë është pasojë e natyrshme e këtyre proceseve, të cilët nuk janë asgjë tjetër veçse kalimtarë. Rimëkëmbja post-pandemike me çmimet në rritje është vetëm fillimi.

Në këtë kontekst, kriza monetare është më shumë një domosdoshmëri sesa një zgjedhje. Bankat amerikane dhe evropiane janë në krizë sepse është ekonomia reale ajo që është në krizë. Nëna-Fed nuk mund të bëjë mrekullira. Kapitalizmi ka ligjet e vetë ekonomikë. Fitimi prodhohet nga shfrytëzimi i punëtorëve dhe norma reale e interesit thjesht shpreh pjesën e fitimeve që i takon bankave. Nëse tani është bërë negativ, kjo nuk është aspak për shkak se kapitali bankar dhe industrial nuk mund të bien dakord për ndarjen e tortës, por sepse, me përparimin e krizës, torta zvogëlohet.

Mbushja, për pesëmbëdhjetë vjet, e sistemit financiar me kartmonedha, ka shërbyer për të pastruar (pjesërisht) bilancet e bankave nga letrat me vlerë toksike që u rritën tej mase gjatë të ashtuquajturës krizë të subprime-ve, dhe për të mbështetur çmimet e aksioneve që përndryshe do të kishin rënë. Kriza monetare tani shërben për të shpëtuar bankat nga humbjet që vijnë nga normat reale negative të interesit.

Autoritetet monetare janë të detyruar të ndërhyjnë tani në një drejtim e më pas në drejti-

93 Peterson Institute for International Economics, First trade war, now Russia's real war. Why US exports to China continue to suffer.

min tjetër, në përpjekje për të shpëtuar sistemin bankar nga një krizë që mund të shtyhet, por nuk mund të shmanget, dhe problemi është se sa më shumë shtyhet, aq më tepër rritet ngarkesa e saj eksplozive në momentin e shpërthimit. Ata të Fed-it e dinë mirë se ky problem nuk mund të zgjidhet duke e tërhequr jorganin tani në një drejtim, tani në tjetrin. Powell-i, i cili citon gjithnjë e më shumë paraardhësin e tij të vjetër Volcker, tani duhet t'i tregojë klasës punëtore dykrerëshin e Schwarzenegger-it nëse, përveç kthimit të normës reale të interesit në zonën pozitive, ai dëshiron vërtet të rrisë normën e përgjithshme të fitimit të ekonomisë. Sepse norma e fitimit rimëkëmbet vetëm me rritjen e shkallës së shfrytëzimit të punëtorëve.

Në mbyllje të kësaj vepre, në të cilën – pa i fshehur qëndrimet e mia – kam zhvilluar arsyetimin tim mbi baza ekonomike, fakte historikë dhe të dhëna objektive, do ia lejoj vetes disa komente të karakterit politik për goditjen e fuqishme që ka dhënë kapitali klasës punonëtorë përmes luftës kundër Covid-it dhe luftës kundër Putin-it.

Për shumë njerëz, kriza e koronavirusit duket si një rrufe në qiell të hapur dhe si një proces shumë kontradiktor. Parë në çdo dimension të saj, strategjia për të luftuar Covid-in duket si një vetëvrasje e vërtetë. Paefektshmëria dhe natyra kontradiktore e politikës shëndetësore, irracionaliteti ekonomik i lockdown-it, vala shtypëse shpërpjestimore, në mos më shumë, ndryshimi i rregullave gazetareske dhe informative, me ndalimin e çdo opinionit kritik, nuk duket se gjejnë një shpjegim bindës.

Në një plan thjesht ekonomik, ndalimi i prodhimit i vendosur si masë kundër pandemisë është një autogol real për ekonominë kapitaliste. As në kohë lufte, prodhimi nuk ndalet. Dhe për sa i përket shëndetit, asnjëherë nuk ka pasur një mbyllje të përgjithshme të popullsisë. Në një sistem ekonomik tashmë

në krizë, këto masa i japin goditjen përfundimtare sektorëve të mëdhenj ekonomikë në mbarë botën. Por njëkohësisht, ato përbëjnë një mundësi joshëse për sektorët më të avancuar kapitalistë për të pushtuar sektorët në krizë me çmime të volitshme.

Ndërsa gjysma e botës është ende duke lëpirë plagët e shkaktuara nga kjo tragjedi, më shumë ekonomike sesa shëndetësore, kemi shpërthimin zyrtarisht të luftës në zemër të Evropës. Përsëri, bota tronditet. Askush me sa duket nuk e priste, dhe i vetmi shpjegim që jepet nga mediat me rrjet të unifikuar është rizgjimi i papritur i nacionalizmit ekspansionist të Car Putinit të ri.

Nga një emergjencë në tjetrën, popujt e Evropës janë të detyruar të paguajnë për zgjedhje politike ekstreme, të pakuptueshme për shumëkënd dhe me pasoja ekonomike katastrofike. Megjithatë, nëse këto procese qëndrojnë pas kuadrit të ballafaqimit/përplasjes mes blloqeve imperialiste, kjo krizë ekonomike, sociale, shëndetësore dhe ushtarake, me pasojat e saj në fushën e informacionit dhe të shtypjes, tregon një shkallë të lartë koherence.

Kjo përzierje e frikshme e formave të reja të disiplinimit, nëpërmjet përdorimit të teknologjisë së lartë dhe ndërhyrjes së përsëritur shtetërore, ka të bëjë fare pak me një virus në formë kurore apo me ekspansionizmin rus. E vërteta është se kapitali ndërkombëtar nuk është i interesuar për shëndetin, ashtu siç nuk interesohet për popullin ukrainas, e as për Rusinë, Evropën apo Amerikën. Për nga natyra e tij, kapitali kërkon vetëm fitim maksimal. Jo fitimin në përgjithësi, por fitimin e vet. Nga këtu lind përplasia mes kapitaleve të sektorëve dhe kombësive të ndryshme.

Por e vërteta është edhe se kjo strategji agresive e blloqeve të veçanta kapitaliste në rrafshin e marrëdhënieve shoqërore dhe marrëdhënieve ndër-

ombëtare, është pasojë e krizës së thellë të kapitalit në tërësi. Asgjë e re në historinë e kapitalizmit: konkurrenca midis kapitaleve prodhon marrëveshje dhe marrëdhënie paqësore për sa kohë që bëhet fjalë për ndarjen e fitimeve. Mirëpo konkurrenca ndizet kur i gjithë kapitali shkon në krizë, duke u shndërruar, sipas fjalëve të Marksit, “në një luftë mes vëllezërve armiq”: vëllezër në shfrytëzimin e punëtorëve, armiq në ndarjen e fitimeve.⁹⁴

Ndërsa kapitalet përplasen me njëri-tjetrin, kapitali në përgjithësi ka vetëm një rrugëdalje nga kriza, atë të zakonshmen: t’i bëjë punëtorët të paguajnë për gjithçka. Për normën e përgjithshme të fitimit, pandemia, lufta dhe zinxhiri i ndryshimeve ekonomike, sociale dhe kulturore që e shoqërojnë, janë të kota nëse nuk përkthehen në rritje të shfrytëzimit.

Megjithatë, frika nga virusi dhe mbrojtja e demokracisë në Ukrainë nuk kanë të njëjtin efekt bindës për klasën punëtore të dërguar në kasaphanë.

Infektimi me një virus të panjohur ose infektimi i njerëzve tuaj të dashur, gulçimi, izolimi dhe frika nga vdekja kanë tmerruar vërtet gjysmën e botës, madje edhe ata që, në fund të fundit, nuk kishin asnjë rrezik. Falë edhe një fushate efektive mediatike, shumë e kanë pranuar me bindje vendosjen e masave kufizuese dhe shtrënguese. Edhe kur ato masa i pengonin realisht ata që jetonin vetëm me punën e tyre të shkonin të fitonin bukën e gojës.

Të dërgosh armë kur në spital nuk ka shtretër, të financosh luftën kur nuk ka fonde për shkollat, t’i japësh Ukrainës para hua me interes zero (duke e ditur që ajo nuk do të jetë në gjendje t’i shlyejë kurrë) ndërsa futesh në borxhe me përqindje në rritje, të ndihmosh kapitalin e madh ndërsa pagat dhe pensionet ulën, janë kontradikta të qarta, nën sytë e të

94

K. Marks, Kapitali, vëll. III, kapitulli 15.

gjithëve. Nuk mund t'i kërkohet popullit të vuajë nga i ftohti për të ndihmuar Ukrainën të bëjë luftë.

Madje edhe këta emigrantët e rinj të kategorisë superiore, të cilët të gjithë do duhej t'i donin dhe t'i respektonin, në realitet askush nuk i pëlqen. Në Evropë emigracioni nuk pëlqehet as në ata vende nga të cilët dikur niseshin flukset migratorë, të cilët tani i mbrojnë kufijtë me ushtri e marinë. Deri më tani, gratë ukrainase kanë qenë të mirëseardhura në Perëndim vetëm sepse vinin për t'u kujdesur për të moshuarit që kishin vënë disa para mënjane. Asnjë evropian nuk është i gatshëm të shtrëngojë rripin për ta. Nëse mbjellim racizëm, nuk mund të korrin solidaritet.

Predhat politiko-mediatike të mistifikimit dhe manipulimit goditën në shenjë kur ishte fjala për krijimin e panikut për një virus të gripit. Por tani që do të donin t'ia ngarkonin popullit koston e luftës ekonomike dhe ushtarake, ato rrezikojnë të shpërthejnë në ajër, për shkak të kontradiktave të tyre të brendshme.

Edhe për sa i përket *green-it*, duket qartë kthesa e papritur. Gjatë projektit më kolosal të tranzicionit teknologjik në emër të ekonomisë *green*, pas vitesh bombardimesh mediatike në mbrojtje të energjisë së pastër, papritur i kthehemi qymyrit dhe çdo gjëje që digjet. Në fakt BE-ja rrezikon të mos e kalojë dimrin në udhën pa krye ku është futur. Greta mund të bëjë një pushim dhe të përfitojë prej tij për të plotësuar disa boshllëqe të grumbulluar në vitet e shkollimit të detyrueshëm, ndërkohë që shkonte vërdallë duke iu dhënë mësim të fuqishmëve të planetit. Mbreti është lakuriq.

Tensionet rriten, lufta ekonomike po bëhet më e ashpër dhe rreziqet e një përrshpejtimi ushtarak janë afër. Por velloja e mistifikimit fillon të grisët. Shesht mbushen edhe nëse televizionet nuk i shfaqin. Kundër kufizimeve prej Covid-it, thërrisnin *Liri* dhe

Rezistencë, tani kërkojnë paga më të larta dhe kushte më të mira pune.

Forca kryesore e këtyre proceseve është objektive: interesat e subjekteve shoqërore që paguajnë çmimin e këtyre përplasjeve mes kapitaleve, dalin në pah në mënyrë të pashmangshme. Aftësia subjektive për t'i udhëhequr politikisht, sidoqoftë, është një çështje tjetër.

Rindërtimi i interesave në fushën e lojës, shpjegimi i strategjive të aktorëve kryesorë, të njohur apo të panjohur, gjetja e arsyeve të zgjedhjeve ne duke irracionale, është mënyra ime për të kontribuar shkencërisht në këtë proces demistifikimi, pa të cilin asnjë subjektivitet vërtet i vetëdijshëm nuk do të mundet kurrë të ekzistojë. Ky është, në fund të fundit, qëllimi i këtij libri.

Mistifikimi mediatiko-politik e errëson, por nuk e fshin të vërtetën. Të mos mund të punosh për shkak të një virusi, të mos ia dalësh deri në fund të muajit për shkak të luftës ekonomike, të rrezikosh luftën atomike për shkak të interesave të kapitalit, janë kushtet objektive në të cilat jetojnë ata që punojnë. Por lufta ekonomike, çmimin e së cilës duhet të paguajnë punëtorët, është në të vërtetë një luftë mes kapitaleve në krizë. Një valë grevash të përgjithshme dhe në të gjithë vendet, është e vetmja përgjigje racionale që klasa punëtoare mund t'i japë kësaj përplasjeje mes kapitaleve. Sigurisht, kushtet subjektive fillestare nuk janë të favorshme, pas dekadash individualizimi dhe atomizimi të lëvizjes punëtoare dhe të gjithë shoqërisë. Por kjo është e vetmja luftë nga e cila kapitali, i çdo sektori dhe kombësie, ka frikë: lufta e klasave.

Shkurtime

FED – Federal Reserve (Banka Qendrore e SHBA-së)

FEM – Forumi Ekonomik Botëror

SME – Sistemi Monetar Evropian

FMN – Fondi Monetar Ndërkombëtar

NATO – Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut

OKB – Organizata e Kombeve të Bashkuara

OSBE – Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

BE – Bashkimi Evropian

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Palermo, Giulio

Konflikti ruso-ukrainas : imperializmi amerikan

pushton Evropën / Giulio Palermo ; përkth.

Besmir Skëndaj ; red. Xhuliano Bregasi.

- Tiranë : Dritëhije, 2024.

... f. ; ... cm.

Tit. origj.: Il conflitto russo-ucraino : l'imperialismo

USA alla conquista dell'Europa

ISBN 9789928481511

1.Marrëdhënie ndërkombëtare 2. Politika
botërore

3. Marrëdhënie me jashtë 4. Rusi

5.Ukrainë

327(470:477) "21"

327(4/9) "21"